

nr.13

# praktikat QYTETARE



Qendra  
Maqedonase për  
Bashkëpunim  
Ndërkombëtar

*Perceptimi  
i ndikimit  
dhe vrethina  
e shoqërisë  
civile*





## Praktikat qytetare

**Tema: Perceptimi i ndikimit dhe  
rrethina  
e shoqërisë civile**

Numër 13



Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

**Biblioteka**

Shoqëria civile – Praktikant qytetare

**Botues**

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim

Ndërkombëtar (MCMS)

**Për botuesit**

Sasho Klekovski, drejtor i parë ekzekutiv i MCMS

Aleksandar Kërzhalovski, drejtor ekzekutiv i MCMS

**Redaktor**

Daniella Stojanova

**Përktheu**

Ermira Kuçlar

**Përgatiti**

Koma

ISBN 978-608-4617-39-6

**Adresë:**

Makedonski centar za megunarodna sorabotka (MCMS)

ul. Nikola Parapunov bb, Post. fah 55

1060 Skopje

**e-mail:** [mcms@mcms.org.mk](mailto:mcms@mcms.org.mk)

[www.mcms.org.mk](http://www.mcms.org.mk)

Mendimet që janë shprehur këtu i takojnë autorit dhe nuk do to thotë se i reflekton qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

**MCMS**

Të gjitha të drejtat janë ruajtur, riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i cilësdo qoftë pjesë nga ky publikim mund të bëhet vetëm nën kushtet që vijojnë: me leje paraprake të botuesit, për shkak të citimit në analizë dhe nën kushte të cekura në vazhdim.

Të drejtat e autorit të këtij publikimi janë mbrojtur, por publikimi mund të riprodhohet në cilëndo qoftë mënyrë dhe pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjimin në kushte tjera, për përdorim në publikime tjera ose për përkthim ose adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

# PËRMBAJTJA.....

- 7 Parathënie
- 9 Hyrje
- 11 Perceptimi i ndikimit
- 35 Ndikimi i organizatave qytetare te grave ndaj politikave buxhetore të republikës së maqedonisë: Buxhetim gjinorë
- 51 Raportet mes sektorit afarist dhe shoqërisë civile / përgjegjësia shoqërore e ndërmarrjeve
- 70 Strategjia për bashkëpunim me sektorin civil a kontribuoi për përmirësimin e dialogut mes qeverisë dhe shoqërisë civile
- 86 Kufizimet e lirisë së shoqërimit dhe veprimit
- 101 Shënime për autorët



# — PARATHËNIE —

Para jush gjendet botimi i 13-të i Praktikave qytetare, kësaj here kushtuar ndikimit të organizatave qytetare (OQ) dhe rrethinës në të cilën veprojnë.

Në këtë rrëfim mr. Ilina Mangova e hulumton pjesëmarrjen dhe ndikimin e shoqërisë civile në Maqedoni në procesin e krijimit dhe miratimit të Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ajo vlerëson se një pjesë e shoqërisë civile ka arritur që të bëjë ndikim të pjesshëm në legjisllacionin nacional për jo diskriminim, por ndikim më të madh nuk mund të realizohet për shkak të dallimeve ideologjike mes një pjese të shoqërisë civile dhe qëndrimeve konzervative të partisë në pushtet.

Mr. Bobi Badarevski e shqyrton ndikimin e organizatave të grave në politikat buxhetore të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht buxhetimi gjinor. Ai përfundon se këto organizata janë iniciatorët kryesor të idesë për krijimin e politikave të ndjeshme buxhetore gjinore. Në pikëpamje të procedurave, ato vazhdimisht insistojnë në aplikimin e metodave të cilat e mbështesin buxhetimin e ndjeshëm gjinor, ndërsa në raport me strukturën, punojnë në forcimin e kapacitetit profesional të nëpunësve shtetëror.

Raportet mes sektorit afarist dhe shoqërisë civile të vështruara nga prizma e Përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve (PSHN) është lëndë e hulumtimit të mr. Nikica Kusenikova. Hulumtimi tregon se organizatat qytetare nuk janë lëvizës i rëndësishëm i PSHN në Republikën e Maqedonisë. Janë të rrallë shembujt e OQ të cilat bëjnë presion mbi sektorin afarist dhe të cilat rregullisht e përcjellin rezultatin e ndërmarrjeve në fushën e PSHN. Bashkëpunimi mes dy sektorëve vazhdimisht përparon, por akoma janë në nivel të pakënaqshëm të iniciativave individuale të disa ndërmarrjeve dhe shoqatave të cilat e kanë njohur dobinë e ndërsjellë dhe interesin nga bashkëpunimi.

Strategjia e kontribuoi për përmirësimin e dialogut mes qeverisë dhe shoqërisë civile, është tema e rrëfimit të mr. Simonida Kacarska. Bëhet fjalë për Strategjinë e Qeverisë për bashkëpunim me sektorin civil. Analiza tregon për raporte të ndryshme për zbatim dhe pikëpamjet e ndryshme të aktorëve të ndryshëm të vendit dhe nga jashtë për këtë çështje. Vlerësimi tregon se bashkëpunimi akoma varet nga çështja, institucionet dhe personalitetet e kyçura në atë.

Rrëfimi i fundit është i mr. Sllagjana Dimishkova dhe ka të bëjë me kufizimin e lirisë së shoqërimit dhe veprimit. Rrëfimi përqendrohet në dokumentet ndërkombëtare të cilat

drejtpërdrejt aplikohen në vend, por edhe në legjislacionin nacionalë që ka të bëjë me lirinë e shoqërimit. Autorja konstatoi se liria e shoqërimit nuk është e drejtë absolute dhe e njëjta ja përkufizime të caktuara të cilat mund të jenë me interes të sigurisë nacionale, për pengimin e trazirave ose veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Lexim të këndshëm,  
Gonce Jakovleska

# — HYRJE —

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) rregullisht e hulumton shoqërinë civile dhe kontekstin në të cilin vepron. Deri tani MCMS zbatoi më shumë hulumtime, d.m.th. analiza, anketa, studime të rastit për çështje të caktuara nga fusha me interes për shoqërinë civile, si: besimi dhe vlerat tjera shoqërore, përgjegjësia shoqërore e qytetarëve, rrjetëzimi, rregullativa ligjore, pjesëmarrja e organizatave qytetare në krijimin e politikave etj.

## CIVIKUS – INDEKSI I SHOQËRISË CIVILE

Në kuadër të këtyre hulumtimeve me përpjekje për avokim të bazuar në fakte, MCMS në vitin 2004 për herë të parë filloi ta zbatojë edhe Civikusin – Indeksin e shoqërisë civile (ISHC), projekt hulumtues-aksionar ndërkombëtar që e vlerëson situatën e shoqërisë civile në dhjetëra vende në botë. Në nivel ndërkombëtar ISHC është koordinuar nga Civikus – Aleanca botore për pjesëmarrje qytetare. Metodologjia e ISHC përfshinë anketa të popullatës, anketa me organizatat qytetare, intervista, rrëfime të rastit, analizë të literaturës, fokus-grupe etj. Përgjegjës për zbatimin e MCMS është ekipi hulumtues nacional (IEN). MCMS për herë të parë e zbatoi ISHC në periudhën 2004-2006 dhe e botoi raportin “Pas 15 vjet tranzicion – Nga stabilizimi deri te pjesëmarrja qytetare”<sup>1</sup>.

## PROCESI I ZGJEDHJES SË RRËFIMEVE TË RASTIT

Në periudhën 2009-2011 MCMS për herë të dytë e zbatoi ISHC. Kësaj radhe MCMS ta përsërisë përpjekjen nga viti 2008 kur u mbështet përgatitja dhe botimi i 10 punimeve të magjistraturës<sup>2</sup> dhe ta përsëritë botimin e **Praktikave qytetare**<sup>3</sup>, ashtu që mundësoi përgatitjen e rrëfimeve të rastit për nevojat e ISHC ta bëjnë hulumtuesit e ri të shoqërisë civile. Në nëntor të vitit 2010 u shpall shpallje për përgatitjen e rrëfimeve të rastit për shoqërinë civile në pesë dimensionet e tija (të definuara sipas ISHC): **Angazhimi qytetar; Niveli i organizimit; Praktikimi i vlerave; Perceptimi i ndikimit; dhe, Rrethina e jashtme.** IEN zgjidhi 16 tema të rrëfimeve të rastit, të cilat do të botohen në tre botime të Praktikave qytetare.

1 Raporti në formë elektronike mund të gjendet në ueb faqen e MCMS:

2 Punimet në formë elektronike mund të gjenden në ueb faqe e MCMS:

3 Në periudhën 2003-2005 u botuan 11 numra të Praktikave qytetare. Të njëjtat në formë elektronike mund të gjenden në ueb faqen e MCMS:

## METODOLOGJIA

Rrëfimet e rastit paraqesin analizë të thellë dhe sistemore të çështjeve konkrete me rëndësi për shoqërinë civile. Autorët e rrëfimeve shfrytëzuan më shumë metoda hulumtuese: anketa, intervista, analizë të literaturës etj. Autorëve iu ishte i qasur udhëzimi për përgatitjen e rrëfimeve të rastit, të përgatitur nga Civikus dhe IEN.

## INDEKS EKIPI NACIONAL

Autorët punua në bashkëpunim me IEN, anëtarë të cilit krahas udhëzimeve, bënin edhe redaktimin e teksteve. IEN e përbëjnë: Sasho Klekovski, Daniella Stojanova, Gonca Jakovleska dhe Emina Nuredinoska

## TERMET DHE DEFINICONET

Në opinionin maqedonas dhe në rrethet eksperte nuk ekziston mirëkuptim i ndërsjellë i konceptit (definicioni) të shoqërisë civile. Për rrëfimet është përdorur definicioni i Civikus – Indeksi i shoqërisë civile në Maqedoni (MCMS, 2009): **Shoqëria civile** është pjesë e hapësirës shoqërore jashtë familjes, shtetit dhe tregut, që është krijuar nga ana e aksioneve individuale dhe kolektive, organizatat dhe institucionet për shkak të arritjes së inverseve të përbashkëta. Sipas këtij definicioni, në shoqërinë civile janë përfshirë shoqatat dhe fondacionet, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, sindikatat, partitë politike dhe bashkësitë fetare.

**Perceptimi i ndikimit.** Me perceptimin e ndikimit përshkruhet dhe analizohet sa shoqëria civile në Maqedoni është e suksesshme në ndikimin në shoqëri dhe në politikat. Qëllimi i rrëfimeve të përgatitura në këtë dimension ishte të analizohet efektiviteti i aktiviteteve të organizatave qytetare për ndikim mbi politikat. Duke marrë parasysh spektrin e gjerë të çështjeve për të cilat mund të analizohet ndikimi i organizatave qytetare, MCMS u përcaktua për ndikim mbi politikat për të drejtat e njeriut dhe buxhetin nacional. Organizatat qytetare dhe përfaqësuesit e sektorëve tjerë vlerësuan se shoqëria civile është më aktive në fushën e të drejtave të njeriut, ndërsa nuk ka kurrfarë ose shumë pak aktivitete lidhur me buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

**Rrethina e jashtme.** Me dimensionin rrethina e jashtme vlerësohen kushtet në të cilat vepron shoqëria civile. Duke marrë parasysh metodologjinë për Civikus-Indeksi i shoqërisë civile në mënyrë të pamjaftueshme i përfshinë raportet me sektorët tjerë, MCMS u përcaktua me rrëfimet e rastit të bëjë analizë të raporteve të sektorit civil me sektorin shtetëror dhe afarist, ndërsa gjatë kësaj të përfshihen edhe liritë e shoqërimit dhe përgjegjësia shoqërore e ndërmarrjeve..

Tema:

# — PERCEPTIMI I NDIKIMIT —

Mr. Ilina Mangova, Instituti për Demokraci Societas civilis

## NDIKIMI I POLITIKAVE NACIONALE: LIGJI PËR PENGIMIN DHE MBORJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### REZYME

Rrëfimi e hulumton pjesëmarrjen dhe ndikimin e shoqërisë civile në Maqedoni në procesin e krijimit të Ligjeve për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ligjit, që u miratua më 8 prill 2010 i paraprin punë intensive dhe lobim i organizatave qytetare. Përmes krijimit të Trupit koordinues nacional që përfshinë pjesëmarrës nga Kuvendi, nëpunës shtetëror, organizata qytetare, ekspertë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare punohet në koordinimin e palëve të interesuara për miratimin e këtij ligji. Gjithashtu, një numër i caktuar i organizatave qytetare shoqërohen për veprim të përbashkët përmes formimit të lidhjes Maqedonia pa diskriminim dhe ata në mënyrë të drejtpërdrejtë janë inkuadruar në përpunimin e Ligjit në kuadër të grupit punues së Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Por, para se të dorëzohet projekt-ligji në Kuvend në kuadër të Qeverisë, bëhet shkurtimi i një të tretës së tekstit të tij, me çka bëhen ndryshime të shumta, të cilat në mënyrë thelbësore ndikojnë në propozim-ligjin. Kjo shkakton reagime të ndryshme të organizatat qytetare, gjatë së cilës një pjesë e tyre kërkojnë propozim-ligji të tërhiqet për çka kërkojnë dhe fitojnë mbështetje nga opozita. Por, kjo kërkesë nuk rezulton me sukses. Nga ana tjetër, një pjesë e organizatave qytetare vazhdojnë të llobojnë për ndryshimet e amendamenteve në procedurën ligjdhënëse, gjatë së cilës arrijnë sukses të fusin 11 amendamente të vlerësuara si amendamente me prioritet të lartë. Rrëfimi vlerëson se një pjesë e shoqërisë civile arrin të bëjë ndikim të pjesshëm në legjislacionin nacional për jo diskriminim. Pritjet për ndikim më të madh të shoqërisë civile mbi legjislacionin nga kjo sferë nuk mundnin të realizohen për shkak të dallimeve të mëdha ideologjike mes një pjese të shoqërisë civile dhe qëndrimeve konzervative të partisë në pushtet.

## HYRJE

Shoqëria civile është pjesë përbërëse, ndërsa është shoqëria e zhvilluar civile llogaritet për shprehje të pjekurisë së një demokracie. Kontributi i tij për demokracinë varet edhe nga ajo se sa edhe vetë është e orientuar demokratikisht ose sjell vlera retrograde. Karakteristikat e saja, si dhe vlerat, si dhe vlerat që i promovon janë determinuar nga kushtet historike dhe konteksti politik në të cilin zhvillohet. Fuqia dhe kapaciteti i shoqërisë civile ti realizojë qëllimet dhe interesat e veta mund të matet përmes ndikimit të saj mbi politikën nacionale. Karakteri i shoqërisë civile në Maqedoni është determinuar nga pavarësia e shtetit dhe ristrukturimi i sistemit politik. Derisa gjatë viteve të nëntëdhjeta përpiquej të etablohet në kontekstin e ri demokratik, sot shoqëria civile në Maqedoni më shumë është e printuar drejt ndikimit mbi politikën nacionale. Shoqëria civile ka ndikim të vogël, por që rritet mbi politikën nacionale. Gjatë kësaj, ndikim më të madh ka mbi krijimin e politikave për përmirësimin e statusit të romëve, personave me nevoja të veçanta, gratë etj. Edhe krahas aktivitetit të madh në sferën e të drejtave të njeriut, mospjesëmarrja e saj është i kufizuar në përmirësimin e statusit të këtyre grupeve<sup>4</sup>.

Përkushtimi i shoqërisë civile maqedonase ndaj të drejtave të njeriut në vend intensifikohet në vitin 2007 dhe 2008, në qëllimin e më shumë organizatave qytetare që të krijohet sistem integral për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, garancia e barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi. Rregullimi ligjor i kësaj fushe është nxitur veçanërisht nga nevoja për harmonizimin e legjislacionit maqedonas me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe plotësimin e kriterëve politike për anëtarësim në Union. Me qëllim të miratimit të ligjit sa më cilësor i cili do të përfshijë kërkesat e organizatave qytetare dhe të institucioneve shtetërore, në vitin 2008 një grup i organizatave qytetare themelojnë trup koordinues heterogjen që bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) në përpunimin e **Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (më tutje, Ligji)**.

Por, edhe krahas koordinimit mes institucioneve qeveritare dhe organizatave qytetare, në fillim të vitit 2010 Qeveria në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë shtron versionin e ndryshuar dhe të shkurtuar të propozim-ligjit. Ndaj rezultatit të këtillë të ngjarjeve, shoqëria civile në Maqedoni, e kuptuar si veprim kolektiv i qytetarëve përmes organizatave qytetare, vendos të reagojë në dy drejtime të ndryshme. Një grup i organizatave qytetare hapin e këtillë të pushtetit e komenton si goditje mbi të drejtat e njeriut dhe heq dorë nga ndikimi i mëtejshëm mbi legjislacionin nacional për jo diskriminim. Një grup tjetër i organizatave qytetare vendos të vazhdojë të ndikojë mbi legjislacionin konkret përmes procedurave parlamentare dhe të punojë në ndryshimet amendamente të propozim-ligjit. Përmes futjes së një grupi të amendamenteve të vlerësuara si amendamente me prioritet

4 Civikus: Indeksi i shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë; Pas 15 vjet tranzicioni drejt pjesëmarrjes qytetare. (2005) Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar. fq. 85, 87

të lartë, ato bëjnë ndikim mbi versionin përfundimtar të ligjit. Me shtrimin e pyetjes pse një proces i cili realizohet si bashkëpunim mes Qeverisë, Kuvendit, institucioneve relevante shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile e ndryshon trajektoren e lëvizjes dhe e sjell në pikëpyetje kontributin e shoqërisë civile ndaj legjislacionit nacional për jo diskriminim.

Studimi së pari e shqyrton konceptin e shoqërisë civile dhe si e njëjta kuptohet në Maqedoni përmes pasqyrës së literaturës akademike dhe hulumtuese në këtë temë. Në pjesën e parë e sqaron metodologjinë e aplikuar në këtë hulumtim. Pjesa e tretë e ndjek procesin e inicimit dhe miratimit të Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, e përcjellë me vështrim të shkurtër në mbulimin e saj nga mediat. Në pjesën e pestë diskutohet pse Qeveria e hedh poshtë propozim-ligjin e përgatitur në bashkëpunim mes shoqërisë civile dhe si ligji përsëri përjeton ndryshime gjatë procesit legjislativ, pas çka vijon përfundimi i studimit.

### » **Funksioni i shoqërisë civile në demokraci**

Shoqëria civile është shprehje e drejtpërdrejtë e potencialit të qytetarëve të një shoqërie. Civikus – Indeksi i shoqërisë civile e definon të njëjtën si “pjesë nga hapësira shoqërore jashtë familjes, shtetit dhe tregut, që është krijuar nga ana e individëve dhe aksioneve kolektive, organizatave dhe institucioneve për shakat të arritjes së interesave të përbashkëta”<sup>5</sup>. Ky kuptim, krahas shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve, në konceptin e shoqërisë civile i përfshinë odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, partitë politike dhe bashkësitë fetare<sup>6</sup>. Por, termi i këtillë i gjerë dallohet nga termi akademik që nuk i përfshinë organizatat fetare dhe partitë politike në definicionin e tyre<sup>7</sup>. Shoqëria civile është ndërmjetësues mes shtetit dhe qytetarëve dhe si e tillë i përjashton partitë politike, pasi që nuk pretendon ta pushtojë pushtetin<sup>8</sup>. Kjo i “përfshinë qytetarët që veprojnë në mënyrë kolektive në sferën publike që ti shprehin interesat e tyre, pasionet dhe idetë, të shkëmbejnë informata, të realizojnë qëllime të përbashkëta, të shtrojnë kërkesa deri te shteti dhe i vë funksionarët shtetëror nën përgjegjësi”<sup>9</sup>. Kjo i prek sferën politike, ekonomike dhe private në një shoqëri, por nuk është e orientuar të ndryshojë ndonjërin prej tyre. Kjo është hapësira ku qytetarët grumbullohen ti shprehin dhe ti praktikojnë vlerat e tyre dhe ti realizojnë interesat e tyre, hapësirë ku qytetarët dalin nga sfera e tyre private të ndërmarrin aksione qytetare që ndikojnë në rrethinën më të gjerë. Karakteristika e saj e këtillë e bën shoqërinë civile të jetë me rëndësi thelbësore për demokracinë<sup>10</sup>.

5 Stojanova, D., Jakovleska, G., Klekovski, S., Nuredinoska, E. (2010). Vetëperceptimi për shoqërinë civile – Raport nga anketa organizative, Civikus – Indeksi i shoqërisë civile. Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar. fq. 4

6 Ibid. fq.4

7 What is Civil Society?, Centre for Civil Society, London School of Economics and Political Science, [http://www.webarchive.org.uk/wayback/archive/20100820110531/http://www.lse.ac.uk/collections/CCS/introduction/what\\_is\\_civil\\_society.htm](http://www.webarchive.org.uk/wayback/archive/20100820110531/http://www.lse.ac.uk/collections/CCS/introduction/what_is_civil_society.htm) Qasur më: 20 февруари 2011

8 Diamond, L. (1994). Rethinking Civil Society: Towards Democratic Consolidation. *Journal of Democracy*, 5(3), 5

9 Diamond, L. (1994). Rethinking Civil Society: Towards Democratic Consolidation. *Journal of Democracy*, 5(3), 5

10 Ibid. 92

Sipas Dajmond, përmes aksioneve të këtilla qytetare, qytetarët në kuadër të kësaj sfere publike i zbulojnë keqpërdorimet e pushtetit. Shoqëria civile e ka rolin e kontrolluesit ose faktorit të legjitimizimit të pushtetit shtetëror. Kjo e kufizon dhe tregon për nevojën që të kufizohet fuqia e shtetit. Në këtë kuptim, shoqëria civile nuk është vetëm sferë për realizimin e interesave, por kryen edhe funksione me dobi për demokracinë në një shtet. Grugel flet për nevojën e shoqërisë civile të shërbejë si platformë përmes së cilës grupet e marginalizuara, të cilat nuk kanë fuqi të mjaftueshme të veprojnë në skenën politike, do të mund të dalin veprojnë. “Demokracia kërkon grupe të caktuara të kenë mjete të mjaftueshme të luajnë rol të rëndësishëm në shoqërinë civile dhe në këtë kuptim gjithashtu edhe në raport me shtetin”<sup>11</sup> Ky rrëfim do ta pranojë konceptin e këtillë me qëllim që më mirë të kuptohet raporti mes partive politike, Qeverisë, Kuvendit, si faktorë në krijimin e politikave nacionale nga njëra anë dhe shoqëria civile si faktor i cili përpiket të ndikojë ose ndikon mbi politikat nacionale.

Për dallim nga shoqëritë civile me demokraci të zhvilluara, vendet në Evropën post komuniste i karakterizon shoqëria e dobët e zhvilluar dhe pjesëmarrja e dobët e qytetarëve në të njëjtën. Huard pohon se dobësia e shoqërisë civile në Evropën post komuniste është e rrezikshme për demokracinë në këto vende dhe për këtë shkak pëson kualiteti i demokracisë në ato<sup>12</sup>. Në vijë të njëjtë është edhe Grugel i cili thotë se shoqëria e dobët civile me shkalë të ulët të pjesëmarrjes jo vetëm që flet për demokraci të dobët, por flet edhe për gjendjen ku shteti nuk ka obligim të madh ta dëgjojë shoqërinë civile.

Shoqëria civile maqedonase pretendon të kryejë funksione me interes të demokratizimit të vendit, të cilat i theksojnë Dajmond dhe Grugel. Fuqia relevante të kryejë funksione të tilla varet nga kapaciteti i tij i brendshëm, si edhe konteksti politik në të cilin ekziston. Cvikus – Indeksi i shoqërisë civile në Maqedoni (ISHC) vërteton se “shoqëria civile në Maqedoni është e zhvilluar mirë e matur”<sup>13</sup>. Kjo i mundëson ta realizojë karakteristikën më të fuqishme të saj – zhvillimi dhe promovimi i vlerave pozitive, edhe krahas asaj që funksionon në mjedis politik që e kufizon realizimin e kapacitetit të saj<sup>14</sup>. Por, Kacarska, nga ana tjetër, pohon se edhe krahas zhvillimit, organizatat qytetare si element konstitutiv i shoqërisë civile ballafaqohen me problem që në mënyrë efektive ta realizojnë funksionin e vet mes shtetit dhe opinionit<sup>15</sup>.

Vetë organizatat qytetare në Maqedoni e shohin këtë problem edhe në vitin 2005, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) bashkëpunon me Qeverinë me

11 Howard, M. M. (2003) *The Weakness of Civil Society in Post-Communist Europe*, Cambridge: Cambridge University Press

12 Ibid. fq. 12

13 Ibid. fq. 13

14 Kacarska, C. (2008) *Organizatat qytetare në Republikën e Maqedonisë – Lidhja mes shtetit dhe opinionit ose entitet i izoluar? Analiza e gjendjes në periudhën 1990-2007*, Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

15 *Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil (2007-2011)*. (2007) Shkup: Qeveria e Republikës së Maqedonisë – Sekretari gjeneral <http://www.vlada.mk/?q=node/2> fq. 25 Qasur më: 10 dhjetor 2010.

qëllim të krijimit të programit qeveritar për ndihmë shoqërisë civile. Ky aktivitet rezulton me **Strategjinë e Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile**. Gjatë kësaj Qeveria vërteton disa parime në bazë të cilave e realizon bashkëpunimin me sektorin civil: besimi i ndërsjellë, partneriteti, pjesëmarrja dhe këshillimet, transparenca, pavarësia dhe përgjegjësia “me qëllim të realizimit më efikas të interesave të qytetarëve”<sup>16</sup>. Qëllimi i inkuadrimit të këtillë të sektorit civil në krijimin e politikave nacionale janë **zgjidhjet më cilësore ligjore**, si dhe “të forcohet **legjitimiteti i politikës qeveritare**”<sup>17</sup>.

Strategjia e këtillë tregon se pushteti deklaron interes që ta inkorporojë shoqërinë civile në proceset demokratike në vend. Por, shoqëria civile në Maqedoni akoma i ndjen pasojat nga konceptimi i vet në fillim të viteve të nëntëdhjeta gjatë së cilës etablohet si e afërt dhe e sponsorizuar nga opioni i majtë politik<sup>18</sup>. Trashëgimia e këtillë krijon mosbesim mes strukturave të caktuara në partinë në pushtet VMRO-DPMNE dhe një grupi të caktuar të organizatave qytetare, të cilat promovojnë vlera të majta dhe liberale. Në kuadër të partisë sunduese akoma ekziston bindja se këto organizata veprojnë në interes të drejtpërdrejtë me LSDM-në opozitare. Vlladimir Gjorçev, deputet i VMRO-DPMNE, ato i quan “këmbësori e LSDM”.<sup>19</sup> Kjo situatë krijon hapësirë për dyshim se mund të ketë armëpushim mes asaj që është qëndrim deklarativ i pushtetit me atë që është qëndrim inherent të partisë në pushtet.

Sistemi politik maqedonas, mbi politikat e të cilit shoqëria civile përpiqet të ndikojë, është krijuar sipas shembullit të demokracive parlamentare evropiane ku qeveria është bartësi kryesor dhe krijuesi i politikave. Qeveria maqedonase, si qeveri me koalicion i VMRO-DPMNE, Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) dhe partive më të vogla, para së gjithash i realizon politikat dhe programet e këtyre dy partive..

## » **Metodologjia**

Studimi përdori metodën për hulumtim të rasteve individuale me qëllim që të hyjë në thelbin e raporteve mes aktorëve të ndryshëm që ishin inkuadruar në procesin e krijimit dhe miratimit të ligjit konkret. U realizuan dymbëdhjetë intervista me përfaqësues të organizatave qytetare, partive politike dhe institucioneve shtetërore, me qëllim që të fitohet pasqyrë autentike dhe vështrime të personave që kanë qenë të inkuadruar në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin dhe miratimin e ligjit. Metoda e intervistës mundëson të shihet perspektiva e atyre të cilët intervistohen dhe të kuptohen punë të cilat nuk kanë mundur në mënyrë të drejtpërdrejtë të vëzhgohen<sup>20</sup>. Intervistat janë bërë në bazë të pyetësorit që është kombinim i dy qasjeve. Pyetësori i kombinon qasjen e ciceronit të përgjithshëm për intervistë dhe intervista e hapur duke marrë parasysh profilet e ndryshme dhe palët që të

16 Ibid. fq. 26

17 Civikus – Indeksi i shoqërisë civile. fq. 24, 25

18 A janë të diskriminuar homoseksualët në Maqedoni? (3 shkurt 2010) Video incizim. A1 televizioni, studio 2

19 Patton, M. Q. (2002) Qualitative Research and Evaluation Methods California: Sage. p.287

20 Ibid. fq. 287



intervistuarit i përfaqësojnë në procesin që u analizua. Qasja e kombinuar mundëson të kompensohen mangësitë e dy tipave të intervistave dhe të vërtetohet përvoja unike në procesin e secilit nga të intervistuarit. Në këtë mënyrë ruhet sistematizimi dhe krahasimi i përgjigjeve nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër shmanget anësia e intervistuesit dhe mundëson gjerësi të dhënave.

Rrëfimi bëri **ndjekjen e procesit**<sup>21</sup> me qëllim që të vërtetohen shkaqet që sollën deri te ndryshimi në ligj dhe deri te versioni përfundimtar. U bë edhe pasqyrë e përfshirjes mediale të ngjarjeve lidhur me Ligjin, që ndihmoi të shihet ndikimi i mediave për krijimin e debatit publik lidhur me Ligjin. Gjithashtu studimi u shërbye me burime primare, siç janë dokumentet parlamentare dhe qeveritare dhe dokumentet e organizatave qytetare dhe burimet sekondare, më saktë literatura dhe hulumtimet ekzistuese për gjendjen dhe kapacitetin e shoqërisë civile në Maqedoni.

## **ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË PROCESIN E KRIJIMIT DHE MIRATIMIT TË LIGJIT PËR PENGIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Përpjekja e shoqërisë civile maqedonase të ndikojë mbi legjislacionin nacional për anti-diskriminim paraqet përpjekje që të ndikohet mbi politikën për të drejtat e njeriut të partisë në pushtet. Partia e cila në atë periudhë është në pushtet, VMRO-DPMNE, është parti konzervative, ndërsa politika e saj lidhur me të drejtat e njeriut është e ekspozuar në programin zgjedhor 2008-2012, ku në pikëpamje të drejtave dhe lirive të njeriut projektohen në tre drejtime – forcimi institucional dhe normativ i politikës për të drejtat e të miturve, implementimi i të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe ligji për avokatin e popullit të personave me nevoja të veçanta. Por, me interes të veçantë për këtë studim është masa që e ka planifikuar ta ndërmerr kjo parti, duke aluduar në të drejtat dhe lirive e të njeriut si një nga prioritetet kryesore të saja. Në të vërtetë, programi si prioritet kryesor e vë agjentin qeveritar i cili e përfaqëson shtetin në Gjykatën evropiane për të drejtat e njeriut.<sup>22</sup> Projekti i programeve të tilla flet për pozitën që preferon mbrojtjen e shtetit nga qytetarët para mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga shkelja e shtetit. Programi flet për kuptimin e ngushtë të VMRO-DPMNE ndaj të drejtave të njeriut dhe politikës së saj në këtë kontekst, gjegjësisht politika e orientuar drejt përmirësimit të drejtave të njeriut nga grupe të caktuara dhe mbrojtja, para së gjithash e shtetit në sistemin juridik ndërkombëtar për të drejtat e njeriut kur do të vërtetohet shkelja e të njëjtave.

Përgatitja e Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, që është lëndë e këtij

21 Gerring, J, (2006) “pp172-186” from Gerring, J, Case study research : principles and practices pp.172-186, New York: Cambridge University Press

22 Programi i VMRO-DPMNE për rilindje 2008-2010 (2008) [www.vmro-dpmne.org.mk](http://www.vmro-dpmne.org.mk), E qasur më: 10 korrik 2010

rrëfimi, është në kompetenca të grupit punues pranë MPPS. Shoqëria civile në Maqedoni përpiqet të ndikojë në legjislacionin nacional për jo diskriminim përmes krijimit të Trupi koordinues nacional për jo diskriminim, që më poshtë do të sqarohet më hollësisht. Trupi që i përfshinë pothuaj të gjitha entitetet relevante të interesuara, duke filluar nga Qeveria, deri te organizatat qytetare në periudhën prej një viti e gjysmë takohet dhe negocion propozime të ndryshme në dispozitat e ligjit. Sipas mënyrës në të cilën është vendosur sipas propozimeve në raportet mes grupit punues dhe këtij trupi, mund të thuhet se kjo ka funksionuar sipas parimit të votimit me shumicë. Teoria në optimum mesatar, e njohur si “teoria për votues mesatar”, e vendosur nga Dankan Blek në vitin 1948<sup>23</sup>, flet se kur propozimi votohet në kuadër të trupit anëtarë të cilit kanë preferenca të ndryshme, vendimi përfundimtar do të jetë optimumi mesatar. Gjegjësisht, vendimi përfundimtar do të jetë shprehje në pozitën optimale mesatare të anëtarëve që gjenden më djathtas dhe më majtas nga pozita e mesme të këtij trupi.

Versionin e ligjit që MPPS e dorëzon në Qeveri (nr. 20, fotografia 1), ndërsa është e përbërë në këshillime me organizatat qytetare, që përbëhet prej 62 anëtarëve, paraqet optimum mesatar të grupit më të ngushtë punues të MPPS dhe anëtarëve të MPD. Përmes këshillimeve të VMREO-DPMNE, në kapacitet të partisë kryesore në pushtet dhe krijues i politikave të Qeverisë, në vendimarrjen për tekstin final të propozimit të LPMD, janë lënë anësh preferencat e kësaj partie dhe versioni i ligjit të shoqërisë civile është shumë larg preferencave të VMRO-DPMNE. Por, me aktivizimin e disa organizatave qytetare në drejtim të përfaqësuesve në pushtet në pushtetin ekzekutiv dhe ligjdhënës, një pjesë e shoqërisë civile i kanalizon kërkesat e të njëjtës deri te kryesorët që vendosin. Prej këtu shtrohet hipoteza e këtij rrëfimi të rastit, **në atë masë ku shoqëria civile do të ketë sukses ti ballafaqojë propozimet e veta drejtpërdrejtë me kryesorët që vendosin nga partia në pushtet, do të ketë sukses mbi legjislacionin final për jo diskriminim..**

### » **Përcjellja e procesit të krijimit dhe miratimit të Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi**

Parimi i jo diskriminimit është në thelbin e garantimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë qytetarëve të saj ua garanton të njëjtat në 45 nene. Maqedonia gjithashtu ka ratifikuar një numër të madh të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare, që janë pranuar si pjesë e legjislacionit nacional. Por, që në vitin 2005 shteti sheh se “në realitet aplikimi i ligjeve ekzistuese nuk funksionon në mënyrë ideale”.<sup>24</sup> Prej atëherë dalin iniciativat e para për miratimin e ligjeve me të cilin do të sanksionohen

23 Black, D. (1948) On the Rationale of Group Decision-making. *Journal of Political Economy*, 56(1), 23-34

24 Propozim Ligji për mbrojtje nga diskriminimi, 2005, fq.3

<http://www.mcms.org.mk/mk/za-nasata-rabota/jaknene-svest-i-kampani/325-eden-do-drug-razlicni-a-ednakvi.html>

rastet dhe politikat e diskriminimit kur është përgatitur propozimi i parë i “Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi”. Iniciativat për këtë ligj nisin nga aktorë të shoqërisë civile. Në vitin 2005 janë përpunuar dy propozim versione (nr. 1, fotografia 1), një nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) i mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ndërsa tjetri nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHM), i mbështetur nga Komiteti Suedez i Helsinkit. Në këtë periudhë të dy organizatat i koordinojnë aktivitetet e veta dhe bashkëpunojnë në vërejtjet e tyre në versionin e përbashkët të propozim-ligjit. Por, sipas pjesëmarrësve në këtë proces, partia e atëhershme në pushtet, LSDM, mendonte se akoma është herët për miratimin e një ligji të tillë në Maqedoni<sup>25</sup>. Përpjekjet e organizatave qytetare të punohet në ligjin nga fusha e diskriminimit në mënyrë plotësuese u ngrinë me zgjedhjet në vitin 2006.

Pas konstituivit të kuvendit të ri në vitin 2006 përsëri u aktivizua në drejtim të rregullimit ligjor në sferën e diskriminimit. Komiteti i Helsinkit Maqedonas e dorëzoi propozim-ligjin për anti-diskriminim (nr. 2, fotografia 1) deri te deputet e porsazgjedhur dhe instancat tjera relevante, por iniciativa u injorua nga ana e të gjithë pranuesve<sup>26</sup>.

Në vitin 2007, në shenjë të shpalljes së të njëjtit për “Vit evropian për mundësi të barabarta për të gjithë”, nga ana e Komisionit Evropian, tre organizata qytetare – MCMS, Polio Plus dhe Qendra për të Drejta të Njeriut dhe Zgjidhjen e Konflikteve, filluan fushatë (nr. 3, fotografia 1) për zhvillimin e vetëdijes publike në vend në pikëpamje të sjelljes diskriminuese dhe ndërmarrjen e masave për përmirësimin në këtë sferë<sup>27</sup>. Fushata e emëruar si “Njëri afër tjetrit – të ndryshëm, por të barabartë” paraqitet në mediat elektronike dhe të shtypura dhe kontribuon për zhvillimin e vetëdijes te popullata e përgjithshme lidhur me njohjen e praktikave të ndryshme të sjelljes diskriminuese që është prezent në shoqëri, si edhe toleranca e rritur dhe pranimi i dallimeve<sup>28</sup>. Nga ky bashkëpunim del veprimi i mëtejshëm i përbashkët i organizatave qytetare, të cilat shoqërohen në trup më të gjerë joformal, që së pari është emëruar si “Koalicioni për mundësi të barabarta”. Qëllimi i veprimit të këtillë të përbashkët të organizatave qytetare është të jepet kontribut autentik në krijimin e legjislacionit anti-diskriminues dhe krijimi i mekanizmave për luftë efektive me diskriminimin. Koalicioni më vonë emërohet në “Lidhja Maqedonia pa diskriminim” (MBD) (nr. 11, fotografia 1) dhe krahas tre organizatave të përmendura në atë janë inkuadruar edhe Shoqata Humanitare dhe Bamirëse e Romëve “Meseçina”, EL Hilal, Asociacioni për Iniciativa Demokratike, Këshilli Nacional i Grave të Maqedonisë – LOGM, Qendra Maqedonase për të Drejta të Grave – Shellter qendra, “Universiteti Moshë e tretë”, Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë Megjashi dhe HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë (që më vonë u tërhoq nga

25 Gordana Nestorovska, intervistë me autorin

26 Gordana Nestorovska, intervistë me autorin

27 <http://www.mcms.org.mk/mk/za-nasata-rabota/jaknene-svest-i-kampani/325-eden-do-drug-razlicni-a-ednakvi.html>

28 <http://www.mcms.org.mk/mk/za-nasata-rabota/jaknene-svest-i-kampani/325-eden-do-drug-razlicni-a-ednakvi.html>

Lidhja)<sup>29</sup>.

Vitin e njëjtë OSBE inician formimin e grupit joformal, me përfaqësues nga institucione të ndryshme që filloi të punojë në versionin e tretë të ligjit për anti-diskriminim. Polio plus, në bashkëpunim me OSBE, krijon trup të gjerë koordinues për shkëmbim të informatave për zhvillim të konceptit të anti-diskriminimit, më vonë i emëruar në Trupi koordinues nacional për jo diskriminim (TKND) (nr. 3, fotografia 1). Një nga prioritetet kryesore të këtij trupi është puna në tekstin e propozimit të ligjit për jo diskriminim, duke përfshirë komentet dhe vërejtjet nga përfaqësues të gjitha instancave të kyçura. Trupin e përbëjnë përfaqësues nga organizata qytetare, Qeveria, ministritë përgjegjëse, Avokati i Popullit, Kuvendi dhe komisionet kompetente, mediat dhe bashkësia ndërkombëtare. Qëllimi i këtij trupi është të zhvillohet politika anti-diskriminuese në Maqedoni përmes aktivitetit koordinues të institucioneve qeveritare, sektorit civil, opinionit ekspert, bashkësisë ndërkombëtare, mediave dhe ekspertëve nga fusha e të drejtave të njeriut.<sup>30</sup> Trupi nuk i inkuadron përfaqësuesit e partive politike, por përfshinë deputet nga partitë relevante politike. Në këtë viti Qeveria akoma nuk e planifikon miratimin e ligjit anti-diskriminues, por që në vitin 2008, të shtyrë nga Unioni Evropian, MPPS krijon grup punues (nr. 4, fotografia 1) që fillon të punojë në propozim-ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjatë vitit 2009 Trupi koordinues nacional për jo diskriminim punon në mënyrë intensive në tekstin e ligjit, duke futur sugjerime në masë të madhe nga organizatat qytetare. Një nga kontributet kryesore të shoqërisë civile drejt propozimit ligjor është tipi i organit, në kompetencë të cilit do të jetë ballafaqimi me diskriminimin. Në të vërtetë, teksti i propozimit të ligjit në të cilin punon grupi punues i MPPS në versionin e përpunuar në shtator të vitit 2009 (nr. 13 fotografia 1) parasheh që organi shtetëror i cili do të punojë në sanksionimin e diskriminimit në vend të jetë byro në kuadër të MPPS. Si rezultat i anëtarësimit të përfaqësuesve të sektorit civil në grupin e njëjtë punues, TKND është informuar për formulimin e këtyre të trupit dhe fillon të llojë për ndryshime të statusit të njëjtit<sup>31</sup>. Tre organizatat qytetare, Lidhja MPD, Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur –Maqedoni dhe KHM, përgatisin komente me propozim për formimin e komisionit, që është pranuar dhe hynë versioni i atëhershëm punues i propozim-ligjit<sup>32</sup> (nr. 13, fotografia 1).

Gjatë viteve 2008 dhe 2009 TKND kryen takime të rregullta në të cilat diskutohet për propozimet ligjore, jepen vërejtje, komente dhe sugjerime dhe arrin të bëjë ndikim të madh mbi versionin e fundit të propozim ligjit që dorëzohet për miratim në qeveri (nr. 23, fotografia 1). Por, procesi i bashkëpunimit mes Qeverisë dhe shoqërisë civile has në frenim të paparaparë në momentin kur ky version i ligjit e braktis tryezën e përbashkët dhe hy në procedurë qeveritare. Në të vërtetë, në shkurt të vitit 2010, dy muaj prej kur llogaritet

29 <http://www.equal.org.mk/MK/Koalicija.html>

30 Për listën e plotë të anëtarëve të trupit koordinues, shih te: <http://www.equal.org.mk/MK/KoordinativnoTelo.html>

31 Programi për punë 2011-2013, fq. 6, Trupi koordinues nacional për jo diskriminim, Shkup, nëntor 2010

32 Ibid.

se është përpunuar ky version i propozim ligjit dhe i cili përmban 62 nene, propozim ligji dorëzohet deri te komisionet kompetente në Kuvend. Por, versioni që hy në procedurë të Kuvendit (nr. 24 fotografia 1) ka 41 nene, 21 nene më pak se versioni i nëntorit dhe sipas një numri të madh të intervistuarve është vlerësuar si version “i masakruar”<sup>33</sup>, “i copëtuar”<sup>34</sup>, “i kasapitur”<sup>35</sup> i ligjit.

Si reagim i intervenimit të këtillë qeveritar në tekstin e propozim ligjit, grupi prej 48 organizatave qytetare<sup>36</sup> shtrojnë kërkesë (nr. 25, fotografia 1) deri te Qeveria që ta tërheqë versionin e fundit të Ligjit për pengim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe ta fusë në procedurë propozim ligjin që është përpunuar si rezultat i bashkëpunimit mes organizatave qytetare dhe institucioneve qeveritare (nr. 23, fotografia 1). Kërkesa shënon më shumë ndryshime thelbësore të cilat janë bërë në versionin e parafundit të ligjit, që është përpunuar në koordinim mes përfaqësuesve të sektorit qytetare dhe institucioneve qeveritare. Disa nga këto vërejtje janë: fshirja e definicionit të termeve themelore; bashkëngjitja dhe përzierja e anëtarëve të cilët kanë të bëjnë me masat afirmative, veprimi jo i barabartë që nuk llogaritet për diskriminim dhe masat mbrojtëse për grupe të caktuara të njerëzve; ndryshime të statusit dhe kompetenca e komisionit, që është riemërtuar nga Komisioni për barazi në Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi dhe të cilit i është zvogëluar fuqia; dhe vështirësimi i procedurës gjyqësore për shkak të hedhjes së mundësisë për padi të veçantë për diskriminim. Kërkesa shpallet si shpallje e paguar në mediat e shkruara dhe gjithashtu është transmetuar nga ana e mediave elektronike.

Kërkesa nuk has në pritje të mirë te Qeveria, pas çka disa nga organizatat qytetare, si Koalicioni për të drejta seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara<sup>37</sup>, drejtohen nga opozita dhe vendosin teksti i propozim ligjit (nr. 23, fotografia 1) t’ia dorëzojnë deputetëve të opozitës të cilët e propozojnë si ligj paralel për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Më 24 shkurt 2010 grup prej 24 deputetëve nga LSDM, PLD, PRSD, PL, DR dhe AR shtrojnë propozim ligj për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (nr. 23, fotografia 1) me procedurë të shkurtuar<sup>38</sup>. Në kuadër të komisioneve për punë dhe politikë sociale dhe Komisionit ligjdhënës-juridik është votuar si i papranueshëm dhe me këtë është hedhur poshtë nga shumica në pushtet në Kuvend<sup>39</sup>.

Me këtë një numër i madh i organizatave qytetare me qëllim të shprehjes së revoltit ndaj raportit të Qeverisë dhe “copëtimit” të tekstit të Ligjit tërhiqen nga mundësia e mëtejshme për ndikim të Ligjit. Nga ana tjetër, disa anëtare të Lidhjes MPD, siç janë MCMS

33 Aleksandar Kërzhallovski, intervistë me autorin

34 Zharko Trajanovski, intervistë me autorin

35 Natasha Postollovska, intervistë me autorin

36 Kërkesë deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë si propozues i Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi <http://soros.org.mk/default.asp?lang=mak&menuid=1586/> [http://www.coalition.org.mk/index.php?option=com\\_content&task=view&id=157&Itemid=82](http://www.coalition.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=157&Itemid=82)

37 Sllavčo Dimitrov, Zharko Trajanovski, intervistë me autorin

38 <http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?id=1dd6454f-70d4-4dd6-b928-08b0957b425d>

39 <http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?id=1dd6454f-70d4-4dd6-b928-08b0957b425d>

dhe Polio plus vendosin të vazhdojnë të bëjnë ndikim për përmirësimin e legjislacionit nacional përmes lobimit të pushteti ekzekutiv dhe ligjdhënës. Këto organizata qytetare përgatisin propozime amendamente të cilat kanë të bëjnë në disa pjesë të propozim-ligjit që paraprakisht janë fshirë dhe punojnë në përmirësimin e tekstit të propozim ligji<sup>40</sup>. Ata përpilojnë listë të amendamenteve (nr. 32, fotografia 1) prej të cilave 13 (më vonë të sublimuara në 11) të vlerësuara si amendamente me prioritet të lartë pranohen dhe propozohen nga ana e deputetëve të partive në pushtet<sup>41</sup>. Hapa të ngjashme ndërmarrin edhe disa instanca ndërkombëtare, siç janë OSBE (nr. 29 dhe 34, fotografia 1). Më 8 prill 2010 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miraton Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (nr. 35, fotografia 1).

Nevoja për miratimin e këtij ligji medoemos ishte imponuar edhe nga procesi i integritetit të Maqedonisë në BE. Mosekzistimin e politikës shtetërore për ballafaqimin me diskriminimin, Komisioni Evropian e shënoi që në Raportin për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2006<sup>42</sup>, por që nga viti 2007 në çdo raport shkruan për nevojën e miratimit të ligjit të veçantë, me të cilin do të institucionalizohen masat anti-diskriminuese dhe mekanizmat për ballafaqimin me politikën dhe sjelljet diskriminuese. Raportet prej vitit 2008-2010 veçanërisht theksojnë se diskriminimi në të cilin janë të ekspozuar homoseksualët, biseksualët dhe transseskualët, e prej këtu edhe nevoja nga ligji i përgjithshëm për pengimin e diskriminimit qartë ta evidentojë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë për diskriminim.<sup>43</sup> Raportet gjithashtu identifikojnë se pakicat, bashkësia rome, personat me nevoja të veçanta janë grupe që më së shumti pësojnë nga diskriminimi. Ligji i miratuar është vlerësuar si përparim i pjesshëm në politikën për pengimin e diskriminimit<sup>44</sup>. Sipas Komisionit Evropian, ky ligj pëson nga dy probleme kryesore. I pari është mos identifikimi i orientimit seksual si bazë për diskriminim. Problemi i dytë kryesor është mekanizmi i dobët për ballafaqimin nga diskriminimi. Gjithashtu është vlerësuar se sugjerimet e sektorit civil dhe bashkësisë ndërkombëtare nuk janë përfshirë në ligjin e miratuar

### » **Diskriminimi dhe Ligji për mosdiskriminim në mediat**

Para se të iniciohet miratimi i Ligjit, tema e diskriminimit nuk është prezent në mediat dhe fillon të paraqitet në tekstet gazetareske si rezultat i aktiviteteve dhe paraqitjeve publike të organizatave qytetare. Në prill të vitit 2009, kur Ligji ende ishte në përgatitje, mediat

40 Aleksandar Kërzhhalovski, Zvonko Shavreski, intervistë me autorin

41 Aleksandar Kërzhhalovski, Zvonko Shavreski, intervistë me autorin, stenogram nga mbledhja e 100-të e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, vazhdimi 2, 8 prill 2010, <http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?ld=3bbeadbb-0005-4315-982a-adb550867724>

42 Raport për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2006, fq. 44 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControllID=IzvestaiEU.ascx>

43 Raport për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2007, fq. 17 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControllID=IzvestaiEU.ascx>

44 Raport për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2010, fq. 16 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControllID=IzvestaiEU.ascx>

raportuan për nevojën nga miratimi i Ligjit për anti-diskriminim dhe kushtëzimi i heqjes së regjimit të vizave për Maqedoninë me miratimin e një ligji të këtillë. Më shumë media theksuan nevojën nga përpunimi dhe plotësimi i definicioneve në ligj, lobimi i organizatave qytetare për statusin e pavarur për komision, si edhe fakti se Ligji në këtë gjendje nuk i plotëson as standardet evropiane, e as ndërkombëtare.

Në periudhën kur Ligji arrin në Kuvend, fillimi i vitit 2010, dukshëm ndryshon mënyra e raportimit të mediave. Raportimi për ligjin bëhet sensacionale, gjatë së cilës lajm kryesor bëhet lërja anësh e orientimit seksual si bazë për diskriminim, ndërsa anashkalohen ndryshimet thelbësore të cilat ligji i përjeton si rezultat i shkurtimeve të një të tretës të dispozitave. Ligji trajtohet si ligj homofobik, ligj mungesa kryesore e të cilit është anashkalimi i orientimit seksual si bazë për diskriminim. Për këtë kontribuojnë edhe paraqitjet publike të përfaqësuesve të Bashkimit Evropian. Mediat përqendrohen në paraqitjet e ambasadores së Holandës, Simone Filipini dhe euro deputetes Ulrike Lunaçek. Në atë masë ku disa organizata nga sektori civil marrin pjesë në inkorporimin e tyre në diskutimin publik, pa vetëdije kontribuojnë për defokusimin e debatit publik nga ndryshimet tjera thelbësore në ligj. Personat e intervistuar e interpretojnë objektivizmin e mediave gjatë raportimit. Derisa disa<sup>45</sup> kanë vërejtje për anësinë e mediave me sentiment antiqeveritar ose pro-qeveritar në trajtimin e tematikës, të tjerët<sup>46</sup> mendojnë se me përjashtim të mediave të caktuara pro-qeveritare, raportimi i mediave ka qenë pothuaj neutrale.

Por, edhe krahas nevojës së mediave për paraqitjen sensacionale të një pjese nga problemet e Ligjit për jo diskriminim, nuk duhet të lihet anësh kontributi i tyre për aktualizimin e kësaj teme. Në shkurt të vitit 2010 mediat kushtojnë vëmendje të rëndësishme kërkesës së 47 organizatave qytetare deri te Qeveria për tërheqjen e propozimit të ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Me këto aktivitete të organizatave qytetare dhe mbulimi medial i të njëjtave njoftohet “loja me” organizatat qeveritare nga ana e Qeverisë. Përmes mediave, opinioni njoftohet me rëndësinë e diskriminimit si problem në shoqëri dhe roli të cilin shoqëria civile e kryen në këtë kontekst. Ligji për jo diskriminim edhe më tej mbetet temë interesante për mediat të cilat në vazhdimësi e transmetojnë kritikën e organizatave qytetare për mungesat e ligjit.

## DISKUTIM

Ky rrëfim e vendosi tezën se shoqëria civile do të ketë sukses të ndikojë mbi politikën nacionale vetëm nëse i drejton kërkesat e veta drejtpërdrejtë deri te vendimmarrësit kryesor nga partia në pushtet. Përpjekja kryesore e një partie është të vijë në pushtet që ti realizojë politikën e veta. Shoqëria civile në Maqedoni realizon më shumë funksione, por

45 Bekim Kadriu, Elena Grozdanova, Gordana Nestorovska, Aleksandar Kërzhhalovski, intervistë me autorin

46 Nade Naumovska, Sllavčo Dimitrov, intervistë me autorin

hulumtimet tregojnë se kjo më shumë aktivizohet me qëllim të realizimit të ndikimit mbi politikat publike dhe ka efekte nga ndikimi i këtillë.<sup>47</sup> Ligji për shoqata dhe fondacione është shkruar në bashkëpunim me organizatat qytetare, që flet se në kushte të mos largimit ideologjik, pushteti dhe shoqëria civile gjejnë mirëkuptim të përbashkët. Por, në rastin me Ligjin për jo diskriminim, largesa ideologjike mes partisë në pushtet dhe një pjese të caktuar të shoqërisë civile është shumë e madhe që të mos drejtohet drejtpërdrejt. Prandaj është problematike që organizatat qytetare në Maqedoni nuk i identifikojnë partitë politike si qëllime për lobim. Asnjë nga të intervistuarit nuk ka realizuar takim me partitë politike si entitete të veçanta dhe nuk i percepton partitë si faktorë ndaj të cilëve duhet ti orientojnë aktivitetet e tyre për lobim.


Rastin konkret e karakterizojnë dy elemente. Edhe krahas aktivitetit të madh dhe inkuadrimit të shoqërisë civile në krijimin e legjislacionit nacional për jo diskriminim, kjo nuk arrij të kryejë ndikim mbi propozimin qeveritar. Por, përmes shtrimit të kërkesave të veta deri te pushteti ligjdhënës, kjo arrin ta ndryshojë tekstin e ligjit. Situata mund të shihet edhe përmes aktorit tjetër. Nga njëra anë, pushteti e hedh poshtë kontributin e madh të shoqërisë civile në krijimin e politikës nacionale për jo diskriminim, nga ana tjetër, pushteti e pranon ndikimin e shoqërisë civile edhe në procedurat parlamentare i mundëson të bëjë ndikim thelbësor me futjen e trembëdhjetë amendamenteve me prioritet të lartë. Pse raporti mes shoqërisë civile dhe pushtetit ndryshon gjatë procesit.

Gjatë krijimit të ligjit, TKND paraqiste platformë për negociim për sugjerime me të gjithë aktorët e inkuadruar, duke përfshirë edhe përfaqësues të lartë të MPPS, ministri e cila edhe në mënyrë formale dhe normative është propozues i ligjit. TKND gjithashtu inkuadron edhe dy deputetë nga VMRO-DPMNE nga komisionet relevante në Kuvend. Sektori civil, nga ana tjetër, ka përfaqësues të tij në grupin punues të MPPS. Grupi punues, gjithashtu, u mundëson qasje organizatave qytetare për sugjerime dhe propozime, të cilat në masë të madhe edhe janë pranuar. Grupi punues, si edhe përfaqësuesit e pushtetit në TKND i paraqesin qëndrimet e Qeverisë dhe gjatë “negociatave” ata në emrin e Qeverisë ngadalë i zhvendosin pozitat e tyre nga pozita tejet e djathtë. Gjegjesisht, nga pozita e cila kërkon trup të dobët shtetëror për diskriminim, drejt pozitës tejet të majtë që mes tjerash parasheh komision të pavarur për barazi me kapacitet të vet financiar dhe administrativ.

Shoqëria civile negocion me këta përfaqësues të shtetit. Por, pafuqia relative e këtyre përfaqësuesve në krijimin e politikës anti-diskriminuese zbulohet kur Qeveria në vend ta dorëzojë në Kuvend “versionin e shoqërisë civile” të ligjit, shkurton një të tretën e të njëjtit, me çka praktikisht i hedh poshtë pothuaj të gjitha sugjerimet e organizatave qytetare. Me këtë ligji kthehet nga pozita e arritur tejet e majtë, prapa në pjesën e fundme të djathtë të vijës (versioni qeveritar i ligjit). Kjo tregon se krijuesit real të legjislacionit anti-diskriminues qeveritar nuk gjenden në trupat shtetërore, të cilët kenë këtë sferë në kompetenca të veta, por në kuadër të strukturave partiake të VMRO-DPMNE, të cilët i krijojnë politikat e

47 Civikus – Indeksi i shoqërisë civile, fq. 85

saja ideologjike dhe programore. Gjithashtu, këtu bëhet ndarja në qasjen ndaj procesit në kuadër të vetë shoqërisë civile. Një pjesë e caktuar e tyre tërhiqen nga procesi, duke e identifikuar qeverinë si kundërshtar të vetin ideologjik, pushtet i cili udhëheq politikë jo kompatible me të drejtat e njeriut<sup>48</sup>, ndërsa një pjesë mendon se më mirë është të vazhdohet me ndikim mbi propozim-ligjin, se sa të lihet si i tillë<sup>49</sup>.



### Fotografia 1: Pozitat e aktorëve të inkuadruar lidhur me Ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Në të vërtetë, siç pamë më sipër, si dhe nga qëndrimet të cilat përfaqësuesit qeveritar o mbrojnë gjatë krijimit të ligjit, VMRO-DPMNE preferon politikë të mbrojtjes më të dobët të drejtave të njeriut. Në mënyrë plotësuese, në suaza të kësaj partie ekziston bindja se fitimi i mandatit të sigurt të zgjedhjeve u jep pozitë relativisht monopole në krijimin e politikave nacionale, derisa moszgjidhja e organizatave qytetare ua merr autoritetin të njëjtëve të imponojnë politika.<sup>50</sup> Perceptimi i këtillë i organizatave qytetare anashkalon se partitë politike nuk mund të jenë zëvendësim i shoqërisë civile, mes tjerash edhe për shkak të lidhjeve sociale të cilat i kanë, dhe të cilat partitë politike nuk i kanë ndërtuar<sup>51</sup>. Ky konstalacion i raporteve dhe qëndrimeve flet se organet dhe trupat shtetërore nuk kanë fuqi të mjaftueshme që ti imponojnë zgjidhjet eksperte të pushtetit. Më saktë, partia në pushtet do ti injorojë kapacitetet eksperte të administratës shtetërore, kontributi i shoqërisë civile, si dhe kërkesat e Bashkimit Evropian, nëse këto kërkesa janë në drejtim të zhvendosjes më të madhe të dëshirave të saja në drejtim të kundërt. Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian insistojnë shumë për inkuadrimin e “orientimit seksual” si bazë për diskriminimin<sup>52</sup>, por pozita e këtillë është shumë larg nga qëndrimi konservativ të VMRO-DPMNE, në radhët të cilit ekziston edhe besimi se homoseksualiteti është sëmundje<sup>53</sup>.

48 Sllavčo Dimitrov, intervistë me autorin

49 Natasha Postollovska, intervistë me autorin

50 Intervistë me deputet të VMRO-DPMNE, anonime

51 Grugel, J. (2003) *Democratization: A Critical Introduction*. New York: Palgrave Macmillan. p.211

52 Risteski, M.A. (2010, 22 shkurt) BE: Futni orientimin seksual në Ligj. A1 televizioni. <http://www.time.mk/read/ofc7849b6b/b3ae8eeoaf/index.html>, Qasur më: 16 dhjetor 2010

53 Shënime stenografike nga mbledhja e njëzetë e Komisionit anketues në Kuvendin e republikës së Maqedonisë të mbajtur më 16.03.2010, Deputeti Jovan Ginev, VMRO-DPMNE, fq. 6 <http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?Id=1dd6454f-70d4-4dd6-b928-08b0957b425d>

Mosinkuadrimi i orientimit seksual si bazë për mbrojtje nga diskriminimi arsyetohet me besimin se kjo është hyrje në legalizimin e martesave homoseksuale dhe adoptimi i fëmijëve nga ana e çifteve homoseksuale, që është në kundërshtim me vlerat konservative demo-krishtere të partisë<sup>54</sup>. Por, ajo që partia nuk e vëren është se vetëm insistimi i këtillë i rreptë të mos futet orientimi seksual si bazë për mbrojtje nga diskriminimi, është trajtim diskriminues i një grupi të caktuar.

Por, megjithatë procesi parlamentar i miratimit të ligjit zbulon dimensione të reja. Nga njëra anë, pushteti përjeton presion nga bashkësia ndërkombëtare. Përfaqësues të Bashkimit Evropian ua theksojnë mungesat e propozim-ligjit dhe kërkojnë të kryhen ndryshime thelbësore. Reagimet e organizatave qytetare e okupojnë hapësirën mediale dhe zbardhet raporti joparimor i qeverisë ndaj shoqërisë civile. Situatën e këtillë e shfrytëzon një pjesë e shoqërisë civile dhe arrin ta zhvendos propozim-ligjin nga e djathta drejt të majtës dhe drejt optimumit të mesëm.

Pse theksohet roli i VMRO-DPMNE-së në raport me rolin e BDI-së? Në të vërtetë, edhe krahas asaj që MPPS është e udhëhequr nga ministër i BDI-së, pjesëmarrja dhe ndikimi i kësaj partie në krijimin e këtij ligji është minimale. Nga ana e të intervistuarve, pjesëmarrja e tyre është përshkruar si “e barabartë me zero”<sup>55</sup>, gjegjësisht si mungues nga debati për ligjin<sup>56</sup>. Mosinkuadrimi i këtillë i BDI shihet edhe përmes mospjesëmarrjes në diskutimet parlamentare, ku mbrojtjen e propozimit qeveritar e udhëheqin deputetë të VMRO-DPMNE. Më në fund, në procesin e plotësimit të “versionit qeveritar të ligjit” kur dy organizata qytetare vazhdojnë të negociojnë për plotësimet amendamente të Ligjit, negociatat i udhëheqin me ministra të VMRO-DPMNE<sup>57</sup>. Qëndrimi i BDI është se Ligji ka lëshime, për çka duhet të bëhen ndryshime<sup>58</sup>, por gjatë krijimit të tij, partia nuk ndërmer hapa për përmirësimin e tij.

Pa dyshim duhet të shtrohet edhe pyetja nëse bëhet fjalë për trajtim të VMRO-DPMNE ndaj shoqërisë civile dhe konkretisht ndaj kësaj politike anti-diskriminuese, ose raport klasik i partisë në pushtet ndaj faktorëve të cilët dëshirojnë ta kufizojnë fuqinë e saj. Në të vërtetë, disa nga të intervistuarit theksuan mosvullnetin e LSDM të miratojë ligj për jo diskriminim gjatë mandatit të tyre<sup>59</sup>. Përvoja e organizatave qytetare është se partitë janë kooperative dhe të hapura për iniciativat e tyre kur janë në opozitë, por të shurdha kur do të vijnë në pushtet<sup>60</sup>. Për çdo rast, edhe krahas parimeve të deklaruara dhe përcaktimit strategjik të Qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile, në këtë rast Qeveria i shkel

54 A janë të diskriminuar homoseksualët? (2010) Video incizim. A1 televizioni, studio 2, deklaratë e Vlladimir Gjorçev

55 Sllavčo Dimitrov, intervistë me autorin

56 Bekim Kadriu, Gordana Nestorovska, intervistë me autorin

57 Zvonko Shavreski, intervistë me autorin

58 Popovska, T. (2010, 15 prill) Letrat nga BE nën tepih. Dnevnik. <http://www.dnevnik.com.mk/?itemID=B3A148CFC9DBF94DBDE38C5F1AD9B8E7&arc=1> Qasur më: 16 dhjetor 2010

59 Gordana Nestorovska, intervistë me autorin

60 Nade Naumovska, Gordana Nestorovska, Zvonko Shavreski, intervistë me autorin

ato parime. Partia në pushtet e vlerëson kontributin e shoqërisë civile varësisht nga ajo sa i shërben interesave të saja. Parlamenti shpreh gatishmëri të madhe për kërkesat e shoqërisë civile dhe hapësirë ku mund të kryhet ndikimi më i madh.

## PËRFUNDIM

Procesi i krijimit të Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi paraqiste shembull për bashkëpunimin pozitiv mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile. Por, pushteti e lajti shoqërinë civile, duke vendosur përfaqësues pa autoritet në procesin e negociatave. Shteti ka përgjegjësi të madhe të jetë partner kooperativ i shoqërisë civile.<sup>61</sup> Prandaj hedhja poshtë e kontributit të shoqërisë civile në emër të mandatit të fituar në zgjedhje për realizimin e politikave personale nuk kontribuon për zhvillimin e demokracisë. Me hedhjen poshtë të mundit dhe rolit të shoqërisë civile, pushteti e delegjtimon politikën e vet për të drejtat e njeriut dhe e zbraps kualitetin e demokracisë<sup>62</sup>. Nga ana tjetër, degët dhe segmentet e ndryshme nga pushteti tregojnë shkallë të ndryshme të qenurit të hapur ndaj shoqërisë civile. Hapja e Kuvendit mundëson në masë të caktuar të sanohet dëmi që propozimit ligjor i është bërë në komisionet qeveritare.

Aktivizimi i shoqërisë civile maqedonase në drejtim të krijimit të legjislacionit anti-diskriminues tregoi se kjo ka kapacitet të madh dhe ekspertizë në fushën e të drejtave të njeriut. Shoqëria civile kryen rol të pazëvendësueshëm në ngritjen e vetëdijes për ekzistimin dhe nevojën për tejkalimin e diskriminimit në vend. Por, kjo e nënvlerësoi rolin dhe fuqinë e organeve kompetente shtetërore dhe format institucionale të ndikimit. Ky studim tregoi se një pjesë e shoqërisë civile nuk e orientoi ndikimin e vet ndaj krijuesve kryesor të politikave dhe për këtë shkak nuk arriti sa duhet ti afrojë qëndrimet e pushtetit ndaj qëndrimeve të veta. Një pjesë tjetër e shoqërisë civile u orientua drejt Kuvendit si bartës i ligjeve dhe i afroji qëndrimet e pushtetit drejt qëndrimeve të veta. Me këtë krijohet ligj që paraqet optimum të mesëm mes pjesës së shoqërisë civile dhe partisë në pushtet.

61 Howard, M. M. (2003) *The Weakness of Civil Society in Post-Communist Europe*, Cambridge: Cambridge University Press p.14


62 Grugel, J. (2003) *Democratization: A Critical Introduction*. New York: Palgrave Macmillan. p.115

## Bibliografia

- Black, D. (1948) On the Rationale of Group Decision-making. *Journal of Political Economy*, 56(1), 23-34
- Centre for Civil Society, London School of Economics and Political Science, What is Civil Society?, [http://www.webarchive.org.uk/wayback/archive/20100820110531/http://www.lse.ac.uk/collections/CCS/introduction/what\\_is\\_civil\\_society.htm](http://www.webarchive.org.uk/wayback/archive/20100820110531/http://www.lse.ac.uk/collections/CCS/introduction/what_is_civil_society.htm)
- Diamond, L. (1994). Rethinking Civil Society: Towards Democratic Consolidation. *Journal of Democracy*, 5(3), 4-17
- Fioramonti, L. & Heinrich, V.F. (2007) How Civil Society Influences Policy: A Comparative Analysis of the CIVICUS Civil Society Index in Post-Communist Europe [www.civikus.org/new/media/CIVICUS.ODI.Fioramonti.Heinrich.pdf](http://www.civikus.org/new/media/CIVICUS.ODI.Fioramonti.Heinrich.pdf)
- Gerring, J, (2006) *Case Study Research: Principles and Practices*. New York: Cambridge University Press
- Grugel, J. (2003) *Democratization: A Critical Introduction*. New York: Palgrave Macmillan.
- Howard, M. M. (2003) *The Weakness of Civil Society in Post-Communist Europe*, Cambridge: Cambridge University Press
- Kacarska, S. (2008) *Organizatrat qytetare në republikën e Maqedonisë – Lidhja mes shtetit dhe opinionit ose entitet i izoluar? Analiza e situatës në periudhën 1990-2007*, Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Kopecy, P., Mudde C. Eds. (2002) *Uncivil Society? Contentious Politics in Post-Communist Europe* London, New York: Routledge
- Patton, M. Q. (2002) *Qualitative Research and Evaluation Methods* California: Sage
- Civikus: Indeksi i shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë; Pas 15 vjet tranzicion – nga stabilizimi drejt pjesëmarrjes qytetare. (2005) Shkup: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

# SHTOJCA 1<sup>63</sup>::

## RRJEDHJA KOHORE E PËRGATITJES SË MIRATIMIT TË LIGJIT PËR PENGIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



- 7.2008 6 Propozimi i dytë i LMD i prodhuar nga MPPS (versioni i dytë).
- 9.2008 7 TPropozim i tretë i LMD i prodhuar nga MPPS.  
\*Gjatë vitit 2008 grupi punues takohet pesë herë.  
MPPS me ndihmën e OSBE në periudhën shtator-tetor organizoi gjashtë debate publike rreth tekstit të propozim-ligjit.
- 2009
- 3.2009 8 NPAA për vitin 2009 e vendos miratimin e LMD si prioritet për vitin 2009, me afat për miratim deri 30 qershor 2009..
- 14.4.2009 9 Këshilli nacional për euro integrimi (KNEI) organizon debat publik për tekstin punues të ligjit për mbrojtje nga diskriminimi (LMD).  
\* E thekson nevojën për përpunim serioz të tekstit punues të LMD.
- 6.2009 10 Grupi punues në MPPS përpunon version të PARË punues të ligjit të parë për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.
- 16.6.2009 11 TU formalizua koalicioni për jo diskriminim në Lidhja Maqedonia pa diskriminim (MBD).
- 1.9.2009 12 MPPS e përpunon versionin e DYTË punues të LPMD.  
\*Ligji parasheh byro për mbrojtje dhe evokim në kuadër të MPPS.
- 9.2009 13 Lidhja MBD reagon me mbajtjen e mbledhjes së Trupi koordinues nacional për jo diskriminim (TKNJ) sipas të cilit, me intervenim të një pjese të deputetëve të pranishëm është tërhequr nga procedura qeveritare për shkak të këshillimeve me organizatat qytetare.
- 10.9.2009 14 Shefi i Misionit vëzhgues të OSBE në Shkup takohet me ministrin e Punës dhe Politikës Sociale dhe e këshillon që MPPS të mos shpejtojë me përpunimin e ligjit dhe ti pres komentet nga Komisioni i Venedikut dhe OSBE/ODIHR.
- 15 Misioni vëzhgues i OSBE në Shkup e dërgon tekstin nga versioni dytë punues deri te Komisioni i Venedikut dhe deri te OSBE/ODIHR për komente.

- 12.9.2009** **16** Lidhja MBD realizon takime me zëvendëskryeministrin Vasko Naumovski dhe me zëvendësministrin në MPPS, Spiro Ristovski, të shihen vërejtjet.
- 25.9.2009** **17** MPPS e dërgon tekstin e ligjit deri te Komisioni i Venedikut
- 30.9.2009** **18** Lidhja MBD në periudhën shtator-dhjetor 2009 punon në tekstin e ri të LPMD – më 30.09 u përgatit versioni i parë.  
08.10.2009 – Punëtori e MBD, Berovë.  
16.10.2009 – Janë inkuadruar vërejtje teknike.  
29.10.2009 – Janë inkuadruar vërejtjet nga FISHHM dhe OSBE dhe nga këshillimet me deputetët dhe Qeverinë.
- 13.10.2009** **19** OSBE/ODIHR bashkë me Misionin vëzhgues të OSBE në Shkup i shtroi komentet rreth versionit të dytë punues të ligjit. Të njëjtët janë shumë kritik, si rreth përmbajtjes, ashtu edhe rreth procesit të përgatitjes së ligjit.
- 19.11.2009** **20** TLidhja MBD prodhon version të pastruar të LPMD.
- 21.11.2009** **21** Në MPPS përbëhet grupi punues i MPPS. Diskutohet se sipas cilit version të LPMD do të punohet. Miratohet propozimi i Lidhjes MBD që të dorëzojë propozimin e et të tekstit të ligjit.
- 2.12.2009** **22** Këshilli drejtues i Lidhjes MBD e vërteton propozim-tekstin e ligjit dhe e dorëzon deri te MPPS.  
*\*Ky version përmban 62 nene dhe më vonë atij i referohet si version i Ligjit nga sektori civil.*
- 2010**
- 22.1.2010** **23** Në MPPS mbahet takim këshillues për LPMD në grup më të ngushtë punues me nga një përfaqësues nga Lidhja MBD, Avokati i Popullit dhe nga OSBE. **Vërtetohet se versioni i MBD (62 nene) me modifikime të vogla** (p.sh. “orientimi seksual” zëvendësohet me “orientim gjinor”) **do të dorëzohet për miratim në mbledhjen e ardhshme qeveritare.**

- 26.1.2010** **24** Qeveria vërteton dhe shtron deri te Kuvendi propozim-ligjin për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i cili **përmban 41 nene**.  
\*Komisioni për punë dhe politikë sociale (25.2.2010) dhe Komisioni ligjdhënës-juridik e miratojnë këtë propozim dhe e dorëzojnë për lexim të mëtejshëm.
- 16.2.2010** **25** Grupi prej 48 organizatave qytetare (duke përfshirë edhe dy anëtarët e Lidhjes MBD, MCMS dhe Meseçina) shtrojnë kërkesë që të tërhiqet ky version i propozim ligjit  
\* Ligji nuk është tërhequr nga procedura parlamentare.
- 18.2.2010** **26** Lidhja MBD thirri mbledhje të TKND, ku marrin pjesë deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita. Miratohen përfundime për intervenime amendamente.
- 22.2.2010** **27** Diskutim publik në Kuvend/Komisioni i përhershëm anketues për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut të qytetarit sipas këtij versioni të propozimit të LPMD  
\*Kërkon që Qeveria ta tërheq këtë propozim të ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.
- 24.2.2010** **28** Një grup prej 24 deputetëve nga opozita sipas procedurës së shkurtuar shtron version të dytë të LPMD (propozimi prej 62 nene që i ka përgatitur MBD).  
\*Propozimi është hedhur në mbledhjen e Komisionit të përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarit (16.3.2010) dhe të Komisionit për punë dhe politikë sociale (17.3.2010).
- 2.3.2010** **29** Mbahen seri të mbledhjeve mes OSBE dhe MPPS në nivele të ndryshme
- 4.3.2010** **30** Kuvendi e miraton propozim ligjin (41 nene) dhe e dorëzon për lexim të dytë.
- 8.3.2010** **31** Lidhja MBD realizon takime me zëvendëskryeministrin Naumovski (01.03) dhe zëvendësministrin Ristovski.
- 10.3.2010** **32** Lidhja MBD shtron listë prej 32 amendamenteve deri te MPPS dhe deputetët në Kuvend.

- 15.3.2010** **33** Propozim-ligji plotësohet me 13 prej propozimeve të Lidhjes MBD, prej të cilave 10 prej 13 janë shënuar me prioritet të lartë, të sublimuara në 11 amendamente.
- 17.3.2010** **34** Në kërkesë të MPPS, Misioni vëzhgues i OSBE në Shkup përpunon mendim të brendshëm rreth versionit të fundit të Ligjit që e dorëzon deri te ministri i Punës dhe Politikës Sociale.
- 8.4.2010** **35** TKuvendi e miraton LPMD në mungesë të opozitës me 73 vota për dhe asnjë kundër ose të përmbajtur.

## Materiale plotësuese:

- Kërkesë deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë si propozues i Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi <http://soros.org.mk/default.asp?lang=mak&menuid=1586/>  
[http://www.coalition.org.mk/index.php?option=com\\_content&task=view&id=157&Itemid=82](http://www.coalition.org.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=157&Itemid=82)
- A janë të diskriminuar homoseksualët në Maqedoni? (2010) Video material. A1 televizioni, studio 2
- Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2006 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControlID=IzvestaiEU.ascx>
- Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2007 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControlID=IzvestaiEU.ascx>
- Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2008 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControlID=IzvestaiEU.ascx>
- Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2009 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControlID=IzvestaiEU.ascx>
- Raporti për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2010 <http://www.sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControlID=IzvestaiEU.ascx>
- Popovska, T. (2010, 15 prill) Letrat nga BE nën tepih. Dnevnik. <http://www.dnevnik.com.mk/?itemID=B3A148CFC9DBF94DBDE38C5F1AD9B8E7&arc=1> Qasur më: 16 dhjetor 2010
- Programi i VMRO-DPMNE për rilindje 2008-2010 (2008) [www.vmro-dpmne.org.mk](http://www.vmro-dpmne.org.mk) Qasur më: 10 korrik 2010
- Propozim-ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (2005) fq. 3 <http://www.mcms.org.mk/mk/za-nasata-rabota/jaknene-svest-i-kampani/325-eden-do-drug-razlicni-a-ednakvi.html>  
<http://www.equal.org.mk/MK/Koalicija.html>
- Programi për punë 2011-2013 (2010) Trupi koordinues nacional për jo diskriminim. Lidhja Maqedonia pa diskriminim. Shkup
- Risteski, M.A. (2010, 22 shkurt) BE: Inkorporoni orientimin seksual në Ligj. A1 televizioni. <http://www.time.mk/read/ofc7849b6b/b3ae8eeoaf/index.html> Qasur më: 16 dhjetor 2010
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Këshilli Nacional për Eurointegritet <http://www.sobranie.mk/default.asp?ItemID=A07D12EADB4587448D37683C1A956001>
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Shënime stenografike nga mbledhja e njëzet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, vazhdimi 2, 8 prill 2010, <http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?Id=3bbeadb-0005-4315-982a-adb550867724>
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. (2010), Shënime stenografike nga mbledhja e njëzet e Komisionit anketues të Republikës së Maqedonisë e mbajtur më 16.03.2010.

Deklaratë e deputetit Jovan Ginev, VMRO-DPMNE. fq. 6 <http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?Id=1dd6454f-70d4-4dd6-b928-08b0957b425d>

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë <http://www.sobranie.mk/ext/materialdetails.aspx?Id=1dd6454f-70d4-4dd6-b928-08b0957b425d>

Strategjia për bashkëpunim e Qeverisë me sektorin civil (2007-2011). (2007) Shkup: Qeveria e Republikës së Maqedonisë – Sekretariati gjeneral <http://www.vlada.mk/?q=node/2>

Qasur më: 10 dhjetor 2010

# — **NDIKIMI I ORGANIZATAVE QYTETARE TE GRAVE NDAJ POLITIKAVE BUXHETORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË: BUXHETIM GJINORË** —

## **REZYME**

Lidhja e barazisë gjinore, statusit, pozitës dhe të drejtave të grave me krijimin e politikave buxhetore në Republikën e Maqedonisë është lëmi relativisht e re tematike në kuadër të veprimit të organizatave qytetare. Objekt i këtij studimi është procesi i promovimit të perspektivës gjinore në politikat buxhetore në nivel nacional nga ana e organizatave qytetare në kontekst të rolit dhe ndikimit të cilin ato e kanë në krijimin e politikave për buxhetim gjinorë sensitiv. Hipoteza se organizatat qytetare të grave kanë rol kyç në promovimin dhe përfaqësimin para institucioneve përgjegjëse për krijimin e politikave buxhetore sensitive gjinore u vërtetua si relevante. Përfundimi i cili rrjedh nga analiza e fakteve dhe ngjarjeve tregon se organizatat qytetare të grave kanë ndikim thelbësor në procesin e krijimit të politikave buxhetore gjinore në Republikën e Maqedonisë.

## **HYRJE**

Lidhja e barazisë gjinore, statusit, pozitës dhe të drejtave të grave me krijimin e politikave buxhetore në R. e Maqedonisë është dukuri relativisht e re në kuadër të veprimit të organizatave qytetare. Interesi për këtë lidhshmëri mundet ta detektojmë vetëm te organizatat qytetare të grave si një qasje të re dhe origjinale drejt çështjes së barazisë gjinore. Nevoja për mjete financiare për zbatimin e politikave specifike për barazi gjinore ishte vetëm momenti fillestar për zhvillimin e një qasjeje karakteristike drejt lidhjeve strukturale të parave, pushtetit dhe barazisë – u zhvillua qëndrimi se buxhetet nuk janë neutrale nga aspekti gjinor, prandaj edhe u shfaq nevoja për ndjekje sistemore të proceseve buxhetore.

Ky studim përfaqëson një përshkrim të shkurtër dhe vlerësim të rolit dhe ndikimit të organizatave qytetare të grave në krijimin e politikave buxhetore në R. e Maqedonisë. Studimi nuk ka pretendime të jep sqarim detajor të gjitha ndodhjeve që kanë të bëjnë me buxhetimin gjinorë, prandaj fokusi do të jetë në aktivitetet e disa organizatave qytetare të grave dhe puna e tyre si përfaqësuese të sektorit qytetar.

Objekt i hulumtimit ishte promovimi i perspektivës gjinore në politikat buxhetore në nivel nacional nga ana e organizatave qytetare të grave si pjesë e shoqërisë civile. Teksti duhet të përgjigjet pyetjes “Cili është roli dhe sa është ndikimi i shoqërisë civile, në veçanti të organizatave qytetare të grave në krijimin e politikave për buxhetim gjinor?”. Hipoteza fillestare ishte se organizatat qytetare të grave luajnë rol kyç në promovimin dhe përfaqësimin para institucioneve përgjegjëse për krijimin e politikave buxhetore gjinore.

Në fund, studimi do të mbaron me disa konkluzione dhe rekomandime për veprimin e mëtutjeshëm të organizatave qytetare të grave dhe sektorit civil më gjerësisht për çështje që kanë të bëjnë me buxhetimin gjinor.

### » **Metodologjia**

Principet e të drejtave të njeriut paraqesin udhëzues në gjitha fazat e procesit të hulumtimit, duke kyçur vlerësim dhe analize, planifikim dhe dizajn të hulumtimit dhe përgatitjen e studimit.

**Perspektiva gjinore:** Kyçja e perspektivës gjinore në procesin e vlerësimit të implikimeve për gratë dhe meshkujt në të gjitha aktivitetet e planifikuara, duke i kyçur edhe politikat dhe programet në gjitha sferat dhe në gjitha nivelet. Kjo është strategji për kyçjen e përvojave gjinore si dimension integral të dizajnit, implementimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore.

**Vlerësimi multi-kulturor i ndikimit:** Vlerësimi multi-kulturor i ndikimit ka për qëllim të analizojë efektet potenciale të politikave shtetërore (lokale apo qendrore) të marrëdhënieve multi-etnike.

**Teknikat e mbledhjes së të dhënave:** Mënyra bazike e mbledhjes së të dhënave ishte nëpërmjet intervistave. U realizuan intervista me përfaqësues të disa organizatave qytetare të grave dhe ekspertë të ndryshëm. Në të gjitha tre format e intervistave ishin të kyçur: intervista strukturale, gjysmë-strukturale dhe jo-strukturale. Me intervista të thella u hulumtuan të dhënat të cilat nuk mundeshin të hulumtohen me metodologji pozitive. Mënyra e dytë e mbledhjes së të dhënave bëhej nëpërmjet burimeve dytësore, siç janë dokumente apo informata elektronike.

**Burimet e mbledhjes së të dhënave:** Burim i rëndësishëm i të dhënave dhe informatave ishin dokumente të ndryshme, punime, hulumtime të pavarura dhe analizë e të dhënave të mbledhura.

Mbledhja e të dhënave u bë nëpërmjet bazës elektronike të medimeve të shtypura në Maqedoni, arkivat elektronike të lajmeve (Ena, Evro Ballkan)<sup>64</sup>. Deri më sot, në kuadër të bazës së të dhënave Ena janë arkivuar mbi 300.000 dokumente dhe kolumna nëpër gazeta dhe revista javore. Burime tjera të mbledhjes së të dhënave ishin Enti shtetëror për statistikë, baza të dhënave, ngjarje, konferenca, debate, prezantime dhe forma tjera të shkëmbimit të informatave.

Zhvillimi i veçës metodologjike për ndjekjen dhe mbledhjen e të dhënave në raport me zhvillimin dhe aplikimin e politikave specifike të RM-s për barazi gjinore dhe buxhetim dhe identifikimin e aspekteve gjinore dhe çështje në sektorët politik të cilët nuk janë nga fusha e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, zhvillohej në disa etapa. Së pari u bë shqyrtim i literaturës nga fusha e barazisë gjinore e cila merret me çështje hulumtuese nga fusha e buxhetimit gjinorë. Në etapën e dytë u caktuan çështje nga fusha e buxhetimit gjinorë. Në etapën e dytë u caktuan principet themelore të hulumtimit dhe analizës, burimet e informatave, hapat dhe teknikat e ndjekjes dhe mbledhjes së të dhënave.

**Analizë e vlerësimit të ndikimit:** Analiza e propozuar i identifikon problemet dhe intervenimet e politikave. Me analizën identifikohen opsionet e mundshme për arritjen e qëllimeve reale të politikave dhe analizohet ndikimi i tyre në fushat ekonomike, ekologjike dhe sociale. Me analizën theksohen përparësitë dhe mungesat e secilit opsion në politikat aktuale.

**Qasja e meta-analizës të politikave sektoriale:** Qasja e meta-analizës të politikave sektoriale ka për qëllim ti sqaron faktorët kontekstual të cilët ndikojnë në procesin politik, gjegjësisht me këtë analizë hulumtohet cilët faktorë politik, ekonomik dhe socio-kulturor ndikojnë në sjelljen e vendimeve të cilat kanë karakter politik.

**Korniza e vlerësimit:** Korniza e vlerësimit do të mbështetet në pesë kritere: adekuat, relevantë, efikas, efektiv dhe ndikim.

**Vlerësimi i ndikimit mbi gjininë:** Qëllimi i vlerësimit mbi gjininë është të identifikohen mundësitë e mundshme të politikave të analizuara mbi barazinë gjinore.

Studimi është përgatitur nëpërmjet hapave në vijim: Analizë e kontekstit të implementimit së idesë për politika buxhetore gjinore; Identifikim i organizatave nga sektori civil të kyçura në aktivitetet që kanë të bëjnë me buxhetimin gjinorë; Identifikimi i aktorëve tjerë aktiv në fushën e buxhetimit gjinor; Përgatitja e strukturës së intervistave dhe pyetësorëve; Implementimi i intervistave me organizata dhe aktorë; Shqyrtimi i aktiviteteve të realizuara që kanë të bëjnë me buxhetimin gjinor; Analizë e të dhënave nga aspekti thelbësor, procedural, struktural dhe sintetik; Formulimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve.

64 Arkiva elektronike e gazetave (EHA), [http://77.28.96.119/joomla/index.php?option=com\\_content&view=article&id=92&Itemid=56](http://77.28.96.119/joomla/index.php?option=com_content&view=article&id=92&Itemid=56), [Accessed dhjetor, 2010]

## » **Çka është buxhetimi gjinor**

Buxhetimi gjinor paraqet dëshirë politike dhe vendim në arritjen e barazisë gjinore. Buxhetimi gjinor donë të thotë zbatim të praktikave të kyçjes së perspektivave gjinore në proceset e buxhetimit. Kjo nuk donë të thotë vetëm buxhete të veçanta për gratë, por donë të thotë vlerësim të buxheteve nga aspekti i barazisë gjinore dhe kyçje të perspektivave gjinore në gjitha nivelet e procesit të buxhetit<sup>65</sup>.

Buxhetimi gjinor është proces nëpërmjet të cilit buxhetet publike hulumtohen me qëllim që të vlerësohet se sa e kyçin apo kontribuojnë për barazi mes burrave dhe grave, e me këtë të propozojnë ndryshime në drejtim të arritjes së barazisë gjinore. Analiza gjinore e buxheteve i ndihmon pushtetit të vendos për atë se si vendimet politike ti drejtojnë kah arritja e ndikimit maksimal, si edhe atë se ku duhet të alokohen resurset për tu arritur nivel më i lartë i zhvillimit njerëzor dhe barazi gjinore. Buxhetimi nuk është vetëm vegël financiare për balancimin mes anës së të ardhurave dhe të dalave. Si proces, gjithashtu paraqet metodë për vendosjen e prioriteteve dhe sjelljen e vendimeve për çështje që ndikojnë në situatën aktuale dhe atë të ardhshme të njerëzve dhe rrethinës së tyre. Planerët buxhetorë duhet të kenë njohuri mbi situatën, si edhe të jenë të vetëdijshëm për pasojat e vendosjes së prioriteteve që kanë ndikim mbi jetët e meshkujve dhe të grave.

Siç përmendëm buxhetimi gjinor nuk nënkupton krijimin e buxheteve të veçanta për femra, por nënkupton planifikimin dhe zbatimin e buxheteve që i marrin parasysh nevojat, prioritetet dhe problemet e femrave dhe meshkujve, si edhe rolet e tyre në kuadër të familjes, vendit të punës dhe bashkësisë. Injorimi i ndikimit gjinor nga buxhetet nuk është neutralitet, por verbësi gjinore e cila mundet të shkakton harxhime të mëdha njerëzore dhe ekonomike – produktivitet më të ulët, zhvillim më të ulët të kapaciteteve të njerëzve dhe nivele më të ulëta të mirëqenies së përgjithshme.

Iniciativat e buxhetimit gjinor munden të zbatohen në gjitha fazat e procesit të sjelljes së buxhetit: planifikimit, miratimit, zbatimit dhe revidimit. Qëllimet specifike janë në drejtim të forcimit të vetëdijes për ndikim gjinor të politikave dhe alokimet adekuate buxhetore, potencimi i dallimit mes alokimeve buxhetore dhe politike, detyrimin e pushtetit të jetë i përgjegjshëm në raport me përcaktimet e tyre për barazi gjinore dhe ndryshimin e politikave dhe buxheteve me çka do të ndihmohet në përmirësimin e statusit të grave, si edhe arritjen e barazisë gjinore. Qëllim i buxhetimit gjinor është krijimi i buxhetit në të cilin koncepti gjinor është zbatuar, gjë e cila është në drejtim të mbledhjes së të ardhurave dhe planeve për harxhim publik, me çka pasqyrohet distribuimi i barabartë i resurseve në drejtim të përfshirjes dhe kënaqjes të nevojave të grave dhe meshkujve.

Qeveria dhe ministritë përkatëse janë përgjegjëse për krijimin e politikave për arritjen e barazisë gjinore në sektorët e tyre. Këto politika duhet të pasqyrohen në strategjitë dhe

65 Drejtoria Gjenerale për të drejtat e njeriut (2005), Buxhetim gjinor, Raport final i Grupit për buxhetim gjinor (EG-S-GB), Strazbur, Available from: [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/o3themes/gender-mainstreaming/EG\\_S\\_GB\\_2004\\_RAPFIN\\_Macedonian.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/o3themes/gender-mainstreaming/EG_S_GB_2004_RAPFIN_Macedonian.pdf) [Accessed, dhjetor 2010]

programet e ministrive përkatëse dhe institucioneve përkatëse, si edhe në planifikimin e tyre strategjik dhe buxhetim, gjegjësisht të sigurojnë mjete adekuate buxhetore për zbatimin e politikave gjinore

### » **Strategji globale për barazi gjinore**

Me qëllim të eliminimit të barrierave në arritjen e barazisë gjinore në fushën e krijimit të politikave publike, duhet të ndërmerren hapa të caktuara dhe masa të cilat duhet ta ndryshojnë mënyrën e formulimit të politikave në sektorë, zbatimin e cikël projekteve dhe menaxhimin e punëve administrative. Me fjalë tjera, nëse barazia gjinore është karakteristikë strukturore dhe sistimore, atëherë duhet të bëhet ndryshim strukturor dhe sistematik në mënyrën e funksionimit të politikës buxhetore. Kërkesa për ndryshime të këtilla nuk është asgjë më tepër se sa kërkesa për demokratizimin e proceseve të krijimit të buxheteve publike.

Përvojat botërore nga aktivitetet e planifikuara dhe sistematike në realizimin e barazisë gjinore tregojnë se kryesisht ekzistojnë dy qasje dominonte. Ekziston e ashtuquajtura tradicionale si edhe qasja e ashtuquajtur perspektivë gjinore.

Edhe pse këto dy qasje dallojnë dhe kanë implikime të ndryshme në realizimin e qëllimeve, ata janë komplementarë dhe kushtëzohen nga njëri tjetri. Mirëpo, ajo që është karakteristike për organizatat qytetare të grave në Maqedoni është po ajo ndarje në pranimin e njëres apo qasjes tjetër drejt barazisë gjinore. Për ti kuptuar aktivitetet e organizatave qytetare të grave që kanë të bëjnë me buxhetimin gjinor, më poshtë do të orvatemi ti definojmë dhe analizojmë qasjet dominonte në të cilat funksionojnë ato..

### » **Mekanizmat e barazisë gjinore: qasja tradicionale**

Qasja tradicionale drejt barazisë gjinore bazohet në formë të caktuar të politikës së barazisë gjinore dhe të mekanizmave nëpërmjet të cilëve do të realizohet ajo politikë. Qasja tradicionale fokusohet në problemet dhe temat të cilat dalin apo janë rezultat i barazisë gjinore në disa sfera të jetës. Mekanizmat, të njohura si makineri e barazisë gjinore, paraqesin organe institucionale të shtetit dhe janë pjesë e institucioneve të sistemit. Ata merren me zgjidhjen e problemeve specifike dhe konkrete, duke ofruar zgjidhje optimale në kontekstin e dhënë dhe në kushtet ekzistuese.

Makineria për barazi gjinore duhet ti zbulojë dhe ti vendos problemet e pabarazisë gjinore dhe të kryej trysni mbi politikat tjera sektoriale në drejtim të eliminimit të problemeve. Politika tradicionale e barazisë gjinore krijon dokumente të caktuara strategjike dhe plane aksionare për realizimin e tyre. Shpesh herë ata janë pasqyrim i dëshirave për barazi gjinore dhe të drejtave të grave sipas dokumenteve ndërkombëtare dhe gjithnjë e realizojnë funksionin për të cilën janë formuar.

Kjo ka të bëjë me më shumë faktorë. Si e para, shpesh herë makineria për barazi gjinore marginalizohet, edhe pse mundet të jetë pjesë e ndonjë ministrie të rëndësishme apo të formohet si komision apo si sektor madje edhe si një ministri. Margjinalizimi rrjedh nga përkrahja e pamjaftueshme materiale dhe financiare nga ana e pushtetit e cila do të mundëson realizimin e dokumenteve strategjike dhe planeve aksionare.

Së dyti, edhe pse dobët e ekipuar, ajo përbëhet nga administratë profesionale e cila edhe pse e posedon ekspertizën e duhur, shpesh herë për shkaqe ligjore apo politike nuk mundet të bëjë shtypje mbi institucionet tjera të sistemit.

Së treti, edhe pse mundet të jetë edhe politikisht e strukturuar, që donë të thotë të ketë edhe forcë politike (siç është rasti me komisionet lokale komunale), makineria shpesh nuk disponon me instrument institucional nëpërmjet të cilit do ta kryen reaksionin e pritur dhe do të ndërmarrë aktivitet të caktuar nga ana e atyre që janë përgjegjës.

Nga aspekti i qasjes tradicionale, barazia gjinore ka rëndësi më të ngushtë nga konteksti i perspektivës gjinore. Tre karakteristikat kryesore e definojnë rëndësinë e barazisë gjinore në qasjen tradicionale: së pari barazia gjinore trajtohet si çështje e anti-diskriminimit; së dyti barazia gjinore trajtohet si barazi de jure, në kuptim se nuk ekzistojnë pengesa ligjore dhe kushtetuese për pjesëmarrje të meshkujve dhe femrave në jetën shoqërore; dhe së treti, në ligjet e fushës së barazisë gjinore referohet në gratë dhe në këtë mënyrë garantojnë të drejtat e tyre.

Koncepti i barazisë gjinore i cili nuk bazohet vetëm në barazinë de jure, në anti-diskriminim dhe në referimin eksplicit të grave në ligje, por do të supozon këto aspekte dhe do të fokusohet në vetë relacionet gjinore, gjegjësisht të meshkujve dhe grave njëkohësisht, është koncepti i barazisë i perspektivës gjinore. Përveç konceptit të zgjeruar të barazisë gjinore, perspektiva gjinore e zgjeron mandatin e veprimit institucional për arritjen e barazisë. Risi në qasjen e perspektivës gjinore është përfshirja e qasjes gjinore në vetë aktivitetet sociale, planifikimin dhe realizimin e tyre

### » **Integrimi i perspektivës gjinore**

Strategjia gjenerale e cila ka për qëllim këtë koncept të zgjeruar të barazisë gjinore dhe mënyrat e veprimit institucional në drejtim të arritjes së barazisë, në dokumentet ndërkombëtare e njohur si **Gender Mainstreaming**. Gjatë përkthimit të kësaj shprehjeje shfaqen disa pengesa, prandaj apelet për përkthim adekuat bazohen në vetë kuptimin të cilin duhet ta ketë shprehja **Gender Mainstreaming**. Në përgjithësi mundemi të veçojmë disa kuptime: qasje e bazuar në gjini, perspektiva e barazisë gjinore. Ja disa shembuj nga burimet ndërkombëtare për atë se si definohet **Gender Mainstreaming**:

Në platformën e Pekingut për aksion **Gender Mainstreaming** definohet si në vijim:

„...qeveritë dhe aktorët tjerë duhet të promovojnë politikë aktive dhe të dukshme në pranimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe programet, ashtu që para se të

sillen vendimet do të bëhet analizë e efekteve mbi gratë dhe meshkujt.“<sup>66</sup>

Në definicionin e Programit zhvillimor pranë Kombeve të Bashkuara UNDP theksohen komponentët në vijim:

„Marrja parasysh e çështjeve gjinore në të gjitha politikat, programet aktivitetet administrative dhe financiare dhe veprimet organizative me çka kontribuohet drejt transformimit të thellë organizativ,“

„Futja e rezultateve nga analizat socio-ekonomike dhe politike në gjitha proceset e sjelljes së vendimeve në organizimin dhe ndjekjen e rezultatit. Këtu bëjnë pjesë dhe vendimet kryesore për politikën e organizatës dhe vendimet e vogla të përditshme gjatë zbatimit.“<sup>67</sup>

Sipas kësaj, konceptin e **Gender Mainstreaming** mundemi ta paraqesim me konceptet e integritimit, përfshirjes, qëndrimeve, perspektivës, procedimit. Ajo që është objekt i integritimit është koncepti i perspektivës gjinore, gjegjësisht sensibilizimi i veprimeve institucionale i cili duhet të rezultojë me gjendje të barazisë gjinore. Tani mundemi ta japim definicionin në vijim: pranim të plotë të perspektivës gjinore në procesin e vlerësimit të implikimeve të secilit veprim të planifikuar mbi gratë dhe meshkujt, duke i përfshirë edhe legjislativen, politikat apo programet në gjitha fushat dhe në gjitha nivelet. Kjo është strategji për çështjet dhe përvojat e grave dhe meshkujve në orvatjet të bëhen dimension i integruar në disajnimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve në gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, ashtu që gratë dhe meshkujt do të kenë përfitime të njëjta dhe nuk do të vazhdojnë pabarazia. Qëllimi përfundimtar është të arrihet barazia gjinore.“

Me qëllim ta sqarojmë konceptin e integritimit të perspektivës gjinore, do të bëjmë një krahasim të shkurtër me qasjen tradicionale, gjegjësisht me makinerinë për barazi gjinore.

- ▶ Derisa makineria për barazi gjinore veçohet si kornizë e veçantë institucionale, integrimi i perspektivës gjinore është proces i cili zhvillohet në vetë institucionet e pushtetit dhe shoqërisë civile.
- ▶ Makineria për barazi gjinore përbëhet nga aktorë ekspertë, ndërsa në kontekstin e integritimit të perspektivës gjinore aktorë janë të gjithë subjektet e veprimit politik dhe social.
- ▶ Pasojat e pabarazisë gjinore janë qëllim i makinerisë për barazi gjinore, ndërsa integrimi i perspektivës gjinore ka për qëllim të pengohet krijimi i kushteve për shfaqjen e pabarazisë gjinore.

Edhe pse nga ky krahasim mundet të konkludohet se integrimi i perspektivës gjinore dhe makinerisë së barazisë gjinore janë plotësisht meta-strategji të kundërta dhe se

66 Beijing Declaration and Platform for Action Beijing Platform for Action ,Fourth World Conference on Women, Beijing, 1995, paras. 79, 105, 123, 141, 164, 189, 202, 229, 238, 252, 273, Available from: <<http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>> [Accessed, декември 2010]

67 United Nations Development Programme, Available from <http://www.undp.org/women/> [Accessed, декември 2010]

integrimi i perspektivës gjinore duhet ta zëvendësojë makinerinë për barazi gjinore ajo nuk është ashtu. Siç cekëm, integrimi i perspektivës gjinore e supozon qasjen tradicionale edhe atë për disa shkaqe.

Politika tradicionale për barazi gjinore paraqet pikë fillestare e integritit të perspektivës gjinore. Ajo riorganizohet ashtu që politikën dhe mekanizmin e qasjes tradicionale drejt barazisë gjinore, perspektiva gjinore e inkorporon në politikat standarde. Makineria e barazisë gjinore paraqet prapavijë dhe burim i ekspertëve të cilët janë kreatorë të implementimit të integritit të perspektivës gjinore. Dhe në fund qasja tradicionale siguron dituri dhe ekspertizë për çështjet gjinore.

## **ROLI I ORGANIZATAVE QYTETARE TË GRAVE NË PROMOVIMIN E BUXHETIMIT GJINOR**

Veprimi i organizatave qytetare të grave në drejtim të promovimit të buxhetimit gjinor kryesisht ka të bëjë me edukimin, ngritjes së vetëdijes dhe proces të përfaqësimit. Edhe pse këto aktivitete çdo herë nuk kanë të bëjnë vetëm me promovimin e buxhetimit gjinor, me rëndësi është të ceket se organizatat qytetare të grave buxhetimin gjinor e trajtojnë si çështje e cila është e pandashme nga cila do çështje tjetër që ka të bëjë me barazinë gjinore. Prandaj në vijim të shohim disa shembuj të disa organizatave qytetare në orvatjen e tyre për ta promovuar buxhetimin gjinor.

Në panairin e OJQ-ve në vitin 2004, në organizatën Lidhja e Organizatave të Grave të Maqedonisë (LOGM) u mbajt sesiioni edukativ i titulluar “Buxhetim gjinor”. Buxheti gjinor u prezantua si analizë e të ardhurave publike nga perspektiva gjinore. Në sesiion u prezantuan vegla konkrete dhe metoda për analizë të procesit gjinor.

LOGM, si pjesë e Lobit Evropian të Grave, argumentoi në favor të buxhetimit gjinor me qëllim të efikasitetit më të madh në harxhimin e parave publike. Ata

Iniciativa qytetare e grave Antiko në periudhën 2004-2005 realizoi aktivitete të cilat kishin për qëllim që strukturat udhëheqëse, aktivistët, anëtarët dhe vullnetarët e sektorit qytetar por edhe opinionin më të gjerë ta njoftojnë me Rezolutën e SCR KB 1325. Rezoluta 1325 është dokumenti i parë i miratuar nga Këshilli për Siguri i cili në mënyrë specifike e trajton çështjen e ndikimit të luftës mbi gratë, si edhe kontributin e grave në zgjedhjen e konflikteve dhe ruajtjen e paqes.

Në kuadër të kërkesave deri të Qeveria për zbatimin e Strategjisë për arritjen e barazisë gjinore, kyçjen e Rezolutës 1325 në sistemin e Strategjisë për arritjen e barazisë gjinore, rritjen e numrit të grave në pozita udhëheqëse në parlament, ministri, vetëqeverisje, lokale, diplomaci, ambasadorë, gra në misione paqësore u kërkua edhe fillimi i procesit për formulimin dhe zbatimin e politikave për buxhetim gjinor.

## » **Ndryshime në politikat buxhetore: perspektiva gjinore**

Edhe pse është rëndë të vlerësohet sa është ndikimi i organizatave qytetare të grave mbi fillimin e implementimit institucional të buxhetimit gjinor nga ana e pushtetit qendror apo lokal, megjithatë mundemi të vërtetojmë se pushteti i dëgjon. Mundemi gjithashtu të pohojmë se aktivitetet e organizatave qytetare të grave që kanë të bëjnë me buxhetimin gjinor janë kusht i nevojshëm që pushteti të merret me këtë çështje, po thuaj të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga ana e pushtetit nuk janë pa përkrahjen e organizatave qytetare të grave. Në vazhdim do të shihni vetëm disa nga aktivitetet e ndërmarra nga ana e pushtetit për të cilat mundemi të themi se janë realizuar nën ndikimin e sektorit civil të grave.

Ndryshimi i parë real në drejtim të krijimit të politikave buxhetore gjinore mundemi të dallohet në dokumentin strategjik **Plani Nacional për Aksion për barazi gjinore 2007-2012**. Në dokument theksohet se dhjetë fushat strategjike do të përforcohen nëpërmjet përforcimit të kapacitetit institucional dhe mekanizmave për kyçjen e perspektivave gjinore në politikat publike, strategjitë dhe planet aksionare dhe kyçjen e metodave të buxhetimit gjinor në nivel lokal dhe qendrorë.

Ministria e punës dhe politikës sociale e përkrahur nga UNIFEM, nga janari i vitit 2009 filloi ta realizon programin njëvjeçar për futjen e barazisë gjinore në politikat buxhetore të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i këtij programi është iniciimi i procesit të futjes së perspektivës gjinore në politikat buxhetore në nivel nacional, duke çuar në alokimin e drejtë dhe gjinor të mjeteve dhe transparencë më të mirë dhe përgjegjësi të buxhetit nga aspekti i barazisë gjinore.

Duke i ndjekur rekomandimet e Komisionit Evropian, OKB-s dhe organizatave tjera ndërkombëtare, Republika e Maqedonisë me realizimin e aktiviteteve në kuadër të këtij programi është shteti i parë në rajon i cili realizon kësi lloj aktivitetesh në nivel nacional. Vendet e rajonit kanë ndërmarrë iniciativa për buxhetim gjinor por kryesisht këto janë iniciativa në nivel lokal.

Si një nga rezultatet e arritura të këtij programi është përfshirja e aspekteve të buxhetimit gjinor të përgatitura nga ana e Ministrisë për financa për përgatitjet e buxhetit për vitin 2010.

Të kuptuarit e buxhetimit gjinor si koncept i kyçjes të sa më shumë nëpunësve shtetërorë që punojnë në barazinë gjinore dhe krijimin e politikave buxhetore në promovimin e këtij koncepti është shumë e rëndësishme. Është realizuar trajnim për 30 nëpunës shtetërorë nga ministrinë pranë Qeverisë së RM-s dhe institucioneve tjera relevante me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të tyre.

Në kuadër të buxhetimit gjinor, Sektori për mundësi të barabarta bëri analizë të politikave nga fusha e marrëdhënieve të punës dhe një pjesë të politikave nga fusha e mbrojtjes sociale.<sup>68</sup>

68 prof. Dr. Amalajja Jovanović, prof. Dr. Slobodanka Markovska, (2010) Analizë gjinore buxhetore të politikave aktive të punësimit dhe mbrojtjes sociale, Shkup

Në kuadër të projektit u zbatuan dy hulumtime nga perspektiva gjinore të cilët siguruan informacione për krijimin e politikave dhe proceseve buxhetore në dy komuna dhe paraqesin bazë për identifikimin e pikave fillestare për analizë të mëtutjeshme dhe përforcimin e kapaciteteve në fushën e buxhetimit gjinor. Hulumtimet u bënë në Manastir nga ana e organizatës “Klea” dhe në Tetovë nga ana e Forumit të Grave.<sup>69</sup>

Se tema për buxhetimin gjinor është temë e cila meriton vëmendje tregoi edhe Kuvendi i Maqedonisë i cili organizoi debat publik për buxhetimin gjinor, të organizuar nga Komisioni i Kuvendit për mundësi të barabarta të grave dhe meshkujve. Debatu publik kishte për qëllim ta njofton opinionin me konceptin e buxhetimit gjinor, rolin e Qeverisë dhe Kuvendit në integrimin e perspektivave gjinore në proceset e buxhetimit dhe shkëmbimin e përvojave pozitive me Holandën dhe Austrinë. Si pjesë e iniciativës parlamentare u publikua dorracaku për buxhetim gjinor<sup>70</sup>.

Në fund do ta cekim edhe fjalimin e ministrit të punëve të jashtme, Antonio Miloshevski në sesionin e Komitetit të përhershëm të kuvendit parlamentar të Këshillit të Evropës, i cili mes tjerash theksoi se kryesia ynë do të organizojë seminar për çështjen e buxhetimit gjinor, me çka e theksoi angazhimin e pushtetit ndaj kësaj çështjeje.<sup>71</sup> Në fjalim ai potencoi se vendet anëtare të Këshillit të Evropës pajtohen se barazia gjinore mundet të zbatohet në praksë nëse politikat kujdesen për barazinë gjinore nëpërmjet buxhetimit adekuat, nëse në procesin e përgatitjes së buxheteve ata bazohen në analizë gjinore dhe i integrojnë aspektet gjinore. Barazia e suksesshme gjinore ka të bëjë me implementimin e duhur të politikave për barazi gjinore dhe me strategjinë për promovimin e barazisë gjinore, duke e përfshirë edhe buxhetimin gjinor. Maqedonia është një nga vendet e para në rajon i cili përfshin analizë gjinore si element kyç dhe qendrorë në politikat dhe programet e sektorëve për çështje sociale, punë dhe financa.

69 Publikimet Buxhetim gjinor në nivel lokal për komunat e Tetovës dhe Manastirit janë të qasshme në [www.unifem.sk/uploads/doc/Tetovo\\_MK.pdf](http://www.unifem.sk/uploads/doc/Tetovo_MK.pdf) и [www.unifem.sk/uploads/doc/Bitola\\_MK.pdf](http://www.unifem.sk/uploads/doc/Bitola_MK.pdf), [Accessed, dhjetor 2010]

70 UNDP, Doracak për buxhetim gjinor <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/I-II-III-IV%20finalo.pdf>, [Accessed, dhjetor 2010]

71 Shih, <http://www.sobranie.mk/default.asp?ItemID=BB996BEE7B818540A9D5452CC8BA0956>, [Accessed, dhjetor 2010]

# KONKLUSIONE

# DHE REKOMANDIME

Nga ajo që u tha deri tani mundemi të sjellim disa konkluzione përndikimin e organizatave qytetare në politikat buxhetore të Maqedonisë dhe krijimin e vetë buxhetit – njëkohësisht do të japim edhe disa rekomandime për gjithë aktorët e kyçur në proceset buxhetore. Por, duhet të thuhet se “ndikimi” në këtë studim vlerësohet në bazë të analizës së fakteve dhe sjelljes së aktorëve të kyçur në hulumtim. Kjo është kështu sepse hulumtimi tregon se nuk ka dëshmi të drejtpërdrejtë për ndikimin e organizatave qytetare mbi politikat buxhetore, por ka shkaqe të mjaftueshme për ndryshim të politikave që kanë të bëjnë me buxhetimin. Dëshmi për këtë konstatim është analiza para juve.

## KONKLUSIONE

**Ndikim thelbësor:** Organizatat qytetare, më saktë organizatat qytetare të grave janë iniciatorët kryesorë dhe promotorë të idesë për krijimin e politikave buxhetore gjinore në Maqedoni. Principet e buxhetimit gjinor janë pjesë e politikave të promovuara të Ministrisë së punës dhe politikës sociale si angazhim gjeneral i Qeverisë së R. Maqedonisë.

**Ndikim procedural:** Organizatat qytetare të grave nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, vazhdimisht ndikojnë mbi pushtetin dhe organizatat ndërkombëtare për implementim real të veglave dhe metodave në proceset e krijimit të politikave buxhetore në Maqedoni. Si indikator mundemi ta tregojmë kyçjen e aspekteve të buxhetimit gjinor deri te të gjitha ministrinë dhe institucionet qeveritare.

**Ndikim strukturor:** Ndikimi strukturor nuk shihet aq shumë në aspektin organizativ, siç është për shembull formimi i departamenteve apo sektorëve të ri në kuadër të ministrive, por si çështje e përforsimit të kapaciteteve profesionale të nëpunësve shtetërorë. Shikuar realisht, ekspertiza dhe kapaciteti i duhur për inicimin e proceseve për buxhetim gjinor ndodhet te organizatat qytetare të grave apo te bashkësia akademike e afërt me sektorin civil. Pjesëtarët e sektorit civil janë të kyçur në përforsimin e diturive dhe aftësive të nëpunësve të cilët punojnë në barazinë gjinore dhe krijimin e politikave buxhetore. Qeveria zbatoi trajnim të 30 nëpunësve shtetërorë nga ministrinë dhe institucionet tjera relevante për zbatim praktik të veglave për buxhetim gjinor.

**Ndikim sensitiv:** Ndryshimi i qëndrimeve në opinion për buxhetimin gjinor është ajo se ekziston tendenca që çështjet e barazisë gjinore të zëvendësohen si çështje për buxhetim gjinor. Ndjenja se të drejtat e grave respektohen dhe duke nisur nga fakti se gratë janë tani më pjesë e jetës publike krijojnë kushte për krijimin e qëndrimit se çështje e vetme është ajo financiare deri te barazia e plotë. Nga ana tjetër, interesi për këto çështje ishte edhe iniciatori për ndryshim pozitiv të vetëdijes të opinionit më i gjerë.

## REKOMANDIME

- ▶ Organizatat qytetare të grave ta forcojnë tryshinë mbi pushtetin për implementimin e principeve të buxhetimit gjinor në proceset e krijimit të buxhetit.
- ▶ Të pranohet nevoja për një qasje të vetme drejt çështjes së barazisë gjinore dhe buxhetimit gjinor, me çka do të rritet efektiviteti dhe efikasiteti i iniciativave qytetare të buxhetimit gjinor.
- ▶ Pushteti në Republikën e Maqedonisë ta zbaton procedurën për buxhetim gjinor si pjesë standarde në procesin e krijimit të buxheteve.
- ▶ Të gjenden mekanizma për qëndrueshmëri institucionale të qasjes së buxhetimit gjinor për të ikur qasjes vullnetare.
- ▶ Ngritja e vetëdijes të sektori civil dhe shoqërisë me gjerë për nevojën dhe dobinë e qasjes së buxhetimit gjinor.

Tema:

# RRETHINA E JASHTME

Nikica Kusenikova, Shoqata Konekt

## RAPORTET MES SEKTORIT AFARIST DHE SHOQËRISË CIVILE / PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E NDËRMARRJEVEY

### REZYME

Qëllimi i këtij studimi të rastit është të bëhet analizë e trendëve dhe shkallës së zhvillimit të PSHN në Maqedoni, veçanërisht lidhur me bashkëpunimin e ndërmarrjeve dhe organizatave qytetare. Përgjegjësia shoqërore e ndërmarrjeve (PSHN) e cakton përgjegjësinë e ndërmarrjeve dhe ndikimin e vendimeve dhe aktiviteteve të tija mbi shoqërinë dhe mjedisin jetësor. PSHN prek pothuaj të gjitha segmentet e shoqërisë në të cilat vepron dhe sektorin civil, me çka hap hapësirë më të madhe për bashkëpunim dhe komunikim të këtyre dy sektorëve, ndërsa organizatat qytetare paraqiten si palë e rëndësishme e prekur për ndërmarrjet në fushën e PSHN.

Studimi synon të përqendrohet në: (1) nivelin e aplikimit të PSHN dhe përfaqësimi i tij në raportet vjetore të ndërmarrjeve të cilat janë lëndë e analizës, (2) shkalla dhe kualiteti i bashkëpunimit mes ndërmarrjeve dhe OQ, (3) mbështetja financiare e ndërmarrjeve ndaj OQ dhe (4) roli vëzhgues dhe presioni i OQ mbi punën e ndërmarrjeve. Gjatë kësaj, studimi bazohet në hulumtimet dhe analizat e deritanishme në këtë fushë, me fokus të veçantë të politikave dhe praktikave të 10 ndërmarrjeve më të mëdha në pronësi private në Maqedoni.

Në Maqedoni, PSHN është koncept relativisht i ri, i cili për ndërmarrjet kryesisht paraqet shtesë të punës themelore afariste në vend të pjesës integrale nga menaxhimi me ndërmarrjen. Në vitet e kaluara me këtë temë filluan të merren më shumë palë të prekura – institucione, biznes asociacione dhe oda, shoqata etj. Në vitin 2008 u vendos edhe korniza institucionale për mbështetje të PSHN përmes miratimit të Agjendës nacionale për PSHN 2008 -2012, si dhe përmes formimit të trupit koordinues multi-sektorial për PSHN në kuadër të Këshillit ekonomik-social. Megjithatë, analizat tregojnë se ekziston mungesë e vetëdijes dhe kapacitete për integrimin e PSHN në punën e përgjithshme të ndërmarrjes.

Shumica e kompanive më të mëdha në R. Maqedonisë nuk kanë praktikë për shpalljen e raporteve të veçanta për PSHN. Vetëm një ndërmarrje ka publikuar raport vjetor për PSHN për vitin 2009, derisa tre të tjera kanë inkuadruar informata për veprim në fushën e PSHN, në kuadër të raporteve vjetore të ndërmarrjes. Siç flasin edhe hulumtimet ekzistuese në këtë fushë, edhe te ndërmarrjet më të mëdha pikë e dobët është menaxhimi me rezultatet nga PSHN dhe publikimi i treguesve financiar, që është praktikë e vendosur e rregullt në korniza botërore. Fushat e mjedisit jetësor, shëndetit dhe sigurisë dhe resurset njerëzore janë fushat më të rëndësishme të PSHN për ndërmarrjet më të mëdha.

Bashkëpunimi mes sektorit afarist dhe atij civil akoma është në nivel të pakënaqshëm dhe bazohet në iniciativa individuale të disa ndërmarrjeve dhe shoqatave të cilat e kanë njohur dobinë e ndërsjellë dhe interesin nga bashkëpunimi. Në përgjithësi, OQ rrallë bëjnë presion mbi sektorin afarist lidhur me ndikimin e tyre mbi mjedisin jetësor dhe bashkësinë dhe nuk llogariten për shtytës të rëndësishëm të PSHN në R. Maqedonisë.

Donacionet dhe sponsorizimet janë formë më dominuese të komunikimit mes sektorit afarist dhe atij civil. Por, bile edhe në këtë fushë nuk është arritur minimumi. Edhe pse sipas Regjistrisë qendror, në vjet ndërmarrjet veçojnë rreth 7 milionë euro për donacione dhe sponsorizime, pranues më të shpeshtë të kësaj mbështetje (me përjashtim të shoqatave sportive) janë institucionet publike dhe manifestimet kulturore dhe sportive. Trend i njëjtë është vërejtur edhe te ndërmarrjet më të mëdha në Maqedoni.

Edhe krahas asaj që bashkëpunimi mes sektorit afarist dhe atij civil nuk e arrin potencialin e vet optimal, megjithatë pritet që ky të avancohet gjatë viteve të ardhshme. Indikacione për këtë trend janë prezenca e shtuar e projekteve të cilat ndërmarrjet i realizojnë në bashkëpunim me OQ, zhvillimi i OQ të specializuara, të cilat janë orientuar drejt zhvillimit të PSHN dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë bashkëpunojnë me sektorin afarist, aktiviteti i rritur i OQ në fushën e grumbullimit të mjeteve nga burime lokale etj. Gjithsesi avancimi i bashkëpunimit të dy sektorëve mund të nxitet me implementimin konsistent të politikave nacionale në fushën e PSHN dhe krijimin e legjislacionit adekuat dhe kornizës tatimore në këtë fushë.

## HYRJE

Gjatë disa dekadave të kaluara në korniza globale është pranuar mendimi se ndërmarrjet janë pjesë e pashmangshme e shoqërisë dhe se ato në mënyrë të pashmangshme ndikojnë mbi atë. Në një pjesë të madhe ndikimi është pozitiv – ndërmarrjet janë forcë lëvizëse e rritjes ekonomike, ato sigurojnë të mira dhe shërbime të cilat e lehtësojnë dhe e përmirësojnë jetën e njerëzve, punësojnë njerëz nga bashkësia ku veprojnë, përmes donacioneve të cilat i paguajnë mundësojnë realizimin e shërbimeve me interes publik në fushën e shëndetësisë, sociale, arsimit etj. Por, zhvillimi i shoqërisë në nivel global solli

vetëdije më të madhe dhe brengosje për problemin siç janë varfëria, ndotja dhe degradimi i mjedisit jetësor, të drejtat e njeriut etj. Gjatë viteve të kaluara, ndaj ndërmarrjeve shihej si një fajtor kryesor për problemet sociale, ekologjike dhe ekonomike. Në përgjithësi ishte pranuar qëndrimi se ato prosperojnë në llogari të bashkësisë më të gjerë<sup>72</sup>.

Si pasojë e presionit të aktorëve të jashtëm (organizata joqeveritare, konsumues, qeveritë etj.) si dhe nga nevoja e njohur për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të biznesit, sot për një ndërmarrje nuk është e mjaftueshme që të fokusohet vetëm në rritjen e fitimit, por duhet të synojë edhe ti minimizojë (ideale, ti eliminojë) ndikimet e veta mbi mjedisin jetësor, si dhe të veprojë në pajtim me pritjet e bashkësisë dhe shoqërinë më gjerë.

Në drejtim të këtyre trendëve, është zhvilluar edhe koncepti i Përgjegjësisë shoqërore të ndërmarrjeve (PSHN) si parim i menaxhimit me ndërmarrjen. Përgjegjësia shoqërore e ndërmarrjeve (PSHN)<sup>73</sup> e cakton përgjegjësinë e ndërmarrjeve për ndikimin e vendimeve dhe aktiviteteve të tija mbi shoqërinë dhe mjedisin jetësor.

Si aktorë kryesor në një shoqëri, sektori afarist dhe civil pa dyshim funksionojnë në korrelacion të caktuar dhe zhvillojnë raporte të ndërsjella. Trendët për zhvillim të PSHN që prekën pothuaj në të gjitha segmentet e shoqërisë, ku vepron edhe sektori civil, hap hapësirë të madhe të rëndësishme për bashkëpunim dhe komunikim të këtyre dy sektorëve. Gjatë kësaj, në kontekstin e PSHN, organizatat qytetare (OQ) paraqiten si anë e rëndësishme e prekur për ndërmarrjet në disa nivele::

- ▶ OQ, e veçanërisht organizatat aktive mund ta kryejnë rolin e mbikëqyrësit dhe të bëjnë presion publik mbi ndërmarrjet për ndikimin e tyre mbi shoqërinë dhe mjedisin jetësor. Gjithashtu ata avokojnë dhe te qeveritë për vendosjen e rregullativës më të rreptë për sjelljen e ndërmarrjeve<sup>74</sup>;
- ▶ Si shfrytëzues të aktiviteteve filantropike (donacionet) e ndërmarrjeve. Në këtë fushë, OQ janë partner natyror të ndërmarrjeve duke pasur parasysh atë se të dyja veprojnë në fushën e iniciativës private (përkundër sektorit publik/shtetit);
- ▶ Si bashkëpunëtorë dhe ofrues të shërbimeve në fushën e PSHN, qoftë të bëhet fjalë për koncepte të integruara të PSHN ose për segmente të caktuara të tija (për shembull, organizata ekologjike i ndihmon ndonjë ndërmarrjeje në bashkësinë e vet që ta përmirësojë efikasitetin e shfrytëzimit të resurseve).

Qëllimi i këtij studimi është të bëjë analizë të trendëve dhe shkallë së zhvillimit të PSHN në Maqedoni, veçanërisht lidhur me bashkëpunimin e ndërmarrjeve dhe organizatave qytetare. Më konkretisht, studimi synon të përqendrohet në këto aspekte:

- ▶ Niveli i aplikimit të PSHN dhe përfaqësimi i tij në raportet vjetore të ndërmarrjeve të cilët janë lëndë e analizës;

72 Definicioni në pajtim me propozim standardin e ri për përgjegjësi shoqërore ISO/DIS 26000

73 Studim referencues për përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjeve në IRJ Maqedonisë, UNDP, 2007

74 Ibid.

- ▶ Shkalla dhe kualiteti i bashkëpunimit mes ndërmarrjeve dhe OQ;
- ▶ Mbështetja financiare e ndërmarrjeve ndaj OQ;
- ▶ Roli vëzhgues dhe presioni i OQ mbi punën e ndërmarrjeve..

» **Metodologjia**

PSHN së pari është pranuar dhe aplikuar nga ana e korporatave të mëdha më së shumti për shkak të ekspozimit të tyre të madh në opinion dhe nevojën që ta mbajnë reputacionin/legjitimitetin e vet dhe ta forcojnë brendin e tyre. Në shumicën e vendeve, veçanërisht në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore ata ishin liderë dhe promotorë të PSHN. Edhe në Maqedoni hulumtimet e realizuara deri më tani tregojnë se korporatat multinacionale në vend janë më mirë të njoftuara me konceptin e PSHN dhe me logjikën afariste nga inkomporomi i tij. Për këtë shkak, analiza në kuadër të këtij studimi fokusohet në 10 ndërmarrjet më të mëdha në R. Maqedonisë të cilat janë në pronësi private. Zgjedhja e 10 ndërmarrjeve më të mëdha bazohet në: 1) lista e South East Europe Top 100 që çdo vjet publikohet nga ana e SEE News, në bazë të ardhurave të gjeneruara në vitin 2008 dhe 2009 dhe 2) lista e 200 kompanive më të mëdha në vitin 2009 që e publikon Euro Biznes Qendra – Shkup, në bazë të treguesve financiar të fituar nga institucionet e autorizuara financiare në Maqedoni. (Aneksi 1).

Metodologjia e analizës përfshinë:

- ▶ Analiza e raporteve vjetore për vitin 2008 dhe 2009 të 10 ndërmarrjeve më të mëdha në Maqedoni duke përfshirë edhe raportet për PSHN;
- ▶ Intervista me persona të angazhuar për PSHN në disa nga ndërmarrjet hulumtuese;
- ▶ Hulumtime ekzistuese, analiza dhe dokumente nga fusha e PSHN;
- ▶ Të dhëna zyrtare nga Regjistri qendror Aplikacione të shtruara për Shpërblim nacional për PSHN për vitin 2008 dhe 2009;
- ▶ Praktika të promovuar në opinion dhe mediumet.

Analiza paraqet bazë mbi të cilën krahas studimit të praktikave konkrete, përmblihen edhe përfundimet për shkallën e zhvillimit të bashkëpunimit mes sektorit afarist dhe OQ.

## PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E NDËRMARRJEVE NË MAQEDONI – TRENDËT E PËRGJITHSHËM

Diskutimet e para lidhur me raportet mes sektorit afarist dhe shoqërisë civile në Maqedoni filluan në vitin 2002 përmes paneleve të organizuara në kuadër të Panairit të organizatave joqeveritare. Ky aspekt u përfshi edhe në hulumtimin në kuadër të Indeksit të shoqërisë civile të botuar në vitin 2005. PSHN në rëndësinë e saj të përgjithshme si temë në mënyrë sistemore filloi të hulumtohet nga viti 2006. Sipas Studimit referent për PSHN në Maqedoni nga viti 2007, të realizuar nga ana e UNDP, në kuadër të hulumtimit rajonal<sup>75</sup> “bashkësia afariste akoma ka mungesë nga rëndësia adekuate dhe instrumenteve praktike për zbatimin e plotë të parimeve me përgjegjësi shoqërore të punës afariste”. Hulumtoi tregoi se shumica e ndërmarrjeve në Maqedoni e kuptojnë PSHN si komponentë të jashtme, shtesë e punës afariste të përditshme, që varet nga kërkesat e rrethinës, e jo si mënyrë e udhëheqjes që duhet të inkorporohet në planet dhe vendimet strategjike të ndërmarrjes. Numri më i madh i kompanive akoma e barazojnë PSHN me sigurimin e donacioneve, sponsorizimeve dhe kontributeve bamirëse.

Sipas hulumtimit të njëjtë, lëvizës kryesor të PSHN te ndërmarrjet në Maqedoni janë aspekti ekonomik (shpesh nga aspekti i njohjes së brendit ose kompanisë) dhe qasjes altruiste. Pothuaj gjysma e ndërmarrjeve të anketuara nuk kanë strategji për PSHN, e as kanë menduar ta zhvillojnë. Vetëm 8,2% të ndërmarrjeve kanë pasur sistem të zhvilluar të përcjelljes dhe menaxhimit me rezultatet lidhur me PSHN, e pothuaj dy të tretat nuk kanë praktikë të shpalljes së informatave për PSHN në opinion. Interaksioni me palët e prekura është një nga aspektet më të fuqishme të PSHN te ndërmarrjet maqedonase. Edhe pse pjesa më e madhe e kompanive kanë praktika të vendosura ose janë në proces të zhvillimit të dialogut me palët e prekura, nuk ka kurrfarë treguesish për rezultatet dhe ndikimin nga interaksioni i këtyllë mbi praktikatat dhe strategjitë e ndërmarrjeve.

Lidhur me organizatat joqeveritare<sup>76</sup> si lëvizës të mundshëm të PSHN, sipas studimit referent, organizatat joqeveritare në Maqedoni kanë vetëdije mjaft të zhvilluar, si edhe aftësi të kufizuar dhe fuqi organizative që të bëjnë presion të madh mbi sektorin afarist, që pjesërisht ka të bëjë me zhvillimin e pamjaftueshëm të përgjithshëm të sektorit. Shumica e organizatave shohin në sektorin afarist si burim të mjeteve financiare për punën e tyre.

Gjatë viteve të kaluara në Maqedoni nuk është realizuar ndonjë hulumtim i ri gjithëpërfshirës i cili do ta shohë përparimin eventual në pikëpamje të inkorporimit të PSHN në kuadër të ndërmarrjeve. Ajo në të cilën ishin përqendruar përpjekjet e lëvizësve të PSHN në tre vitet e fundit ishte krijimi i kornizës nxitëse institucionale, ndërtimi i vetëdijes dhe i kapaciteteve të të gjitha palët e prekura dhe promovimi i PSHN në opinion dhe mes ndërmarrjeve. Me vendim të Qeverisë s.R. Maqedonisë u formua Trupi koordinues nacional

75 Baseline Study on CSR practices in the New EU Member States and Candidate Countries, UNDP, 2007

76 Term i cili përdoret në studim referencues

për PSHN që funksionon në kuadër të Këshillit ekonomik-social. Trupi koordinues është i përbërë nga përfaqësues të pothuaj gjithë palëve të prekura nga fusha e PSHN – ministri relevante, oda ekonomike dhe biznes asociacione, shoqata të punëdhënësve, sindikata, organizata joqeveritare, medime. Në tetor të vitit 2008, Qeveria e miratoi Agjendën nacionale për PSHN 2008-2012 që fokusohet në tre qëllimet kryesore strategjike: 1) ngritja e vetëdijes për PSHN; 2) zhvillimi i kapaciteteve dhe kompetencave që të ndihmohet etablimi i PSHN; 3) Sigurimi i ambientit të volitshëm për PSHN<sup>77</sup>. Masat në agjendën janë zhvilluar në mënyrë që kërkon inkuadrim dhe bashkëpunim të gjithë palëve të inkuadruar duke përfshirë edhe OQ. Në drejtim të realizimit të masave të parapara me agjendën, në 24 muajt e parë nga ekzistimi i tij Trupi koordinues për PSHN ka mbajtur dhe ka marrë pjesë në mbi 40 ngjarje, forume, punëtori, debate, konferenca dhe trajnime; ka publikuar 8 publikime të ndryshme dhe doracak në tirazh të përgjithshëm prej 8.000 ekzemplarë dhe ka formuar 7 grupe punuese në tema të ndryshme në fushën e PSHN.<sup>78</sup>

Në drejtim të nxitjes së PSHN dhe promovimin e shembujve pozitiv, janë iniciuar edhe Shpërblime nacionale për PSHN të cilat realizohen nga ana e trupit koordinues dhe Ministrisë së ekonomisë në bashkëpunim me mbështetësit tjerë<sup>79</sup>. Në kuadër të shpërblimeve në tre vite gjithsej kanë aplikuar 128 ndërmarrje (50 ndërmarrje të mëdha dhe 78 të vogla dhe të mesme). Nga mesatarja e aplikuesve, mund të shihet se edhe pse nga ana e ndërmarrjeve ekziston interesim për vlerësimin e asaj që është bërë në fushën e PSHN, megjithatë niveli i pjesëmarrjes nuk është në nivelin optimal.

Nga aktivitetet e lartpërmendura në Maqedoni do të mund të supozohet se është bërë progres i caktuar në ndërtimin e vetëdijes për rëndësinë e PSHN dhe atë se si integrimi i saj do të mund ta avancojë punën afariste të ndërmarrjeve. Megjithatë duhet të merret parasysh se ndryshimi i perceptimit për postulatet e biznesit dhe parimet e menaxhimit në ndërmarrjet është proces i cili nuk lidhet “për një natë”, kështu që edhe nuk mund të pritët përparim pozitiv drastik në praktikën e ndërmarrjeve për një periudhë të shkurtër.

### » **Mbështetja financiare e ndërmarrjeve për organizatat qytetare**

Krahas hulumtimeve nga fusha e PSHN, gjatë viteve të kaluara janë bërë hulumtime edhe në fushën e filantropisë korporatave, si pjesë e PSHN. Hulumtim më i ri në këtë fushë është bërë në fillim të vitit 2009 nga ana e Konekt për nevojat interne të UNICEF Maqedoni. Në kuadër të hulumtimit, janë anketuar 100 ndërmarrje me madhësi të ndryshme në Maqedoni. Hulumtimi tregoi se në përgjithësi, ndërmarrjet maqedonase kanë tendencë të dhurimit dhe se 56% nga ndërmarrjet kanë dhënë donacion të njëhershëm. Lë përshtypje se në një pjesë të dukshme të ndërmarrjeve nuk iu është qasur me kërkesë për donacion

77 Agjenda nacionale për përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjeve për Republikën e Maqedonisë 2008-2012, Shkup, 2008

78 Trupi koordinues për PSHN të Republikës së Maqedonisë – Nga iniciativa deri te lideri rajonal 2007-2009, Shkup, 2010

79 Është evident mungesa e informatave ose mosinteresimi për dobi nga Ligji për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike.

(63% prej tyre u është kërkuar donacion). Kjo flet se te ndërmarrjet ka gatishmëri për donacion, por ky potencial nuk është shfrytëzuar në të tërësi nga ana e pranuesve. Fusha të parapëlqyera të dhurimit janë: shëndetësia (një e katërta e ndërmarrjeve që kanë dhuruar), personat me nevoja të veçanta (16%) dhe fëmijët dhe mbrojtja e tyre (14% të atyre që kanë dhuruar). Një e katërta prej atyre që kanë dhuruar kanë dhënë donacion pa qëllim konkret, që flet për mungesën e qasjes strategjike në dhurim.

Hulumtimi tregoi se ndërmarrjet japin pa marrë parasysh madhësinë e tyre, por madhësia luan rol në nivelin e donacioneve. 35% të ndërmarrjeve me mbi 200 të punësuar kanë dhënë donacion mbi 10.000 denarë, derisa te ndërmarrjet më të vogla përqindja lëvizë prej 5.5% deri 15.4%. Derisa ndërmarrjet e mëdha kanë ndonjë formë të planifikimit vjetor të fushave dhe të buxheteve për donacione, shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhurojnë ad-hok, me kërkesë (ad-hok dhurimi është prezent edhe te ndërmarrjet e mëdha në kuadër të fushës së caktuar të dhurimit). Edhe pse ndërmarrjet parapëlqejnë tu dhurojnë individëve, gjithashtu ata shprehin gatishmëri të mbështetimit organizatat joqeveritare. Në pajtim me të dhënat zyrtare nga Regjistrin qendror (Tabela 1), edhe pse respektohen individët, shumat e donacioneve ndaj tyre janë dukshëm më të vogla prej atyre ndaj pranuesve tjerë. Edhe pse ndërmarrjet janë të hapura për sigurimin e donacioneve të njëhershme, një numër i vogël (vetëm 14%) janë të gatshme të sigurojnë mbështetje afatgjate. Shkaku kryesor për këtë është mungesa e buxhetit për qëllim të tillë dhe mungesa e nxitjeve tatimore .

Sipas të dhënave zyrtare të regjistrit qendror, niveli i donacioneve dhe sponsorizimeve për ndërmarrje në vitin 2009 është zvogëluar në raport me vitin 2008, por është më i madh në krahasim me atë në vitin 2007. Në përgjithësi, në numra absolute ekziston nivel i caktuar i donacioneve dhe sponsorizimeve gjatë viteve dhe i cili është resurs potencial për organizatat qytetare. Ekzistojnë variacione mes donacioneve dhe sponsorizimeve në fusha të caktuara, e kështu në vitin 2009 dukshëm janë rritur donacionet ndaj qytetarëve, pothuaj trefish në raport me vitin 2008 edhe pse akoma paraqesin pjesë të vogël në raport me nivelin e përgjithshëm të donacioneve dhe sponsorizimeve. Donacionet për organizatat humanitare dhe sponsorizimi i manifestimeve kulturore shënojnë rritje të dukshme në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, por janë dyfish më të ulëta nga niveli për këto fusha në vitin 2007. Kjo flet se nuk mund të nxjerrim përfundim të fuqishëm lidhur me trendet afatgjatë për fushat/qëllimet në të cilat dhurohet/sponsorizohet. Nëse merren parasysh rezultatet nga hulumtimet të cilat flasin për atë se shumë nga ndërmarrjet dhurojnë ad-hok si përgjigje ndaj kërkesave të caktuara për dhurim, mund të përfundohet se niveli i donacioneve/sponsorizimeve në fusha të caktuara varen edhe nga kërkesa d.m.th nga aktiviteti i pranuesit lidhur me grumbullimin e mjeteve nga sektori afarist.

**Tabela 1. Niveli i donacioneve dhe sponsorizimeve të prezantuara në raportet vjetore të ndërmarrjeve në RM .**

	Viti 2007 (denarë)	Viti 2008 (denarë)	Viti 2009 (denarë)
Numri i subjekteve afariste të cilat kanë informuar për donacione dhe sponsorizime	847	399	656
Sponsorizime dhe donacione - gjithsej	438.568.792	473.036.824	425.067.100
Donacione për organizata humanitare	36.214.224	2.512.341	18.673.977
Donacione për qytetarë	5.230.948	3.571.488	10.669.018
Donacione dhe sponsorizime për qëllime shkencore	35.085.961	35.819.371	17.916.032
Sponsorizime të manifestimeve kulturore	127.472.287	33.124.220	62.989.851
Sponsorizime të klubeve sportive	33.125.279	16.854.392	14.526.050
Sponsorizime dhe donacione të tjera	201.440.093	381.155.012	300.383.172

Kjo pasqyrë nuk tregon se sa mjete jepen si donacione ose sponsorizime ndaj organizatave qytetare përkundër pranuesve tjerë të mundshëm (institucione publike etj.). Rezultatet e Ministrisë së Drejtësisë nga implementimi i deritanishëm i Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtaritë publike<sup>80</sup> flet se sponsorizimet janë dominuese lidhur me donacionet dhe se përveç shoqatave nga fusha e sportit (klubet sportive, federatat etj.), më së shpeshti si pranues paraqiten institucionet publike nga fusha e arsimit, shëndetësisë dhe kulturës.

## **BASHKËPUNIMI I ORGANIZATAVE QYTETARE DHE SEKTORIT AFARIST – TRENDËT E PËRGJITHSHËM**

Duke pasur parasysh hulumtimet ekzistuese nga fusha e filantropisë korporatave si edhe nga nominimet dominuese për çmime nacionale për PSHN në fushën e “investimit në bashkësi”, mund të përfundohet se motivet altruiste për praktikumin e PSHN më së shpeshti shprehen përmes donacioneve që pajtohet me perceptimin e ndërmarrjeve për konceptin e PSHN.

Pikërisht motivet altruiste në praktikizmin e PSHN mund të hapin mundësi për bashkëpunim të OQ me sektorin afarist. Megjithatë, edhe pse ekziston mungesë e hulumtimit të përqendruar në bashkëpunimin e këtyre dy sektorëve, të dhënat ekzistuese tregojnë për atë se OQ nuk janë lëvizës dominues të PSHN në vend dhe se bashkëpunimi

i sektorëve është në nivel të ulët. Ka shumë pak shembuj të OQ të cilët bëjnë vëzhgim dhe presion mbi sektorin afarist për përgjegjësinë e tyre shoqërore. Organizata e konsumuesve të Maqedonisë bën përcjelljen e shkëljes së Ligjit për mbrojtjen e konsumuesve nga ana e ndërmarrjeve (veçanërisht në fushën e shërbimeve publike) dhe informatat i paraqet në opinion. Disa shoqata, si për shembull Koalicioni i gjelbër nga Velesi, reagon lidhur me praktikat konkrete dhe dëmet e shkaktuara nga ndërmarrje të caktuara mbi bashkësinë dhe mjedisin jetësor. Megjithatë, mungojnë OQ të cilat bëjnë vëzhgim sistemor të praktikave të PSHN në segmente të caktuara, lajmërimi në opinion dhe presion mbi ndërmarrjet.

Bashkëpunimi mes sektorit afarist dhe OQ shpesh realizohet përmes donacioneve nga ndërmarrjet ndaj OQ. Kjo është në pajtim me perceptimin e OQ ndaj sektorit afarist si burim i mundshëm i financimit<sup>81</sup>. Por, bile edhe në këtë fushë duket se OQ nuk e shfrytëzojnë tërësisht potencialin e sektorit afarist. Edhe krahas asaj që ndërmarrjet janë të hapura për bashkëpunim dhe mbështetje të OQ, me përjashtim të shoqatave sportive dhe institucioneve fetare, ato rrallë janë pranues të donacioneve korporatave. Nga ana tjetër, OQ mendojnë se dialogu mes atyre dhe sektorit afarist është jo qarta i zhvilluar dhe se dialogu më intensiv pothuaj edhe nuk aplikohet<sup>82</sup>. Kjo ka të bëjë me informimin e pamjaftueshëm të sektorit afarist për punën e OQ si dhe me mungesën e strategjisë dhe aktiviteteve për grumbullimin e mjeteve nga ndërmarrjet nga ana e OQ. Gjatë dy viteve të fundit është vërejtur aktivitet më intensiv nga ana e disa shoqatave që të arrijnë deri te sektori korporativ (Kryqi i Kuq, SOS Fshati i fëmijëve, Këshilli Rinor Ohër etj.).

Përveç donacioneve, janë vërejtur disa shembuj të bashkëpunimit më strategjik të projekteve konkrete nga fusha e PSHN të disa ndërmarrjeve me OQ, si për shembull të One (me Kryqin e Kuq, Lidhjen e Personave të Invaliditet Trupor të RM, Lidhja e Personave të Verbër të RM dhe Lidhja e personave të shurdhër të RM), EVN Maqedonia (me Konekt, Qendra Maqedonase për Efikasitet Energjetik, Këshilli Rinor Ohër, Planetum dhe Korra e Diturisë)<sup>83</sup>.

Viteve të fundit, disa organizata qytetare filluan të zhvillojnë programe dhe aktivitete për nxitjen e PSHN, ndërsa janë formuar edhe shoqata të reja të specializuara në fushën e PSHN, të cilat ofrojnë shërbime të specializuara për ndërmarrjet.

## **PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E NDËRMARRJEVE TE NDËRMARRJET E MËDHA NË MAQEDONI**

Duke e ndjekur trendin se korporatat më të mëdha janë të parat të cilat e kanë vendosur dhe e promovojnë konceptin e PSHN në vendet ku veprojnë, në rrjedhën e mëtejshme të studimit janë analizuar raportet vjetore të ndërmarrjeve më të mëdha prej sektori jo-

81 Studim referencues për përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjeve në IRJ Maqedonisë, UNDP, 2007

82 Vetëperceptimi për shoqërinë civile, MCMS, shkurt 2010

83 Projekte të dorëzuara për PSHN për vitin 2008 dhe 2009



financiar në Maqedoni. Duke marrë parasysh se të dy listat të cilat u morën parasysh japin informata të ndryshme për 10 ndërmarrjet e para më të mëdha, në analizë janë kyçur ndërmarrjet më të mëdha nga të dy listat.

Prej gjithsej 13 ndërmarrje të përfshira me studimin, bile 9 janë me pronësi dominuese të huaj (me përjashtim të SHA Alkaloid, Makpetroll, Euro Tabak dhe Tineks-MT). Në kuadër të studimit janë analizuar raportet e tyre vjetore, si dhe raportet për PSHN të kapshme në ueb faqet e tyre. Në mënyrë plotësuese intervistat me përfaqësuesit (zakonisht personat e angazhuar për PSHN) nga disa nga ndërmarrjet që të merren më shumë informata për qëndrimet e tyre lidhur me bashkëpunimin e OQ. Dy ndërmarrje nga lista (Tineks-MT dhe Birraria Shkup) nuk kanë ueb faqe të kapshme (të njëjta janë në përpunim). Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, këto ndërmarrje nuk u analizuan edhe pse në opinion janë shpallur informata për aktivitetet e tyre në fushën e PSHN.

Shumica nga gjysma e ndërmarrjeve nuk i shpallin raportet vjetore për punën në Republikën e Maqedonisë në ueb faqet e tyre, kështu që ato nuk janë të kapshme deri te opinioni më i gjerë. Prej tyre, vetëm një ndërmarrje, Çimentorja Usje Shkup (pjesë e Grupacionit Titan) sivjet publikon raport vjetor për përgjegjësi shoqërore për vitin 2009. Ndërmarrjet Telekom i Maqedonisë, T-Mobile Maqedonia dhe Alkaloid përfshijnë informata për aktivitetet nga fusha e përgjegjësisë shoqërore në kuadër të raportit integral vjetor. Ndërmarrjet si OKTA, EVN Maqedonia dhe Arcelomittal nuk i shpallin raportet e ndara për PSHN për Maqedoninë, por grupacionet të cilat janë pronarë të tyre prodhojnë raporte të përgjithshme për PSHN, të cilat në vëllim të vogël përmbajnë edhe informata për operacionet në Maqedoni. Disa ndërmarrje (Feni industri, EVN Maqedonia, OKTA) paralajmëruan se do të fillojnë me prodhimin e raporteve të ndarja për PSHN duke filluar nga ky vit (në vitin 2011 i cili ka të bëjë me vitin 2010). Rreth gjysma e ndërmarrjeve inkuadrojnë informata lidhur me kontestin e PSHN në vetë ueb faqet (te disa ato janë nën emrin “qëndrueshmëri”, “rrethinë” etj.). Një nga ndërmarrjet (Euro Tabak) nuk shpall kurrfarë informata lidhur me PSHN.

Nga analiza e raporteve dhe informatave ekzistuese në përgjithësi mund të thuhet se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të hulumtuara kanë nivel të caktuar të vetëdijes së ngritur për rëndësinë e PSHN, aplikojnë praktika në segmente të caktuara të PSHN dhe synojnë të njëjtat ti përmirësojnë. Në angazhimet e veta për veprim shoqëror me përgjegjësi, ata i potencojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe kontributin e ndërmarrjeve ndaj avancimit të shoqërisë dhe mjedisit jetësor. Disa ndërmarrje e potencojnë rëndësinë e komunikimit me palët e prekura.

Lidhur me aktivitetet konkrete që i ndërmarrin në fushën e PSHN, mjedisi jetësor she shëndeti dhe siguria janë fushat kryesore për të gjitha ndërmarrjet nga veprimtaria prodhuese dhe furnizimi me lëndë energjie. Pothuaj të gjitha ndërmarrjet prej këtyre veprimtarive kanë fituar certifikata adekuate, të njohura në botë (p.sh. ISO 14001:2004,

ISO 9001:2000, SAS 18001 etj.). Për të gjitha pothuaj ndërmarrjet, të punësuarit paraqesin një nga palët prioritare të prekura në fushën e PSHN.

Donacionet dhe sponsorizimet gjithashtu paraqesin një pjesë të rëndësishme nga praktikat në fushën e PSHN. Në vitin 2009, 26.5% të organizatave qytetare kanë pasur të ardhura prej sektorit afarist dhe mesatarisht donacionet nga sektori afarist janë rreth 15% në buxhet vjetore të OQ. Të gjitha ndërmarrjet e përfshira me hulumtimin kanë dhënë mbështetje të rëndësishme financiare dhe materiale në më shumë segmente nga jeta shoqërore. Disa nga ndërmarrjet (Telekomi i Maqedonasë, T-Mobile, Alkaloidi) veçanërisht e theksojnë këtë aspekt nga PSHN e tyre në kuadër të raporteve vjetore me informata për fushat të cilat janë mbështetur, si dhe pranuesit e donacioneve dhe sponsorizimeve. T-Mobile dhe Alkaloid kanë formuar fondacione korporatave (fondacioni T-Mobile dhe Fondacioni “Trajçe Mukaetov”) përmes së cilave në mënyrë sistemore realizojnë një pjesë të aktiviteteve të tyre filantropike. Fusha të preferuara për mbështetje përmes donacioneve dhe sponsorizimeve janë sporti, arsimiti, kultura dhe shëndetësia.

Është interesante të përmendet se ndërmarrjet zakonisht i përfshijnë donacionet dhe sponsorizimet nën një emërues të përbashkët edhe pse sponsorizimet sipas karakterit të tyre bazohen në raport komercial dhe duhet të jenë pjesë thelbësore e marketing strategjisë (derisa donacionet bien në aktivitete për zhvillim të bashkësisë). Kjo tregon se numri më i madh i ndërmarrjeve vendosin theks në ndikimin që filantropia korporatave mund ta ketë për imazhin e brendit dhe ndërmarrjes.

Pikë e dobët në qasjen e PSHN të aplikuara nga ana e ndërmarrjeve të hulumtuara është avancimi me rezultatet nga PSHN. Përveç Çimentoresh Usje e cila në raportin e vet për PSHN ka të dhëna të hollësishme dhe kuantitative për rezultatet e arritura me indikator të veçantë për segmentet e ndryshme të PSHN në krahasim me vitet, si edhe Alkaloid në segmente të caktuara, ndërmarrjet tjera zakonisht vetëm i numërojnë aktivitetet e realizuara pa vështrim të rezultateve dhe ndikimin e arritur, nivelin e realizimit të qëllimeve në fusha të ndryshme të PSHN etj. Gjithashtu, te pothuaj të gjitha ndërmarrjet ekziston mungesë e informatave lidhur me mjetet e investuara, për shembull të donacioneve dhe sponsorizimeve. Në aplikacionet e Çmimit nacional për PSHN, një pjesë e ndërmarrjeve të hulumtuara i kanë çekur mjetet financiare të investuara në projekt të caktuar për PSHN, por këto të dhëna nga shumica e ndërmarrjeve trahtohen si të besueshme dhe nuk publikohen në opinion. Kjo është në kundërshtim me praktikën në suaza botërore ku ndërmarrjet publikisht i shpallin informatat për mjetet e dhuruara ose mjetet e investuara në fusha tjera të PSHN.

#### » **Bashkëpunimi me organ zatat qytetare**

Duke se OQ nuk paraqesin palë kyçe të prekur për numrin më të madh të ndërmarrjeve të hulumtuara. Në fushën e PSHN ato shpesh paraqiten si shfrytëzues të donacioneve bashkë me pranuesit tjerë (shkollat, universitetet, komunat, institucionet shëndetësore, manifestimet kulturore dhe sportive etj.), te të cilat kanalizohet pjesa më e madhe e

donacioneve. Nga OQ me të cilat më shpesh bashkëpunohet zakonisht paraqiten klubet sportive (si pranues të sponsorizimeve), shoqatat profesioniste dhe odat, shoqatat të cilat punojnë me grupet e marginalizuara (p.sh. personat me nevoja të veçanta) etj. Nuk vërehet përkushtim strategjik i zhvillimit dhe mbështetjes institucionale të OQ si segment i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë dhe avokimit të interesave të qytetarëve. Vetëm ndërmarrjet si Telekom i Maqedonisë dhe T-Mobile e kanë cekur në mënyrë të qartë OQ si fushë për mbështetje, por kjo është e kyçur në bashkë me arsimin dhe pjesa më e madhe e donacioneve janë orientuar ndaj këtij segmenti.

Megjithatë gjatë viteve të fudnit te disa nga ndërmarrjet e hulumtuara vërehen forma të reja të bashkëpunimit me organizatat qytetare. EVN Maqedonia nga viti 2007 në vazhdimësi e realizon projektin “Servisi shkollor” për edukimin e fëmijëve nga shkollat fillore për shfrytëzimin e arsyeshëm të energjisë elektrike. Projekti në tërësi është realizuar nga grupi i OQ (të cekura në kapitullin e mëparshëm) në bashkëpunim me shkollat dhe të punësuarit në EVN Maqedoni dhe deri tani janë përfshirë 285 shkolla dhe 32.272 nxënës në Maqedoni. Organizatat qytetare jo vetëm që e zbatojnë projektin, por janë inkuadruar edhe në zhvillimin e ideve për përmirësimin e tij, e kështu projekti nga viti në vit vazhdimisht zhvillohet dhe është fitues i Çmimit nacional për PSHN për vitin 2008 në kategorinë “Investimi në bashkësi”. Qasja e këtillë tregon se kur do të shoqërohen resurset e sektorit afarist dhe civil arrihen rezultate më të mëdha, si dhe në adresimin e problemeve të caktuara shoqërore, kështu edhe në pjesëmarrjen e masave të PSHN për vetë ndërmarrjen.

Përpjekjet për inkuadrimin e palëve të interesuara janë një nga aspektet kyçe të qasjes së PSHN të ndërmarrjes Çimentorja Usje. Krahas veglave të zakonshme për informim të palëve të prekura, Çimentorja Usje filloi dialog aktiv me aktorët relevant. Në vitin 2010 ndërmarrja e realizoi Forumin e parë të ashtuquajtur “Përgjegjësi-partneritet-zhvillim” në të cilin përveç të punësuarve, furnizuesve, përfaqësuesve të institucioneve dhe ndërmarrjeve tjera u ftuan dhe morën pjesë një numër i madh i OQ, të cilët veprojnë në fusha prioritare të PSHN për vetë ndërmarrjen, si për shembull mjedisi jetësor, siguria dhe shëndeti, PSHN, mbështetje bashkësive etj. Në forum u prezantuan drejtimet strategjike dhe rezultatet e Çimentores Usje në fushën e PSHN, pas çka pjesëmarrësit patën mundësi të parashtronjë pyetje dhe të iniciojnë debat në këtë temë. Çimentorja Usje është e përkushtuar edhe më tej të realizojë aktivitete të cilat në thelb do ti inkuadrojnë palët e prekura, që hap mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të partneriteteve me sektorin civil.

“Bashkëpunimi i ndërmarrjeve të mëdha me OQ do të ishte i dobishëm për ndërmarrjet pasiqë aktivitet për PSHN do të ishte më i suksesshëm, ndërsa dukshmëria do të ishte më e madhe. Gjithashtu, OQ do të ndihmojë për detektimin e problemeve në fushën që e trajton ndërmarrja. Që të arrihet qasje sistemore gjatë realizimit të donacioneve

ose sponsorizimeve, ndërsa të shmangen konfliktet e interesit të nevojshëm për bashkëpunim me OQ, prandaj OQ do të kishin rol në drejtim të kredibilitetit të aktivitetit, si ndërmjetësues ose si zbatues të drejtpërdrejt.”.

z. Goran Llazarevski,  
Kryetar i Trupit koordinues nacional për PSHN

Nga kjo që u përmend më sipër, mund të përfundohet se nga aspekti i bashkëpunimit të ndërmarrjeve të mëdha me OQ, në Maqedoni akoma ka hapësirë të madhe për përmirësim. Bashkëpunimi në pjesë të madhe realizohet ad-hok dhe është sjellë në orientimin e donacioneve dhe sponsorizimeve ndaj OQ. Bashkëpunimi mes ndërmarrjeve dhe OQ duhet të sistemohet dhe të jetë pjesë e strategjisë për PSHN të ndërmarrjeve. Shembujt e përmendur paraqesin praktika të mira të cilat në vitet e ardhshme do të mund ti nxisin edhe ndërmarrjet tjera të mëdha të mendojnë në këtë drejtim.

# PËRFUNDIME PËRMBLEDHËSE

## » **Përgjegjësia shoqërore e ndërmarrjeve në Maqedoni – trendët e përgjithshëm**

Në Maqedoni, PSHN është relativisht koncept i ri, cili për ndërmarrjet kryesisht paraqet shtesë të punës themelore afariste në vend të pjesës integrale nga udhëheqja me ndërmarrjet. Gjatë viteve të fundit nga ana e Qeverisë dhe Ministrisë së Ekonomisë janë bërë hapa të mëdha për promovimin dhe nxitjen e PSHN, siç është miratimi i agjendës nacionale për PSHN, vendosja e çmimeve nacionale në segmente të ndryshme të PSHN etj. Megjithatë, ekziston mungesë e vetëdijes dhe kapaciteteve për integrimin e PSHN në punën e përgjithshme të ndërmarrjes. Në pjesën më të madhe, vendosja e PSHN në ndërmarrje është motivuar nga pjesëmarrja pozitive që ajo mund të ketë mbi imazhin e brendit ose të ndër, marrjes, si edhe nga motivet altruiste edhe pse ndërmarrjet më të mëdha e lidhin konceptin me zhvillimin e qëndrueshëm

## » **PSHN te ndërmarrjet më të mëdha në Maqedoni**

Më shuma se gjysma e 10 ndërmarrjeve më të mëdha nuk i publikojnë raportet vjetore për punën në Republikën e Maqedonisë në ueb faqet e tyre. Vetëm një ndërmarrje ka publikuar raport vjetor për përgjegjësinë shoqërore për vitin 2009, ndërsa tre të tjera kanë publikuar informata për PSHN në kuadër të raporteve vjetore të ndërmarrjes. Siç tregojnë edhe hulumtimet ekzistuese në këtë fushë, edhe te ndërmarrjet më të mëdha pikë e dobët është menaxhimi me rezultatet nga PSHN dhe publikimi i treguesve financiar që është praktikë e vendosur e rregullt në suaza botërore. Fushat e mjedisit jetësor, shëndeti dhe siguria dhe resurset njerëzore janë fushat më të rëndësishme të PSHN për ndërmarrjet më të mëdha.



### » **Bashkëpunimi i organizatave qytetare dhe sektorit afarist**

Organizatat qytetare nuk janë lëvizësi i rëndësishëm i PSHN në R. Maqedonisë. Janë të rralla shembujt e OQ të cilat bëjnë presion mbi sektorin afarist dhe rregullisht e ndjekin pjesëmarrjen e ndërmarrjeve në fushën e PSHN. Bashkëpunimi mes dy sektorëve vazhdimisht përparon por akoma është në nivel të pamjaftueshëm dhe ka të bëjë me iniciativa individuale të disa ndërmarrje dhe shoqata, të cilat e kanë njohur dobinë dhe interesin e dyanshëm për bashkëpunim.

Donacionet dhe sponsorizimet janë forma më dominuese e interaksionit mes sektorit afarist dhe qytetar. Shumica e OQ shohin në sektorin afarist si burim të mjeteve financiare për punën e tyre. Edhe krahas ndërmarrjeve më të mëdha në RM donacionet dhe sponsorizimet drejt OQ janë forma më e shpeshtë e bashkëpunimit. Por, bile edhe në këtë fushë nuk është arritur optimumi. Edhe pse sipas Regjistrisë qendror, në vjet ndërmarrjet veçojnë rreth 7 milionë euro për donacione dhe sponsorizime, pranues më të shpeshtë të kësaj mbështetje (me përjashtim të shoqatave sportive) janë institucionet publike dhe manifestimet kulturore dhe sportive. Trend i njëjtë është vërejtur edhe te ndërmarrjet më të mëdha në Maqedoni.

Megjithatë ekzistojnë indikacione se bashkëpunimi mes sektorit afarist dhe civil do të zhvillohet nëpër linjë të epërme gjatë viteve të ardhshme. Në Maqedoni gjatë viteve të fundit rritet numri i OQ të cilat në punën e tyre inkorporojnë aktivitete programore në fushën e PSHN ose përgatisin strategji për grumbullimin e mjeteve nga sektori afarist. U themeluan edhe organizata të specializuara për PSHN të cilat bashkëpunojnë me ndërmarrjet në këtë fushë. Disa nga ndërmarrjet më të mëdha realizojnë projekte në bashkëpunim me OQ lokale ose ndërmarrin aktivitete për zgjerimin e dialogut dhe inkuadrimit të OQ në kuadër të strategjive për PSHN. Implementimi konsistent i politikave nacionale në fushën e PSHN dhe krijimi i legjislativit adekuat dhe korniza tatimore të kontribuojë për ndryshime thelbësore në këtë fushë.



# ANEKSI 1

## 10 NDËRMARRJET MË TË MËDHA SIPAS „SEE NEWS“

( në euro, nëse nuk është cekur ndryshe)

Nr.	SEE TOP100 Nr.	Emri i ndërmarrjes	Gjithsej të ardhura 2009	Ndryshimi vjetor i të ardhurave	Neto profiti/humbja 2009	Neto profiti/humbja 2008
1	81	SHA Okta	402.420.570	-38,02 %	2.148.179	-22.424.148
2	143	SHA Telekomunikacioni i Maqedonisë	301.897.498	-5,62 %	112.944.606	101.850.282
3	153	SHA Makpetroll	285.766.267	-27,73 %	-4.659.214	4.258.746
4	173	SHA Elem	265.162.780	32,98 %	3.137.013	-3.586.132
5	274	SHA T-Mobile Maqedoni	176.072.302	-2,76 %	65.700.846	70.934.266
6	470	SHA Alkaloid	79.004.008	9,62 %	8.226.920	7.347.820
7	476	SHA Usje, Shkup	76.736.970	-9,85 %	25.120.788	20.996.379
8	487	SHA Makstill	71.513.718	-36,07 %	26.433	1.111.869
9	495	SHA Arcelomittal Shkup	68.763.625	-47,00 %	-18.924.840	-6.264.436
10	496	SHA Birraria Shkup	68.644.079	-6,51%		

## 10 NDËRMARRJET MË TË MËDHA SIPAS EURO BIZNES QENDRËS - SHKUP

Rangu 2009	Rangu 2008	Ndërmarrja	Veprimtaria	Të ardhurat e përgjithshme në denarë
1	1	SHA OTKA – SHKUP, Shkup	Nafta dhe derivatet e naftës	25.214.932.283
2	3	SHA EVN MAQEDONI, Shkup	Distribuimi dhe furnizimi me energji elektrike	21.310.411.824
3	2	SHA MAKPETROLL, Shkup	Nafta dhe derivatet e naftës	17.481.236.779
4	6	SHA ELEKTRANET E MAQEDONISË, Shkup	Prodhimi i energjisë elektrike	16.220.855.789
5	4	SHA TELEKOMI I MAQEDONISË - SHKUP, Shkup	Komunikime elektronike	13.596.459.598
6	7	SHA T-MOBILE MAQEDONI, Shkup	Telekomunikime	10.770.906.173
7	5	SHA FENI INDUSTRI, Kavadar	Metalurgjia e zezë dhe me ngjyra	9.138.591.980
8	15	EURO RABAK, Shkup	Distribuimi	5.463.359.041
9	19	TINEKS-MT, Shkup	Tregtia me pakicë në dyqane me mall të ndryshëm	4.934.485.157
10	22	SHA ALKALOID, Shkup	Industria farmaceutike, kimike dhe kozmetike	4.845.399.239
11	17	SHA USJE, Shkup	Materiale ndërtimore	4.738.124.478

## *Literatura e shfrytëzuar:*

- Alkaloid Shkup (2009), Annual Report 2009
- Ueb resurset e 10 ndërmarrjeve më të mëdha në Maqedoni
- Qeveria e R. Maqedonisë (2008), Agjenda nacionale për përgjegjësi shoqërore e ndërmarrjeve për Republikën e Maqedonisë 2008-2012
- International Organisation for Standardization (2009), Guidance on social responsibility, Draft International Standard ISO/DIS 26000
- Konekt (2010), Konferenca për filantropi, video regjistrime
- Trupi koordinues për PSHN të Republikës së Maqedonisë (2010) – Nga iniciativa deri te lideri rajonal 2007-2009
- SHA Telekom i Maqedonisë – Shkup, T-Mobile Maqedoni (2009), Informata... komunikacione..zbavitje, Raport vjetor 2009
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (2010), Vetëperceptimi për shoqërinë civile
- SHA Makpetroll (2010), Mbledhja e XIII e kuvendit të aksionarëve, raport
- M. E. Porter and M. R. Kramer (2011), Creating Shared Value, Harvard Business Review
- Nikica Kusnikova (2010), Rruga deri te mbështetja efektive e bashkësisë, Konekt
- Projekte të dorëzuara për Çmimin nacional për PSHN për vitin 2008 dhe 2009
- Prof. Dr. Vlladimir Petkovski dhe Aleksandar Nikollov (2007), Studim referencues për përgjegjësinë shoqërore të ndërmarrjeve në IRJ Maqedonisë, UNDP
- Titan Çimentorja Usje (2009), Raport për përgjegjësinë korporatave shoqërore dhe zhvillim të qëndrueshëm
- UNDP, Mark Line, Robert Brown (2007), Baseline Study on CSR practices in the New EU Member States and Candidate Countries

# — STRATEGJIA PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN CIVIL A KONTRIBUOI PËR PËRMIRËSIMIN E DIALOGUT MES QEVERISË DHE SHOQËRISË CIVILE —

## REZYME

This case study examines the implementation of the Strategy for cooperation with the civil society sector adopted by the Government of the Republic of Macedonia in January 2007. It understands the development of civil society as an essential element of the process of democratization in the conditions of post-communism. The case study analyses the process of adoption of the most important legal projects of the Strategy, i.e. the Law on Volunteering and the Law on Associations and Foundations in order to determine the essential improvement in the period of the implementation of this document. The case study uses a qualitative methodology and it is based on primary and secondary literature from local and international sources. The case study points to the mixed record of implementation of the Strategy in terms of the processes surrounding the adoption of the most important legislative acts and underscores the variety and contradiction of opinions between domestic and international organisations in terms of the implementation of the Strategy.

## HYRJE

Ky studim i rastit e hulumton zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil të miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në janar të vitit 2007. Kjo e nënkupton zhvillimin e shoqërisë civile si element thelbësor për procesin e demokratizimit në kushte të post komunizmit. Studimi i rastit fillon nga supozimi se zhvillimi i një shoqërie efektive civile varet nga mbështetja nga shteti dhe vendosja e mekanizmave për bashkëpunim me institucionet shtetërore. Duke u nisur nga ky argument, studimi i

rastit potencon se raporti mes institucioneve qeveritare dhe organizatave qytetare është indikator për suksesin e procesit të konsolidimit demokratik.

Analiza përbëhet prej katër pjesëve kryesore. Pjesa e parë merret me definicionin e termit shoqëri civile, siç përdoret në këtë studim dhe jep sqarim të përfshirjes dhe përdorimit të tij konkret. Pjesa e dytë e hulumton raportin mes shtetit dhe organizatave qytetare edhe në literaturën akademike dhe në atë praktike, që të jep sqarime pse bashkëpunimi me këtyre dy sektorëve është i rëndësishëm për procesin e demokratizimit. Pjesa e tretë e paraqet kontekstin e Maqedonisë post komuniste dhe procesin e miratimit të Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil. Pjesa e katërt e analizon miratimin e projekt ligjeve më të rëndësishme nga Strategjia për bashkëpunim me sektorin civil, që të identifikojë çdo përmirësim thelbësor në periudhën e zbatimit të këtij dokumenti. Në fund, studimi i prezanton përfundimet e analizës.

Ky hulumtim përdor metodologji komparative dhe bazohet në literaturë primare dhe sekondare. Literatura teorike për ndërtimin e shoqërisë civile në kushte të post komunizmit përdoret për vendosjen e kornizës konceptuale për studim. Përveç kësaj, janë analizuar edhe raportet dhe studimet për zhvillimin e sektorit civil në Maqedoni nga burime nga vendi dhe ndërkombëtare, për zbatimin e vlerësimit. Nga ana e vendit, studimi i rastit përdor literaturën nga organizatat qytetare (OQ)<sup>84</sup> dhe nga burime qeveritare, pasi që ata kanë pikëpamje të kundërta rreth kësaj. Nevoja që të shihen raportet e përgatitura nga aktorët ndërkombëtar është rezultat i rolit të gjerë që e kanë organizatat ndërkombëtare dhe donatorët në zhvillimin e shoqërisë civile në rastin e Maqedonisë.<sup>85</sup>

Studimi i rastit e thekson rezultatin e përzier nga zbatimi i Strategjisë në raport me procesin që e ndjek në miratimin e akteve më të rëndësishme ligjore. Ajo gjithashtu e thekson llojllojshmërinë dhe kontradiktoren e mendimeve mes organizatave nga vendi dhe ndërkombëtare lidhur me zbatimin e Strategjisë. Kjo kontradiktë flet për mungesën e qasjes sistemore ndaj këtyre çështjeve dhe varësinë e tyre nga rasti konkret i cili analizohet. Në përgjithësi, studimi i rastit më tej e thekson nevojën për analizë thelbësore të fushave të caktuara të veprimit të shoqërisë civile dhe vështirësitë në nxjerrjen e përfundimeve të përgjithshme në fushë të këtyre dinamikave.

84 Edhe pse termi OQ përdoret për unifikim të terminologjisë, studimi gjithashtu e përdor edhe termin OJQ në raste kur citohen burime të tjera.

85 Shih te Simonida Kacarska, Gorica Atanasova, "The Role of External actors in Civil Society Building: the Case of the Republic of Macedonia", *CEU Political Science Journal* 01/2009. Mund të merret në <[http://www.ceu.hu/sites/default/files/field\\_attachment/page/node-5733/ceupolscijournaliv1.pdf](http://www.ceu.hu/sites/default/files/field_attachment/page/node-5733/ceupolscijournaliv1.pdf)> (Është qasur më 12 dhjetor 2010).



## 1. SQARIMI I DEFINICIONIT – ÇFARË NËNKUPTJË NËN SHOQËRI CIVILE?

Për qëllimet e kësaj analize, shoqëria civile kuptohet në raport me definicionin nga hulumtimi i CIVIKUS – Indeksi i shoqërisë civile në Maqedoni nga viti 2005. Sipas këtij raporti, termi shoqëri civile i përmbledh “të gjitha shoqatat formale dhe joformale të qytetarëve, organizatat dhe rrjetet të cilat e plotësojnë hapësirën shoqërore jashtë familjes, sektorit afarist, partive politike dhe sektorit qeveritar, të cilat shoqërohen të promovojnë qëllime dhe interesa të përbashkëta”.<sup>86</sup> Ky definicion dallohet nga definicioni tradicional i CIVIKUS, i cili shoqërinë civile e nënkupton si “hapësirë mes familjes, shtetit dhe tregut, ku njerëzit shoqërohen që ti ndjekin interesat e tyre”.<sup>87</sup> Raporti i CIVIKUS për Maqedoninë jep definicion më kufizues për shkak të idiosinkrezës së kontekstit maqedonas, i cili përfshin definicionin e vet të vlerave, natyrës jopartiake dhe përjashtimin e partive politike për të cilat ka ligje të veçanta.<sup>88</sup>

Megjithatë, hulumtimi bën dallim se rëndësia e termit shoqëri civile është lëndë e mospajtimit edhe në rrethet akademike dhe në praktikë. Ky mospajtim është rezultat i vështirësisë që të tërhiqen kufi të caktuar mes fushave të ndryshme. Që këtu, hulumtimi dallon se ka literaturë të caktuar që shoqërinë civile e nënkupton në terme më të gjera, duke pohuar se kufijtë mes partive politike dhe shoqërisë civile mund të lirohen bile edhe nëse e pranojmë dallimin mes tyre, siç shpesh bëhet në pjesën më të madhe të literaturës moderne për demokratizimin.<sup>89</sup> Këta autorë angazhohen për inkuadrimit në konceptin e shoqërisë civile të lëvizjeve joqytetare, partive politike, dhe politika e mospajtimit edhe në bazë konceptuale dhe empirike. Ngjashëm me këtë, Dražek pohon se në rastin e Evropës Lindore, mobilizimi i “shoqërisë civile” përkundër shtetit e ndjek inkuadrimit e shoqërisë civile në shtet, që në fund ka ndikuar negativisht në zhvillimin e tij.<sup>90</sup> Prandaj kjo literaturë e ndjek logjikën e të menduarit, e cila e pranon definicionin e përgjithshëm të shoqërisë civile të CIVIKUS, që përfshinë koalicionet dhe grupe joformale, si edhe manifestime negative të shoqërisë civile.

Më tej, Në tetor të viti 2009, komiteti këshillëdhënës i CIVIKUS – Indeksi i shoqërisë civile për Maqedoninë miratoi definicion të ri dhe të reviduar të termit shoqëri civile në

86 “Pas 15 vjet tranzicion – nga stabilizimi drejt pjesëmarrjes qytetare” CIVIKUS Indeksi i shoqërisë civile, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Nëdrkombëtar, Shkup, 2005, fq. 27. Mund të merret në: <[www.mcms.org.mk](http://www.mcms.org.mk)> (Është qasur më 5 dhjetor 2010).

87 CIVICUS Civil Society Index, Summary of conceptual framework and research methodology <[http://www.civicus.org/new/media/CSI\\_Methodology\\_and\\_conceptual\\_framework.pdf](http://www.civicus.org/new/media/CSI_Methodology_and_conceptual_framework.pdf)> (Është qasur më 8 dhjetor 2010).

88 Shih “Pas 15 vjet tranzicion – nga stabilizimi drejt pjesëmarrjes qytetare” CIVIKUS Indeksi i shoqërisë civile fq. 27.

89 Petr Kopecký and Cas Mudde (2003) ‘Rethinking civil society’, *Democratization*, 10:3, 1 - 14

90 John Dryzek, ‘Political Institutions and the Dynamics of Democratization’, *American Political Science Review*, Vol.90, No.1 (1996), fq. 475–87.



raport me Maqedoninë. Sipas këtij definicioni, “shoqëria civile është pjesë e hapësirës shoqërore jashtë familjes, shtetit dhe tregut, e krijuar nga individë dhe aktivitete kolektive dhe institucione për realizimin e interesave të përbashkëta”.<sup>91</sup> Ky definicion gjithashtu i cakton kategoritë dhe nënkategoritë e shoqërisë civile: shoqatat dhe fondacionet, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, partitë politike dhe bashkësitë religjioze. Prandaj definicioni i ri është më i gjerë nga definicioni i komitetit këshillëdhënës të CIVIKUS nga viti 2005, që përdoret në këtë hulumtim, veçanërisht pasi që i përfshinë edhe partitë politike. Ndryshimi i definicionit të shoqërisë civile është indikative për natyrën dinamike të procesit i cili hulumtohet dhe nevojën për vëzhgim të vazhdueshëm të zhvillimit të kontekstit konkret të analizës.

Edhe krahas plotësimit të definicionit në vitin 2009, hulumtimi e shfrytëzon qasjen më të ngushtë të definicionit të CIVIKUS nga viti 2005, më së shumti për shkak të përdorimit të tij në Strategjinë për bashkëpunim me sektorin civil dhe prandaj nuk i përfshinë partitë politike. Në këtë mënyrë, ky hulumtim pranon se natyra e një shoqërie civile në zhvillim është e ndryshme për çdo vend, dhe “në masë të madhe varet nga precedenca historike, kultura politike (veçanërisht aftësia e shoqërisë që të organizohet dhe raporti i klasave shoqërore), formave të veçanta të nacionalizmit, dhe konteksti shoqëror i zhvillimit institucional”.<sup>92</sup> Si rezultat, hulumtimi thekson se shoqëria civile nuk mund të hulumtohet në izolim nga zhvillimi i përgjithshëm politik dhe shoqëror në rastin konkret dhe kushtet kohore. Që këtu, ky studim e hulumton raportin e OQ me institucionet shtetërore si element i rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë civile nga viti 2007 në rastin e Maqedonisë.

## **2. ÇFARË ROLI KA SHOQËRIA CIVILE DHE SHTETI NË KONTEKSTIN POST-KOMUNIST?**

Zhvillimi i shoqërisë civile në vendet në tranzicion llogaritet për element të rëndësishëm në procesin e demokratizimit.<sup>93</sup> Hulumtimet theksojnë më shumë se zhvillimi i një shoqërie efikase qytetare, veçanërisht në kushtet e post komunizmit, nuk mund të bëhet në izolim nga zhvillimi i institucioneve funksionale shtetërore. Sipas Jakubovic, shoqëria civile “mund të ndërtohet vetëm nëse ka vendosmëri të gjerë të një pjese të shoqërisë të kërkohet respektimi i të drejtave individuale qytetare, dhe vullnet i gjerë që të thirren në

91 Definicioni është marrë me anë të postës elektronike nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, që e zbaton hulumtimin e CIVIKUS për Maqedoninë.

92 Marcia Weigle and Jim Butterfield, “Civil Society in Reforming Communist Regimes: The Logic of Emergence,” *Comparative Politics*, Vol.25, No1 (Oct., 1992), fq. 2.

93 Andrew Janos, *East Central Europe in the Modern World*, Stanford University Press, 2000; Juan J Linz and Alfred Stepan, *Problems of Democratic Transition and Consolidation*, Johns Hopkins University Press, 1996.

përgjegjësi secili, ose çdo institucion, i cili i shkel. Kjo nuk mund të bëhet pa mbështetjen e institucioneve të shtetit”.<sup>94</sup> Kështu, shoqëria civile, e veçanërisht regjimet në tranzicion e imponojnë nevojën nga mbështetja e shtetit. Deri sa nën komunizmin parakushtet juridiko-politike për simbiozë të këtillë sipas definicionit mungojnë, pasi që shoqëria civile është përgjigje antagoniste me potencial që të ndryshojë raporti i fuqisë, në demokraci, shoqëria civile është pjesë integruese e sistemit të sundimit.<sup>95</sup> Për Dajmond, shoqëria civile jo vetëm që e kufizon fuqinë e shtetit, por edhe e legjitimon autoritetin e shtetit ku ai bazohet në sundimin e të drejtës.<sup>96</sup> Mark Morje Hauard në studimin e tij të bazuar në punë ekstensive në terren në Evropën post komuniste vjen deri te përfundimi se shteti i fuqishëm dhe stabil e mbështet zhvillimin e shoqërisë civile.<sup>97</sup> Hulumtimet e paradokohshme për Maqedoninë gjithashtu theksojnë se mungesa e bashkëpunimit mes dy sektorëve veçanërisht ndikon negativisht në zhvillimin e shoqërisë civile.<sup>98</sup>

Në përgjithësi, literatura flet se mbështetja nga shteti dhe bashkëpunimi me institucionet shtetërore gjithnjë e më shumë është me rëndësi të madhe për procesin e demokratizimit. Në kushtet e Evropës Qendrore dhe Lindore ose në çdo shoqëri në tranzicion, për shtetin është shumë e rëndësishme që të luajë rol kyç në proces. Qëndrimi i Dalgren për nevojën për demokratizimin e dyfishtë të shtetit dhe të shoqërisë civile jep ilustrim të dobishëm për këtë: “Çdo palë [...] është parakusht për demokratizimin tjetër [...] Nëse shteti është shumë i dobët, nuk mund të nxitë demokratizim të shoqërisë civile. Nëse është shumë e fuqishme, bëhet shumë intervenuese; pa shoqëri stabile civile, shteti bëhet shumë prezent. Demokratizimi i shoqërisë civile ka lidhje me zhvillimin e kulturës ose mentalitetit demokratik në kontest të jetë së përditshme”.<sup>99</sup> Mu për këtë, ky studim e hulumton zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil në rastin e Maqedonisë në dy pjesët e ardhshme..

94 Karol Jakubowicz, “Civil Society and Public sphere in Central and Eastern Europe – A Polish Case Study”, *Nordicom Review* 2/1996, Available at: <[http://www.nordicom.gu.se/common/publ\\_pdf/27\\_JAKUBO.pdf](http://www.nordicom.gu.se/common/publ_pdf/27_JAKUBO.pdf)>, p. 42 (Është qasur më 17 dhjetor 2010).

95 Guiseppe Di Palma, “Legitimation from the Top to Civil Society: Politico-Cultural Change in Eastern Europe”, *World Politics*, Vol.44, No1 (Oct., 1991), 49-80. fq. 63.

96 Larry Diamond, “Towards Democratic Consolidation”, *Journal of Democracy*, Vol.5, No.3, July 1994.

97 Marc Morje Howard, *The Weakness of Civil Society in Post/Communist Europe*, Cambridge: Cambridge University Press, 2003. fq. 17.

98 Kacarska, Simonida. *Organizatrat qytetare në Republikën e Maqedonisë* [Citizen organizations in the Republic of Macedonia], Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, 2008.

99 Peter Dahlgren, *Television and the Public Sphere. Citizenship, Democracy and the Media*. London: Sage, 1995 fq. 6.

### 3. RASTI I MAQEDONISË -- KONTEKSTI

Pas ekspozimit të sqarimeve për definicionin dhe qëllimin e analizës të raporteve shoqëri civile-shtet në kontekstet post-komuniste, kjo pjesë do të vazhdojë ta hulumtojë rastin empirik të Maqedonisë. Disa hulumtime paraprake janë marrë me trashëgiminë e periudhës komuniste dhe përvojat post komuniste për zhvillimin e shoqërisë civile maqedonase, prandaj për shkak të temës së saj konkrete të interesit ky studim i rastit nuk do të merret me këtë çështje.<sup>100</sup> Megjithatë, studimi e pranon rëndësinë e trashëgimisë historike në zhvillimin e fenomeneve shoqërore. Për qëllim të analizës që vijon, kjo pjesë do të prezantojë karakteristikat më të rëndësishme të rrethinës së jashtme dhe raportet shoqëri civile-shtet gjatë disa viteve para miratimit të Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil, të cilat e caktojnë kontekstin për zbatimin e saj.

Vlerësimi i CIVIKUS për shoqërinë civile në vitin 2005 si studim gjithëpërfshirës për Maqedoninë mendon se rrethina deri në një shkallë të caktuar është e pavoritshme, me shtet pjesërisht joefikas dhe me mungesë të madhe të besimit publik. Ai vlerëson se raportet mes shtetit dhe shoqërisë civile janë në kufirin mes atyre produktive dhe jo produktive. Rastet e përzjerjes së shtetit në OQ janë më të rralla dhe dialogu përmirësohet, edhe pse në bazë ad-hok.<sup>101</sup> Hulumtimet e mëparshme të këtij autori i cili i inkuadron intervistat gjysmë të strukturuar me aktivistë të OQ në periudhën prej vitit 2004-2007 gjithashtu flisnin në këtë drejtim. Bashkëbiseduesit e mi atëherë shpesh e shprehnin brengosjen e tyre për gjoja jo legjitimitetin e shoqërisë civile në prezantimin e interesave në opinion.<sup>102</sup> Jepen shembuj për përpjekjet për bashkëpunim me strukturat qeveritare të penguar nga ana e nëpunësve shtetëror me sqarim se OQ nuk janë zgjedhur dhe prandaj nuk kanë bazë të kërkojnë fjalë në procesin e vendimmarrjeve.<sup>103</sup>

Edhe pse kjo situatë u përmirësua shumë gjatë viteve të fundit, në vlerësimet për zhvillimin e shoqërisë civile në Maqedoni mbetet brengosja lidhur me pozitën e organizatave qytetare në shoqëri.<sup>104</sup> Përveç këtij vlerësimi të përgjithshëm për marrëdhëniet mes shtetit dhe shoqërisë civile, shpesh pranohet se bashkëpunimi mes dy sektorëve varet nga rasti konkret dhe nga personat të cilët janë të inkuadruar në atë.<sup>105</sup> Ngjashëm me këtë, në raportin

100 Shih Organizatave qytetare në Republikën e Maqedonisë [Citizen organizations in the Republic of Macedonia], "Pas 15 vjet tranzicion – nga stabilizimi drejt pjesëmarrjes qytetare", Gjorgje Ivanov, Dane Taleski, "Civil Society in South East Europe: The case of Macedonia." E publikuar nga the Institute for Democracy, Solidarity, and Civil Society. September 2003.

101 Shih "Pas 15 vjet tranzicion – nga stabilizimi drejt pjesëmarrjes qytetare" CIVIKUS Indeksi i shoqërisë civile fq. 81.

102 Intervistë personale me autorin në prill të vitit 2004.

103 Intervistë personale me autorin në prill të vitit 2004.

104 Për më shumë informata shihe Indeksën e qëndrueshmërisë të OJQ të USAID që gjendet në: <[http://www.usaid.gov/locations/europe\\_eurasia/dem\\_gov/ngoindex/](http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/)> dhe Raporti i Freedom Haus për Kombet në tranzicion, që gjendet në: <<http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=17>> (Është qasur më 10 dhjetor 2010).

105 Intervistë personale me autorin në shtator të viti 2007. Shih edhe: Pas 15 vjet tranzicion – nga stabilizimi drejt pjesëmarrjes qytetare" CIVIKUS Indeksi i shoqërisë civile, "Former Yugoslav Republic of Macedonia Needs Assessment Report".

analitik i cili është pjesë e Mendimit për aplikacionin e Maqedonisë për anëtarësim në BE nga viti 2005, Komisioni Evropian ka sjellë përfundim se “iniciativat qeveritare, si lehtësimet tatimore dhe koordinimi më i mirë mes autoriteteve dhe OJQ-ve, mbeten të domosdoshme për lehtësimin e mëtejshëm dhe mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile”.<sup>106</sup> Raporti i Komisionit Evropian për përparim nga viti 2006 përfundon se forcimi i shoqërisë civile kërkon koordinim të mëtejshëm mes OJQ-ve dhe autoriteteve.<sup>107</sup>

Lidhur me këtë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2007 e miratoi Strategjinë për bashkëpunim me sektorin civil në kuadër të projektit **Mbështetja teknike e departamentit për shoqëri civile pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë**, të financuar nga BE, ndërsa e realizuar nga COWI nga Danimarka, INTRAC nga Britania e Madhe dhe Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Duke pasur parasysh kontekstin e elaboruar paraprak për zhvillimin e shoqërisë civile, Strategjia dhe Plani adekuat aksionar për zbatimin e saj janë strukturuar rreth shtatë qëllimeve, të cilat përfshijnë edhe aktivitete formale dhe thelbësore të prezantuara më poshtë:

Qëllimet konkrete të inkaudruara në Strategjinë për bashkëpunim me sektorin civil 2007-2011:

**Qëllimi 1:** Mbindërtimi dhe përmirësimi i kornizës juridike për zhvillim të sektorit civil

**Qëllimi 2:** Pjesëmarrja e sektorit civil në krijimin e politikave

**Qëllimi 3:** Realizimi i bashkëpunimit ndërinstucional

**Qëllimi 4:** Realizimi i bashkëpunimit ndërsektorial

**Qëllimi 5:** Inkuadrimi i sektorit civil në procesin e integritimit në BE

**Qëllimi 6:** Krijimi i kushteve të volitshme për veprim të sektorit civil

**Qëllimi 7:** Zhvillim i vazhdueshëm i sektorit civil

Procesi i miratimit të Strategjisë në përgjithësi u vlerësua pozitivisht edhe nga ana e ekspertëve të vendit dhe nga ata ndërkombëtar. Vlerësimi i fundit për nevojat e shoqërisë civile maqedonase i përgatitur nga projekti **Ndihmë teknike organizatave qytetare në vendet e IPA (TACSO)**, e financuar nga BE e llogarit procesin e miratimit të Strategjisë si shumë inkluzive. Raporti vazhdon me pohimin se mbështetja e BE ka mundësuar të sigurohet ekspertizë adekuate për përgatitjen e dokumentit, si dhe pjesëmarrje e gjerë e shoqërisë civile në dizajnin, duke përfshirë 380 OQ dhe 6 debate të gjera publike. Procesi participativ ishte i dobishëm edhe për të dy palët që të arrijnë qartësi lidhur me pritjet e tyre, dhe të

<sup>106</sup> Analytical report for the Opinion on the application from the former Yugoslav Republic of Macedonia for EU membership. Commission Staff Working Paper, November 2005. Brussels: Commission of the European Communities, gjendet në: <[http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key\\_documents/2005/package\\_sec\\_1425\\_final\\_analytical\\_report\\_mk\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package_sec_1425_final_analytical_report_mk_en.pdf)> (Është qasur më 19 dhjetor 2010).

<sup>107</sup> The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2006 Progress Report Commission Staff Working Paper. Brussels: Commission of the European Communities, gjendet në: <[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2006/nov/fyrom\\_sec\\_1387\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2006/nov/fyrom_sec_1387_en.pdf)> (Është qasur më 16 dhjetor 2010).

sigurojnë prioritet kyçe të OQ që të inkuadrohen në dokumentin përfundimtar.<sup>108</sup> Përveç vlerësimit të TACSO, në përgjithësi miratimi i Strategjisë pozitivisht u vlerësua nga shoqëria civile.

Megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se procesi i miratimit të Strategjisë në masë të madhe ishte lehtësuar me fondet e BE të dhëna për procesin dhe stimulimin e përgjithshëm të procesit të dhënë nga integrimi evropian i vendit në këtë moment. Për ilustrim, miratimi i Strategjisë ishte paraparë në dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian dhe ishte lëndë e vëzhgimit në raportet e shtruara nga qeveria për procesin e integrimi evropiane<sup>109</sup> Raporti për zbatimin e kësaj strategjie të përgatitur në vitin 2009 nga ana e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar sjell përfundim të ngjashëm, d.m.th. se shumica e aktiviteteve të zbatuara janë realizuar kur u sigurua mbështetje e jashtme financiare ose kur ishte e domosdoshme të harmonizohen aktivitetet me standardet evropiane ose ndërkombëtare ose drejtpërdrejtë me Acquis Communautaire.<sup>110</sup>

Nga ana tjetër, kontaktet joformale të autorit me përfaqësuesit e OQ theksuan se Strategjia e përgatitur me mbështetje të fondeve të huaja, procesi i miratimit të saj në përgjithësi ishte shembull pozitiv për vullnetin politik për përmirësimin e bashkëpunimit mes dy sektorëve. Më tej, përfaqësuesit e OQ në kontaktet e mia joformale theksuan se shembull i qartë për vullnetin ekzistues politik në atë kohë ishte fakti se projekti i përjetoi ndryshimet politike pas zgjedhjeve parlamentare në verën e vitit 2006. Duke pasur parasysh politizimi i rritur është një nga shembujt primar të shoqërisë maqedonase në tranzicion, vazhdimi i projektit është përjashtim pozitiv i trendit dominues negativ.

Në përgjithësi, analiza e kontekstit rreth miratimit të Strategjisë flet për disa përfundime të përziera. Nga ana tjetër, hulumtimi i cili i parapriu miratimit të këtij dokumenti flet se ka deri diku rrethinë të pavolitshme për zhvillimin e shoqërisë civile. Karakteristika më e rëndësishme e kontekstit në këtë kuptim është mungesa e qasjes sistemore drejt zhvillimit të marrëdhënieve mes shtetit dhe shoqërisë civile në rastin e Maqedonisë. Hulumtimi tregon se edhe pse ka dëshmi për pengimin e drejtpërdrejt të përpjekjeve për bashkëpunim mes këtyre dy sektorëve, ata mbeten të varur nga personalitetet të cilët janë të kyçur. Nga ana tjetër, procesi i përgatitjes dhe miratimi i Strategjisë është vlerësuar si inkluziv edhe nga ana e hulumtimit dhe të pjesëmarrësve në proces. Edhe pse në pjesë të madhe të mbështetur nga fondet e jashtme, procesi i miratimit të Strategjisë gjithashtu ka pjesë të

108 "Former Yugoslav Republic of Macedonia Needs Assessment Report", raport i përgatitur në kuadër të projektit Ndihmë teknike të shoqërisë civile në venet e IPA Aid/127427/C/SER/Multi/5, gjendet në: <[http://www.tacso.org/doc/04\\_nar\\_mk.pdf](http://www.tacso.org/doc/04_nar_mk.pdf)>, fq. 11 (Është qasur më 17 dhjetor 2010).

109 Raportet gjenden në: <<http://sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControlID=Dokumenti.ascx>> (Është qasur më 10 dhjetor 2010).

110 Raport për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me shoqërinë civile janar 2007 – dhjetor 2008, gjendet në: <<http://mcms.org.mk/images/docs/2008/izvestaj-za-sproveduvanje-na-strategjia-za-sorabotka-na-vladata-so-gragjanskiot-sektor-2008.pdf>> (Është qasur më 19 dhjetor 2010).

madhe pronësi të vendit. Duke e prezantuar kontekstin në të cilin është miratuar Strategjia, analiza vazhdon ta vlerësojë përparimin në zbatimin e saj lidhur me miratimin e legjislativit relevant.

## ZBATIMI I STRATEGJISË – SI ZHVILLOHET??

Lidhur me argumentet paraprake për periudhën afatgjate të procesit të transformimit në kushte të post komunizmit, katër vjet është periudhë relativisht e shkurtër që të vlerësohet ndikimi i Strategjisë për bashkëpunim me sektorin civil. Megjithatë, duke pasur parasysh se Strategjia është përgatitur për periudhën 2007-2011 dhe se afrohet data e fundit formale për zbatimin e dokumentit, e dobishme është të shihet prapa se çfarë është bërë. Në këtë periudhë, vëzhgimin e zbatimit të Strategjisë e realizoi edhe Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe organizatat qytetare. Pasi që qëllimi i kësaj analize është ta hulumtojë literaturën e ndryshme sekondare për zbatimin e Strategjisë dhe ti kontrollojë edhe elementet formale dhe thelbësore të zbatimit, ajo nuk do të drejtohet ndaj të gjitha qëllimeve dhe aktiviteteve të parapara në Strategjinë dhe Planin aksionar. Në vend të kësaj, ajo do të drejtohet nga procesi lidhur me miratimin e akteve legjislative lidhur me Strategjinë, të cilat e përfshijnë Ligjin për vullnetarizëm dhe Ligjin për shoqata dhe fondacione.

**Ligji për vullnetarizëm** u miratua në vitin 2007, ndërsa pas tij u miratuan edhe aktet nënligjore të domosdoshme për zbatimin e tij. Miratimi i akteve nënligjore në periudhat e dhëna që e vendosi kornizën për zbatimin e ligjeve është shumë e rëndësishme, pasi që anulimi i miratimit të akteve nënligjore është rast i shpeshtë në Maqedoni.<sup>111</sup> Informata të hollësishme për aktivitetet e orientuara drejt zbatimit të Ligjit për vullnetarizëm mund gjenden në raportet për zbatimin e Strategjisë të përgatitur nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, që tradicionalisht bashkëpunonte me organizatat qytetare në fusha të ndryshme edhe para miratimit të vetë Strategjisë.<sup>112</sup> Edhe pse është vështirë të vërtetohet se Strategjia në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikonte në procesin e miratimit të ligjit, miratimi i saj llogaritet për shembull të miratimit inkluziv të politikave. Më tej, në tetor të vitit 2010, qeveria miratoi strategjinë për promovimin e vullnetarizmit, që autorit i ishte theksuar në kontaktet joformale si dokument i miratuar përmes procesit të lartë participativ.

Projekti më i rëndësishëm ligjor lidhur me miratimin e Strategjisë është miratimi i **Ligjit të ri për shoqata dhe fondacione**. Ky ligj është thelbësor për funksionimin e OQ dhe

111 Shih raportet me vlerësimet e përgatitura nga SIGMA (Mbështetje e përmirësimit të sundimit dhe udhëheqjes) – iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, në pjesën më të madhe është financuar nga raportet për përparimin e Maqedonisë të BE, që mund të gjendet në: <[http://www.oecd.org/document/37/0,3746,en\\_33638100\\_34612958\\_36492389\\_1\\_1\\_1\\_1,00.html](http://www.oecd.org/document/37/0,3746,en_33638100_34612958_36492389_1_1_1_1,00.html)> (Është qasur më 10 dhjetor 2010).

112 Shih Organizatata qytetare në Republikën e Maqedonisë [Citizen organizations in the Republic of Macedonia].

për zhvillimin e ardhshëm të drejtës së përgjithshme të qytetarëve për shoqërim. Më tej, literatura tregon se kufijtë e ri mes shtetit dhe shoqërisë janë amorfe në kuptimin e asaj që u mungojnë garancitë institucionale, e kështu e thekson rëndësinë e legjislativit kur e rregullon shoqërimin e qytetarëve.<sup>113</sup> Në këtë kuptim, kjo e inkudron edhe legjislativin për themelimin e organizatave qytetare dhe legjislativit për financimin e tyre. Themelimi i organizatave qytetare më parë ishte i rregulluar me Ligjin për shoqata të qytetarëve dhe fondacioneve nga viti 1998, që në përgjithësi llogaritej si ligj liberal, edhe pse kishte disa fusha problematike. Gjatë disa viteve të zbatimit të ligjit, identifikoheshin problemet në zbatimin e tij, pasi që e pengonte shoqërimin e të miturve, themelimin e shoqatave nga ana e shtetasve të huaj dhe nuk jepte bazë për lehtësime tatimore për zhvillimin e sektorit civil.<sup>114</sup> Si rezultat, nga viti 2005, pati debate të vazhdueshme për plotësimin e ligjit ekzistues ose përgatitja e ligjit të ri. Por, atëherë u bënë disa ndryshime minimale të ligjit, ndërsa shumica nga çështjet konkrete dhe problematike u lanë për ligjin e ri.<sup>115</sup>

Ligji i ri për shoqata dhe fondacione u miratua në prill të vitit 2010 dhe ai i rregullon aspektet më të rëndësishme të cilat llogariteshin si të pamjaftueshme në ligjin e mëparshëm nga viti 1998. Mes ndryshimeve të tjera, ligji i ri e zgjeron të drejtën e shoqërimit, u mundëson OQ të merren edhe me aktivitete ekonomike dhe e rregullon procesin e fitimit të statusit të organizatës me interes publik. Vlerësimi i procesit të miratimit të tij, i cili është shumë indikativ për raportin mes institucioneve qeveritare dhe OQ është lëndë e mendimeve kontradiktore. Departamenti për bashkëpunim me organizatat joqeveritare akoma nuk ka përgatitur raport për zbatimin e strategjisë gjatë vitit të kaluar, por në raportet për vitet 2007-2009 mund të gjenden vetëm vlerësime faktike për situatën lidhur me pjesëmarrjen e organizatave qytetare në grupin punues për përgatitjen e këtij ligji. Vlerësimi faktik e vështirëson të vlerësohet niveli i inkudrimin thelbësor të OQ në proces. Vlerësimi i njëjtë gjendet edhe në Raportin për avancimin e zbatimit të përgatitur në vitin 2009 nga ana e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.<sup>116</sup>

Përgatitja e këtij ligji gjithashtu ishte lëndë e vëzhgimit të vazhdueshëm nga ana e faktorëve të ndryshëm të jashtëm, të cilët ndryshe e vlerësonin procesin për miratimin e Ligjit të ri për shoqata dhe fondacione. Nga njëra anë, vlerësimi i TACSO pohon se grupi punues për Ligjin për shoqata dhe fondacione është shembull pozitiv për inkudrimin e shoqërisë civile në procesin e miratimit të politikave.<sup>117</sup> Por, vlerësimi i TACSO është përgatitur para se të miratohet ligji, e kështu nuk i komenton fazat përfundimtare të

113 "Civil Society in Reforming Communist Regimes: The Logic of Emergence," fq. 17

114 Propozim Ligji për plotësimin e Ligjit për shoqata të qytetarëve, janar 2006, gjendet në: <[http://www.soros.org.mk/dokumenti/predlog\\_za\\_izmenuvanje\\_na\\_ZZGF-jan\\_2006.pdf](http://www.soros.org.mk/dokumenti/predlog_za_izmenuvanje_na_ZZGF-jan_2006.pdf)> (Është qasur më 15 dhjetor 2010).

115 Amendamentet e miratuara në mars 2007, dhe kanë të bëjnë vetëm me harmonizimin formal të këtij Ligji për kundërvajtje.

116 "Raport për përparimin e zbatimit të strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil janar 2007 – dhjetor 2008"

117 "Former Yugoslav Republic of Macedonia Needs Assessment Report".

përgatitjes së tij. Nga ana tjetër, Indeksi i fundit i qëndrueshmërisë së OJQ-ve në Maqedoni të USAID për vitin 2009 pohon se qeveria ka shpejtuar me përgatitjen e propozimit, dhe se procesit i mungon transparenca dhe se ka inkuadruar pak OJQ. Ministria e drejtësisë nuk ka organizuar debate publike për propozim ligjin ashtu siç pritej, por u ka lejuar OJQ-ve të japin kontributin e tyre nën kushte rreptësishtë të kontrolluara.<sup>118</sup> Kontaktet joformale me përfaqësuesit e OQ vërtetuan se vetë ministria ka organizuar dy mbledhje me OQ, të cilat nuk kanë shprehur interesim për pjesëmarrje. Por, OQ gjithashtu kanë bërë vërejtje se nuk kanë qenë të informuara dhe të këshilluara për ndryshimet e ligjit të miratuara në minutat e fundit dhe të zbatuara në procesin e koordinimit mes ministrive, dhe në përgjithësi mendon se ka nevojë për debat më të madh publik për këtë ligj të rëndësishëm.

Por, informimi i OQ për ndryshimet e propozimit në minutat e fundit nuk është përjashtim në kontekstin konkret maqedonas. Miratimi i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, si një nga ligjet më të rëndësishme lidhur me procesin e afrimit të vendit drejt BE kishte zhvillim të ngjashëm të ngjarjeve.<sup>119</sup> Trendi i ngjarjeve të tilla i cili përsëritet në mënyrë plotësuese flet për atë se problemet lidhur me këshillimet thelbësore me grupet e interesuara janë inkuadruar në proceset e miratimit të politikave dhe vendimeve në Maqedoni. Që këtu, edhe krahas inkuadrimin fillestar në proces, grupet e interesuara shpesh nuk informohen për përmbajtjen e versioneve përfundimtare të ligjeve. Ky trend u vërejt edhe gjatë vlerësimit të fundit të SIGMA, i cili mendon se këshillimet joadekuate me bashkësitë të cilat rregullohen është arsye e madhe për kualitetin joadekuat të ligjeve.<sup>120</sup>

Vlerësimi i prezantuar i proceseve të cilat kanë të bëjnë me miratimin e aktiviteteve ligjore të Strategjisë nuk japin pasqyrë të qartë që të mund të përgjigjet nëse vetë Strategjia ka kontribuar për bashkëpunim më të mirë. Megjithatë, duke e prezantuar kontekstin në të cilin është miratuar Strategjia dhe vlerësimet e procesit të miratimit të ligjeve më të rëndësishme të cilat ndikojnë në bashkëpunimin e OQ dhe institucioneve shtetërore, nuk mund të gjendet dëshmi për qasjen e përmirësuar sistemore në këtë bashkëpunim. Komisioni Evropian në Raportin e vet për përparimin e vendit nga viti 2010 përfundon se “duhet të përgatitet qasje konzistente për nxitjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse publike në miratimin e vendimeve, duke përfshirë edhe mekanizmat adekuate institucionale”. Shembujt me miratimin e dy ligjeve të analizuara flet se bashkëpunimi akoma varet nga tema, institucionet dhe personalitetet e kyçura. .

118 Indeksi për qëndrueshmërinë e OJQ-ve në Maqedoni për vitin 2009: <[http://www.usaid.gov/locations/europe\\_eurasia/dem\\_gov/ngoindex/2009/macedonia.pdf](http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/2009/macedonia.pdf)>, fq. 149 (Është qsur më 13 dhjetor 2010).

119 Më shumë për këtë ligj në dokumentin: How Macedonia Can Keep Pace with European Standards for Prevention and Protection Against Discrimination, STUDIORUM – Center for Regional policy Research and Cooperation, May 2010, gjendet në: <<http://studiorum.org.mk/en/?p=688>> (Është qasur më 16 dhjetor 2010).

120 “The former Yugoslav Republic of Macedonia 2010 Assessment”, raport i përgatitur nga “Mbështetje për avancimin e sundimit dhe udhëheqjes (SIGMA) iniciativë e përbashkët e OECD dhe të Bashkimit Evropian, në pjesën më të madhe e financuar nga BE, gjendet në: <<http://www.oecd.org/dataoecd/28/40/46401959.pdf>>, fq. 2 (Është qasur më 14 dhjetor 2010).

# PËRFUNDIM

---

Ky studim i rastit hulumton se si funksionon Strategjia për bashkëpunim me sektorin civil të miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në praktikë në katër vitet e fundit nga miratimi i saj. Studimi i rastit i qaset zhvillimit të shoqërisë civile si elementit thelbësor në procesin e demokratizimit të kushteve në post komunizëm. Më tej, studimi i rastit vërteton se nuk mund të ketë zhvillim të shoqërisë civile pa vendosjen e mekanizmave efikas për bashkëpunim me shtetin. Studimi përdor edhe literaturë primare dhe sekondare, që përfshin tekste teorike për shoqërinë civile dhe raporte kontestuale për zbatimin e Strategjisë si nga burime nacionale ashtu edhe nga burime ndërkombëtare.

Studimi i rastit përmban katër pjesë kryesore. Pjesa e parë jep definicion për shoqërinë civile në kontekstin maqedonas për shkak të karakteristikave konkrete të zhvillimit të shoqërisë civile. Studimi i rastit e pranoi definicionin nga raporti i CIVIKUS për Maqedoninë për vitin 2005, i cili shoqërinë civile e nënkupton lidhur me vlerat pozitive të tija dhe i përjashton partitë politike si element specifik të shoqërimit të qytetarëve. Pjesa e dytë jep pasqyrë të asaj pseraportet mes shtetit dhe shoqërisë civile janë të rëndësishme, veçanërisht në kushte të transformimit post komunist, e kështu njëkohësisht kërkohet demokratizimi i të dy sektorëve dhe bashkëpunimi i tyre efikas. Pjesa e tretë, më së shumti empirike, jep pasqyrë të përgjithshme të kontekstit maqedonas para viti 2007 dhe të kushteve konkrete në të cilat është miratuar Strategjia. Analiza kontekstuale flet për pasqyrën jo të qartë të bashkëpunimit mes shtetit dhe shoqërisë civile në periudhën para vitit 2007, duke e theksuar nevojën për vendosjen e mekanizmave sistimore për bashkëpunim. Pjesa e fundit jep hulumtim për përparimin nga zbatimi i Strategjisë lidhur me aktivitetet legjislative të bazuara në literaturën sekondare të hulumtimeve të vendit dhe ndërkombëtar. Analiza flet për raportet e ndryshme për zbatimin dhe pikëpamje të ndryshme të aktorëve të vendit dhe të jashtëm për këtë çështje. Vlerësimi flet se bashkëpunimi akoma varet nga çështja, institucionet dhe personalitete e inkuadruar në atë.

Por, siç përmendet në disa vende në analizë, është e rëndësishme të shënohet se zbatimi i kësaj Strategjie nuk mund të shihet në izolim nga zhvillimi i përgjithshëm i demokracisë në vend. Prej këtui, raportet e përziera për zbatimin e saj korrespondojnë me rezultatet e Pasqyrës së sundimit në Maqedoni të SIGMA për vitin 2010, që përfundon se “ka

respektim të pamjaftueshëm të institucioneve demokratike. Do të nevojiten edhe shumë vite për akomodim kulturor dhe shoqëror, si edhe përpjekje reformuese, që të zhvillohet ky respektim dhe të ndërtohet besimi, për shembull, në të kuptuarit se inkuadrimi i ministrive tjera, shoqërisë civile dhe në fund të “ligjdhënësit”, d.m.th. Kuvendit, në procesin legjislativ është më shumë se formalitet”.<sup>121</sup> Në përgjithësi, analiza e thekson nevojën për punë të mëtejshme dhe vëzhgim të vazhdueshëm të këtyre çështjeve për vendosjen e mënyrës institucionale dhe sistemore të bashkëpunimit mes OQ dhe shtetit në rastin e Maqedonisë.

## *Burimet dhe raportet primare:*

**“15 years of transition – a country moving towards citizen participation”** CIVICUS Civil Society Index, Macedonian Center for International Cooperation, Skopje 2005. Available at: [www.mcms.org.mk](http://www.mcms.org.mk).

**Progress Report on the Implementation of the Strategy for Cooperation of the Government with the Civil Sector January 2007 – December 2008**, Macedonian Centre for International Cooperation, available at: <http://mcms.org.mk/images/docs/2008/izvestaj-za-sproveduvanje-na-strategijata-za-sorabotka-na-vladata-so-gragjanskiot-sektor-2008.pdf>.

**CIVICUS Civil Society Index, Summary of conceptual framework and research methodology** [http://www.civicus.org/new/media/CSI\\_Methodology\\_and\\_conceptual\\_framework.pdf](http://www.civicus.org/new/media/CSI_Methodology_and_conceptual_framework.pdf).

**USAID NGO Sustainability Index** available at: [http://www.usaid.gov/locations/europe\\_eurasia/dem\\_gov/ngoindex/](http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/).

**Freedom House Nations in Transit Reports** available at: <http://www.freedomhouse.org/template.cfm?page=17>.

**2009 NGO Sustainability Index Macedonia**, available at: [http://www.usaid.gov/locations/europe\\_eurasia/dem\\_gov/ngoindex/2009/macedonia.pdf](http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/2009/macedonia.pdf).

**Analytical report for the Opinion on the application from the former Yugoslav Republic of Macedonia for EU membership.** Commission Staff Working Paper, November 2005. Brussels: Commission of the European Communities, available at: [http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key\\_documents/2005/package/sec\\_1425\\_final\\_analytical\\_report\\_mk\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1425_final_analytical_report_mk_en.pdf).

**The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2006 Progress Report** Commission Staff Working Paper. Brussels: Commission of the European Communities, available at: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2006/nov/fyrom\\_sec\\_1387\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2006/nov/fyrom_sec_1387_en.pdf).

**“Former Yugoslav Republic of Macedonia Needs Assessment Report”**, Report prepared in the framework of the project Technical Assistance to Civil Society Organisations in the IPA Countries EuropeAid/127427/C/SER/Multi/5, available at: [http://www.tacso.org/doc/04\\_nar\\_mk.pdf](http://www.tacso.org/doc/04_nar_mk.pdf).

**National Reports on the progress in the European accession** process available at: <http://sep.gov.mk/Default.aspx?ContentID=36&ControlID=Dokumenti.ascx>.

Assessment reports prepared by SIGMA (**Support for Improvement in Governance and Management**) - A joint initiative of the OECD and the European Union, principally financed by the EU Assessment Reports on Macedonia, available at: [http://www.oecd.org/document/37/0,3746,en\\_33638100\\_34612958\\_36492389\\_1\\_1\\_1\\_1,00.html](http://www.oecd.org/document/37/0,3746,en_33638100_34612958_36492389_1_1_1_1,00.html).

**“The former Yugoslav Republic of Macedonia 2010 Assessment”**, Report prepared by the “Support for Improvement in Governance and Management (SIGMA) A joint initiative of the OECD

and the European Union, principally financed by the EU, available at: <http://www.oecd.org/dataoecd/28/40/46401959.pdf>.

**Draft Law amending the Law on associations of citizens**, January 2006, available at: [http://www.soros.org.mk/dokumenti/predlog\\_za\\_izmenuvanje\\_na\\_ZZGF-jan\\_2006.pdf](http://www.soros.org.mk/dokumenti/predlog_za_izmenuvanje_na_ZZGF-jan_2006.pdf).

Policy Brief: **How Macedonia Can Keep Pace with European Standards for Prevention and Protection Against Discrimination**, STUDIORUM – Center for Regional policy Research and Cooperation, May 2010, available at: <http://studiorum.org.mk/en/?p=688>.

**Literatura sekundare:**

Dahlgren, Peter (1995) **Television and the Public Sphere. Citizenship, Democracy and the Media**. London: Sage, 1995.

Diamond, Larry (2003) **“Towards Democratic Consolidation”**, *Journal of Democracy*, Vol.5, No.3, July 1994.

Di Palma, Giuseppe (1991). **“Legitimation from the Top to Civil Society: Politico-Cultural Change in Eastern Europe”**, *World Politics*, Vol.44, No1, 49-80.

Dryzek, John. (1996) **‘Political Institutions and the Dynamics of Democratization’**, *American Political Science Review*, Vol.90, No.1, pp.475–87.

Ivanov, Gjorgje. Taleski, Dane (2003). **“Civil Society in South East Europe: The case of Macedonia.”** Skopje: The Institute for Democracy, Solidarity, and Civil Society.

Jakubowicz, Karol (1996). **“Civil Society and Public sphere in Central and Eastern Europe – A Polish Case Study”**, *Nordicom Review* 2/1996, Available at: [http://www.nordicom.gu.se/common/publ\\_pdf/27\\_JAKUBO.pdf](http://www.nordicom.gu.se/common/publ_pdf/27_JAKUBO.pdf).

Janos, Andrew (2000). **East Central Europe in the Modern World**, Stanford University Press.

Kacarska, Simonida; Atanasova, Gorica (2009) **“The Role of External actors in Civil Society Building: the Case of the Republic of Macedonia”**, *CEU Political Science Journal* No.1 Available at: [http://www.ceu.hu/sites/default/files/field\\_attachment/page/node-5733/ceupolscijournaliv1.pdf](http://www.ceu.hu/sites/default/files/field_attachment/page/node-5733/ceupolscijournaliv1.pdf).

Kacarska, Simonida (2008), **Graganskite organizacii vo Republika Makedonija** [Citizen organizations in the Republic of Macedonia], Skopje: Makedonski centar za megunarodna sorabotka.

Kopecký, Petr and Mudde Cas (2003) **‘Rethinking civil society’**, *Democratization*, 10:3, 1 – 14.

Linz, Juan J and Stepan, Alfred (1996) **Problems of Democratic Transition and Consolidation**, Johns Hopkins University Press.

Morje Howard, Marc (2003). **The Weakness of Civil Society in Post/Communist Europe**, Cambridge: Cambridge University Press.

Weigle, Marcia and Butterfield, Jim (1992) **“Civil Society in Reforming Communist Regimes: The Logic of Emergence,”** *Comparative Politics*, Vol.25, No1.

# — KUFIZIMET E LIRISË SË SHOQËRIMIT DHE VEPRIMIT —

## REZYME

Liria e tubimit dhe liria e shoqërimit janë parakushte për ekzistimin e shoqërisë moderne demokratike. Ata janë baza për komunikim mes individëve me interesa të ngjashëm apo qëndrime politike dhe paraqesin një lloj të veçantë të lirisë së shprehjes. Prandaj kanë dimension të rëndësishëm politik. Duke i përdorur këto liri njerëzit mundën të luftojnë për plotësimin e qëllimeve të përbashkëta në shoqërinë ku jetojnë.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e dokumenteve ndërkombëtare të cilët janë drejtpërdrejtë të zbatueshëm në vend, në këtë tekst shqyrtohen këto norma, si edhe praktika që ka të bëjë me lirinë e tubimit dhe shoqërimit. Liria e tubimit garantohej me më shumë dokumente ndërkombëtare. Deklarata universale për të drejtat e njeriut, dokument i Kombeve të Bashkuara (më tutje në tekst UDP), në nenin 20<sup>122</sup> dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tutje në tekst KEDNJ), dokument i Këshillit të Evropës, neni 11<sup>123</sup> e garantojnë lirinë e tubimit në një nen, nga ana tjetër Pakti për Liri dhe të Drejta Qytetare dhe Politike (PQP), dokument i KB-s i garanton në nene të veçanta, gjegjësisht në nenin 21 dhe 22<sup>124</sup>. Veç dokumenteve ndërkombëtare dhe praktikës, në tekst flitet edhe për raportet e organizatave joqeveritare ndërkombëtare me renome të cilat japin pasqyrë për gjendjen me të drejtat e njerëzve në më shumë shtete.

122 UDP n.20: Secili ka të drejtë të në tubime të qeta dhe shoqërim. Askush nuk mundet të detyrohet të anëtarësohet në ndonjë shoqatë

123 . KEDNJ n.11 p.1: Çdo njeri ka të drejtë në tubim të qetë dhe shoqërim me tjerët, duke përfshirë edhe të drejtën të themelon sindikate dhe tu shoqërohet sindikatave për mbrojtjen e interesave të vetë; n.11 p2: Realizimi i këtyre të drejtave mundet të kufizohet vetëm me masa ligjore gjë e cila në një shoqëri demokratike janë të domosdoshme për sigurinë nacionale, publike, mbrojtjen e rendit, mbrojtjen e shëndetit, moralit apo mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve. Me këtë nen nuk ndalohet futja e kufizimeve ligjore për anëtarët e forcave të armatosura, policisë apo administratës shtetërore.

124 PQP n.21: Pranohet e drejta e tubimit të qetë. Realizimi i kësaj të drejte mundet të jetë objekt i kufizimeve në pajtim me ligjin, kufizime të cilat janë të nevojshme në një shoqëri civile në interes të sigurisë nacionale, rendit publik, mbrojtja e shëndetit publik apo moralit ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve; PQP n.22, p.1: Çdo person ka të drejtë lirisht të shoqërohet me persona tjerë duke i përfshirë edhe të drejtën e themelimit të sindikatave dhe anëtarësimeve në to me qëllim të mbrojtjes së interesave të veta; n.21, p2: Realizimi i kësaj të drejte mundet të jetë objekt i kufizimeve të parapara me ligj, të cilat në një shoqëri demokratike janë të nevojshme për interesat nacionale, rendin publik apo mbrojtjen e shëndetit publik dhe të moralit apo të drejtat e të tjerëve. Ky nen nuk ndalon realizimin e kësaj të drejte nga ana e forcave të armatosura të policisë.



Teksti jep pasqyrë edhe të legjislacionit nacional sa i përket lirisë së tubimit dhe shoqërimit. Bëhet fjalë për normat në Kushtetutë dhe më shumë ligje që kanë të bëjnë me lirinë e shoqërimit. Nga teksti mundet të shihet në çarë forma të kufizimeve hasin shoqatat gjatë formimit dhe gjatë veprimit. Njëkohësisht ceket edhe praktika modeste gjyqësore në vend.

Në fund konkluzioni është se liria e shoqërimit nuk është e drejtë absolute dhe e njëjta ka kufizime të caktuara sipas normave ndërkombëtare (të shkruara në legjislacionin nacional). Domethënë kufizime mund të ketë nëse një gjë e tillë është e nevojshme në një shoqëri demokratike, për shembull në interes të sigurisë nacionale, për ndalimin e trazirave apo veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Gjatë shkrimit të tekstit (në periudhën 15.11-15.12.2010) kryesisht janë përdorur të dhëna sekondare: analiza të dokumenteve ndërkombëtare, raste, raporte të organizatave ndërkombëtare joqeveritare. Plotësisht në pjesën për Maqedoninë janë bërë edhe intervista me qëllim që të tregohen disa raste me të cilët ballafaqohen shoqatat gjatë formimit dhe gjatë veprimit.

## HYRJE

Liria e shoqërimit është një nga të drejtat e njeriut me realizimin e së cilës vlerësohet shkalla e zhvillimit demokratik në një shtet. Bëhet fjalë për të drejtë e cila jep bazë që individë me interesa të ngjashëm të shoqërohen dhe të veprojnë së bashku. Duke i shfrytëzuar lirinë e shoqërimit dhe lirinë e tubimit njerëzit mund të luftojnë për plotësimin e qëllimeve të përbashkëta në shoqërinë në të cilën jetojnë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e dokumenteve ndërkombëtare të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të aplikohen në vend, në rrëfimin ka vështrim të këtyre normave, si edhe të praktikës që kanë të bëjnë me lirinë e tubimit dhe shoqërimit. Liria e shoqërimit dhe të tubimit është garantuar në më shumë dokumente ndërkombëtare. Deklarata universale për të drejtat e njeriut, dokument i Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejshëm UDP), në nenin 20125 dhe Konventën evropiane për të drejtat e njeriut (në tekstin e mëtejshëm KEDNJ), dokumenti i Këshillit të Evropës, në nenin 11126 garantojnë për lirinë e tubimit dhe shoqërimit në një nen, nga ana tjetër Pakti për liri dhe të drejta qytetare dhe politike (në tekstin e mëtejshëm PDQ), dokument i KB, garanton në nene të veçanta, gjegjësisht në

125 UDP neni 20: Secili ka të drejtë për tubime dhe shoqërime të qeta. Askujt nuk mund të imponohet të bëhet anëtar në ndonjë shoqatë.

126 KEDNJ neni 11 alineja. 1: Çdo njeri ka të drejtë për tubim të qetë dhe shoqërim me të tjerë, duke përfshirë të drejtën të themel, oje sindikata dhe tu shoqërohet sindikatave për mbrojtjen e interesave të tija; neni 11 alineja 2.: Realizimi i këtyre të drejtave mund të kufizohet vetëm me masa ligjore që në një shoqëri janë të domosdoshme për sigurinë nacionale, publike, mbrojtjen e rendit, mbrojtjen e shëndetit, moralin ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve. Me këtë nen nuk ndalohet imponimi i kufizime ligjore për pjesëtarët e forcave të sigurimit, policisë ose administratës shtetërore.

nenet 21 dhe 22127. Përveç dokumenteve dhe praktikave ndërkombëtare, në rrëfim flitet edhe për raportet e organizatave të njohura joqeveritare ndërkombëtare, që japin fotografi për gjendjen me të drejtat e njeriut në më shumë shtete.

Rrëfimi jep pasqyrë edhe për legjislacionin nacional që ka të bëjë me lirinë e shoqërimit. Bëhet fjalë për Kushtetutën dhe për më tepër ligje që kanë të bëjnë me lirinë e shoqërimit. Nga rrëfimi mund të shihet edhe me çfarë normash të kufizimit hasin shoqatat gjatë formimit, si dhe gjatë veprimit. Në të njëjtën kohë është cekur edhe praktika modeste gjyqësore në vend.

Në fund përfundim është se liria e shoqërimit nuk është e drejtë abosulte dhe e njëjta ka kufizime të caktuara sipas normave ndërkombëtare (të inkorporuara në legjislacionin nacional). Do të thotë kufizimet mund të jenë nëse kjo është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, si për shembull në interes të sigurisë nacionale, për pengimin e trazirave dhe veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Gjatë përpunimit të rrëfimit kryesisht janë përdorur të dhëna sekondare: analiza e dokumenteve ndërkombëtare, rastet, raportet e organizatave joqeveritare ndërkombëtare. Në mënyrë plotësuese për Maqedoninë janë bërë edhe intervista me qëllim të prezantimit plastik të disa rasteve me të cilat ballafaqohen shoqatat si gjatë formimit të tyre, ashtu edhe gjatë veprimit.

## NORMAT DHE PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE

### » **Liria e tubimit të qetë**

Asnjë dokument ndërkombëtarë nuk jep definicion të termit tubim. Edhe pse asnjë dokument ndërkombëtar nuk përmban definicion preciz të terminin nga thelbi i kësaj të drejte të njeriut mundet të përfundohet se tubimi është një mbledhje e vetëdijshme, me dëshirë dhe e përkohshme e më shumë personave për realizimin e një qëllimi të caktuar.

Njerëzit çdo ditë mblidhen në takime argëtuese, stacione, koncerte dhe manifestime të tjera, por këto raste nuk bëjnë pjesë në tubim të lirshëm, por i përkasin sferës private të individëve. Prandaj për të pas mbrojtje të veçantë nga shteti kjo duhet të del nga sfera e pastër private dhe të drejtohet drejt sferës publike<sup>128</sup>.

127 PGP neni 21: Pranohet e drejta për tubim të qetë. Kryerja e të drejtës mund të jetë lëndë e kufizimeve, të dedikuara në pajtim me ligjin, dhe të cilat janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë nacionale, rendit publik, mbrojtje së shëndetit publik ose moralin ose të drejtat dhe liritë e tjerëve; PGP neni 22 alineja 1: Çdo person ka të drejtë që të shoqërohet lirë me persona të tjerë, duke përfshirë edhe të drejtën e themelimit të sindikatave dhe anëtarësimi në ato për shkak të mbrojtjes së interesave të veta; neni 21 alineja 2.: Kryerja e kësaj të drejte mund të jetë lëndë e kufizimeve të parapara me ligj, që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë nacionale, rendit publik ose mbrojtja e shëndetit publik dhe të moralit ose të drejtat e tjerëve. Ky nen nuk e pengon kryerjen e kësaj të drejte nga ana e anëtarëve të forcave të armatosura të policisë që të jenë të ekspozuar në kufizimet ligjore.

128 Nowak, M., Commentary on the UN Covenant on Civil and Political Rights, NP Engel Publisher,

Tubimi mundet të bëhet në lloje të ndryshme të hapësirave publike, pronë private, në lëvizje dhe ngjashëm. Mënyra e tubimit do të ndikon në masat të cilat shteti i ndërmerr për ta mbrojtur dhe nëse ka nevojë edhe ta kufizon<sup>129</sup>.

Shtetet në mënyra të ndryshme e rregullojnë të drejtën e tubimit të qetë, për shembull duke kërkuar paraqitje paraprake apo marrjen e lejes. Për shembull KEDNJ ka qëndrim se dhënia e lejes për tubimet parimisht nuk është në kundërshtim me nenin 11, alinenë 1, sepse shteti duhet të siguron tubim të qetë<sup>130</sup>.

Shtojca “qetë” e kufizon lirinë e tubimit. Shtetet janë të obliguar ti mbrojnë vetëm tubimet e qeta. Nëse organet kompetente kanë shkaqe të arsyeshme dhe të forta të besojnë se tubimi i planifikuar nuk do të jetë i qetë apo gjatë tubimit ai del nga kontrolli, mundet ta ndërpresin apo ta ndalojnë. Zakonisht kuptimi i termit “qetë” është mungesa e çdo lloji të dhunës. Për tu ikur keqpërdorimeve, interpretimi i fjalës “qetë” duhet të jetë i gjerë. Për shembull, nëse mes pjesëmarrësve ka vetëm disa individë ekstremistë dhe të dhunshëm, shteti nuk duhet ta ndërpret komplet tubimin por vetëm ato individë ti izolon. Gjithashtu, tubimi nuk ndërpritet të jetë i qetë nëse policia përdorë dhunë<sup>131</sup>.

Shteti kur bëhet fjalë për tubimin e qetë ka obligime negative (të përmbahet nga pengimi i tubimit të qetë) dhe pozitive (të siguron mirëmbajtjen e tyre). Obligimi pozitiv në fakt mundëson pjesëmarrësit në tubim mendimin e vetë ta shprehin pa frikë të dhunës fizike nga persona tjerë. Gjyqi Evropian për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës në gjykimin Platforma “Mjekë pa kufi” thekson se obligimi pozitiv ekziston me qëllim që “frika e tillë mos ti pengojë shoqatat apo grupet tjera të cilat kanë qëllime dhe interesa të përbashkëta nga shprehja e qëndrimeve të veta për çështje kontroverze në shoqëri”<sup>132</sup>. Në tubime të Shoqatës e cila lufton kundër abortit kundërshtojnë ata të cilët janë për ndërprerje vullnetare të shtatzënisë. Gjatë një tubimi, shoqata vendos ta ndryshon rrugën e marshimit. Policia e paralajmëron shoqatën se nuk mundet ta siguron tubimin. Në fund vjen deri te pengesat e supozuara. Përkrahësit e abortit e kanë pamundësuar mbajtjen e fjalimeve të shoqatës Mjekë për jetë, duke folur paralelisht në megafon, duke hedhur me mjete të ndryshme dhe ngjashëm. Po thuaj se erdhi edhe deri te konflikt fizik, por njësitë speciale për kontroll të tubimit kanë bërë kordon mes dy grupeve. Gjyqi Evropian përfundon se shteti austriak kanë dërguar qindra policë për ta hequr rrezikun nga ballafaqimi i drejtpërdrejtë dhe se Austria i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për ta mundësuar lirinë e tubimit të shoqatës Mjekë për jetë dhe se pushteti nuk e ka thyer nenin 11 të KEDNJ-s.

Prandaj shtetet duhet ti ndërmarrin të gjitha masat e arsyeshme dhe adekuate për të

1993

129 Liria e tubimit në pronë private mundet të kufizohet me të drejtën e menaxhimit të lirë me pronën e personave tjerë

130 Dimitrijević, V., Međunarodno pravo ljudskih prava, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 2007

131 Platform Ärzte für das Leben v. Austria, App.No.10126/82(1988)

132 Dimitrijević, V., Međunarodno pravo ljudskih prava, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 2007

mundësuar që protesta të shkon qetë dhe pa pengesa. Nëse ka nevojë shteti duhet të siguron mbrojtje policore dhe në raste ekstreme mundet edhe ti pengon kundër-demonstrantët <sup>133</sup>.

### » **Liria e shoqërimit**

E drejta për shoqërim të lirë gjithashtu paraqet një nga bazat e demokracisë moderne. Kjo e drejtë politike u mundëson njerëzve të bashkuar të luftojnë për idetë dhe interesat e tyre nëpërmjet partisë politike, shoqërimit profesional, organizime fetare, sindikale, joqeveritare apo lloj tjetër i organizimit. PGP (neni 22), Konventa Evropiane (neni 11) të gjithë njerëzve ua garanton të drejtën e shoqërimit të lirë. Dokumentet ndërkombëtare kryesisht nuk i përcaktojnë shkaqet e shoqërimit të njerëzve <sup>134</sup>. Themelimi i shoqatave dhe anëtarësimi në to duhet të jenë të lirë. Domethënë askush nuk mundet të detyrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, nga shteti, persona privatë të anëtarësohen në ndonjë shoqatë. Kjo nënkupton lirinë e zgjedhjes të organizatës në të cilën dikush dëshiron të anëtarësohet.

UDP parasheh se “askush nuk mund të detyrohet të anëtarësohet në ndonjë shoqatë”. Kjo ka rëndësi në kohën e regjimeve komuniste kur njerëzit kanë qenë të detyruar të anëtarësohen në partinë komuniste. Shembull interesant është Zairi (Kongo i sotshëm) ku me Kushtetutën e atëhershme parashihej që çdo qytetarë sapo lind të bëhet anëtarë i Lëvizjes popullore revolucionare të partisë së atëhershme në pushtet dhe të vetme.

Ashtu si për të gjithë të drejtat, edhe për këtë shteti ka obligime negative (të përmbahet nga ndalimi i themelimit të shoqatave) dhe obligime pozitive (të siguron kornizë ligjore për themelimin e shoqatës). Prandaj kërkesa për regjistrimin e shoqatës i mundëson shtetit ta mbron të drejtën e shoqërimit. Por, nëse regjistrimi pengohet atëherë ka hapësirë për mosrespektimin e kësaj të drejte. Kjo në veçanti ndodh në regjime totalitare në të cilët ekziston qëllimi që të pengohet puna e për shembull organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pengohet regjistrimi formal i tyre. Komiteti për të drejtat e njeriut pranë KB-s disa herë ka shprehë brengosje në raportet për Bjelorusinë<sup>135</sup>.

**E drejta e shoqërimit sindikal.** Edhe pse e drejta e shoqërimit sindikal kryesisht shihet si e drejtë ekonomike, atë e parashikojnë dhe e mbrojnë edhe PQP-ja edhe KEDNJ-ja (neni 22 alineja 1 dhe neni 11 alineja 1) si e drejtë qytetare. Dokumentet ndërkombëtare të cilët i mbrojnë të drejtat sociale dhe ekonomike siç janë Pakti për të Drejta Ekonomike dhe Sociale dhe Karta Evropiane Sociale, të cilët janë dokumente të KB-s, si edhe shoqërimi sindikal duke e theksuar rolin e tij në përmirësimin dhe mbrojtjen e interesave ekonomike. Rëndësi të veçantë ka aspekti negativ i lirisë të shoqërimit sindikal. Parashtrohet pyetja se a paraqet thyerje të kësaj së drejte anëtarësia e detyrueshme në ndonjë sindikatë. Përvoja e vonshme e Gjyqit Evropian qartë e thekson këtë aspekt negativ të lirisë së shoqërimit në

133 Këtë e bën vetëm Konventa Amerikane duke cekur qëllime ideologjike, religjioze, politike, ekonomike, punuese, sociale, kulturore, sportive dhe qëllime të tjera

134 M.A. v. Italy, Comm. No. 117/81(1984)

135 Nowak, M., CCPR Commentary, стр.508-510

sindikate. Në rastin e Serensen dhe Rasmusen V Danimarkës parashtruesit e ankesës për tu punësuar është dashur të nënshkruajnë kontratë me të cilën detyrohen se do të kyçen në sindikatë. Nga rrogat u është refuzuar shuma për anëtarësim edhe pse ato nuk janë anëtarësuar në sindikatë. Kur ata kanë kundërshtuar të anëtarësohen në sindikatë i kanë larguar nga puna. Gjyqi ka sjellë vendim se “neni 11 duhet patjetër të shihet edhe si normë juridike e cila përmban të drejtë negative për shoqërim apo thënë ndryshe – e drejta për mos tu detyruar që personi të anëtarësohet në shoqatë...”

Prandaj, liria e shoqërimit sindikal duhet patjetër të shqyrtohet nëpërmjet lirisë së shoqërimit në përgjithësi, e cila nënkupton edhe të drejtën w mos anëtarësimi në asnjë shoqatë. Liria e shoqërimit dhe e drejta e shoqërimit sindikal mundet të kufizohet me ligj në interes të sigurisë nacionale apo publike, mbrojtjen e shëndetit publik, moralit, rendit publik dhe të drejtat e tjerëve. Sigurisht se kufizimi duhet të jetë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe proporcionalisht me mbrojtjen e interesave, siç edhe parashikojnë dokumentet ndërkombëtare. Ndaleza për themelimin e shoqatës duhet të jetë masa e fundit, nëse masat më të buta nuk i kanë mbrojtur interesat e lartpërmendur. Për shembull, greva mundet të ndalohet nëse paraqet kanosje për sigurinë e përgjithshme, gjegjësisht nëse një gjë e tillë nevojitet në një shoqëri demokratike proporcionalisht me rrezikun i cili del nga greva. Nëse ndonjë shoqatë promovon urrejtje nacionale, fetare puna e saj mundet të ndalohet. Njësoj si te tubimi i qetë. Nëse ndonjë shoqatë merret me aktivitete në kundërshtim me parimin e demokracisë gjithashtu mundet të ndalohet. Komiteti për të Drejtat e Njeriut pranë KB-s ndalimin e partisë fashiste e parashihte në pajtim me nenin 22 të Paktit për të Drejtat Qytetare dhe Politike<sup>136</sup>.

Nga dispozitat e përgjithshme për kufizimin e lirisë së shoqërimit përjashtohen anëtarët e forcave të armatosura dhe policisë (neni 22, aline 2 PQP), ndërsa KEDNJ njëlloj vepron edhe me nëpunësit në administratën shtetërore (neni 11, alineja 2). Kufizimi i lirisë së shoqërimit për anëtarët e ushtrisë dhe policisë (dhe administratës shtetërore) duhet të jenë në përputhje me ligjin, kurse nuk duhet ti plotësojnë kërkesat për domosdoshmëri dhe proporcionalitet në një shoqëri demokratike <sup>137</sup>.

Nga ajo që u cekë më lartë mund të shihet se kur bëhet fjalë për shoqërim më së shpeshti rastet të para institucioneve ndërkombëtare për shkak të kufizimit i përkasin partive politike dhe shoqërimeve në sindikate.

## » **Liria e shoqërimit në raportet e organizatave joqeveritare ndërkombëtare**

Duke vlerësuar se a respektohet liria e shoqërimit organizatat ndërkombëtare joqeveritare këtë e bëjnë në bazë të dokumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (të shqyrtuara më lartë në tekst). Domethënë vlerësojnë se a është thyer e drejta në bazë të normave të përmbajtura në PQP, UDP, EKDNJ, si edhe në legjislacionin nacional i cili duhet të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Human Rights Watch në këtë kontekst ka përgatitur studime të veçanta për vendet problematike. Maroko, shtet në Afrikën Veriperëndimore, de jure monarki kushtetuese, e cila pavarësinë nga Franca dhe Spanja e fitoi në vitin 1956 është shtet i cili pothuaj në të gjithë raportet theksohet si vend ku nuk respektohen të drejtat e njeriut. Mes tyre edhe e drejta e shoqërimit. Në vitin 2009 është përgatitur edhe raport i veçantë për Marokun i titulluar si “Liria e formimit të shoqatave – Regjim deklarativ”. Si në këtë raport, ashtu edhe në raporte tjera të kësaj por edhe të organizatave tjera ndërkombëtare, liria e shoqërimit vlerësohet në bazë të asaj se a janë në pajtim me normat ndërkombëtare ligjet nacionale kur bëhet fjalë për formimin e shoqatave dhe veprimi i tyre. Domethënë në raport thirret Maroku që ti përputh ligjet me normat ndërkombëtare, duke e përfshirë edhe PQP-n, më saktë nenin 22, sepse ky shtet e ratifikoi këtë dokument më 3 maj 1979.

Ja një shembull për kufizimin e lirisë së shoqërimit në Maroku. Grupi për luftë kundër racizmit dhe mbrojtjes së të drejtave të huajve dhe emigrantëve nuk u regjistrua me sqarim se organet kompetente nuk pajtohen me emrin e shoqatës. Megjithatë edhe pos faktit që organizata nuk u regjistrua ajo hapi llogari bankare dhe u vendos në shoqëri si organizatë kryesore e cila kritikon çdo hap të pushtetit kur ai nuk i respekton të drejtat e njeriut <sup>138</sup>.

Në raportin e së njëjtës organizatë të përgatitur në vitin 2000 me titull “Shuarje të Partisë Demokratike Kineze” ftohet Kina që ti përputh ligjet me normat ndërkombëtare. Firmosja e Paktit për të Drejtat Qytetare dhe Politike nga ana e Kinës u tregua vetëm si obligim në letër. Këtë dokument ndërkombëtarë Kina e miratoi në vitin 1997 para vizitës së paralajmëruar të kryetarit amerikan Bill Clinton. Aktivistët e partisë burgoseshin, regjistrimi nuk lejohej. Baza kryesore për mosrespektimin e së drejtës për shoqërim ishte në Ligjin penal nga viti 1997, neni 105 sipas të cilit dënohen të gjithë të kyçurit në organizimin dhe veprimin me qëllim të shkatërrimit të fuqisë politike të shtetit dhe sistemit social. Por partia e cila nuk mundej të regjistrohet kishte vetë 200 aktivistë. Megjithatë organizata tjera të këtij lloji funksionin, mes tyre ishin Partia Demokratike Rinore, Partia Liberale Demokratike e Kinës, Aleanca Progresive Kineze. Por veprimi i tyre ishte i lejuar sepse ata në asnjë moment nuk u orvatën ta legalizojnë statusin e tyre. Në deklaratën e Partisë Demokratike Kineze nuk ka asgjë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Ajo punon për drejtësi, demokraci, respektimin e normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nënshkrues i të cilëve

<sup>138</sup> Sideropoulos and others v. Greece, Reports of decisions and Judgements 1998 - VI

është edhe Kina. Sidoqoftë shoqëria civile në Kinë shënon rritje dhe nga viti 1979 deri sot ekzistojnë rreth 200 000 grupe shoqërore <sup>139</sup>.

Edhe në raportet e Amnesty International theksohen mosrespektimet e lirisë së shoqërimit. Në raportin e fundit i cili e shqyrton gjendjen e të drejtave të njeriut në 158 shtete, liria e shoqërimit ceket vetëm në 17 shtete. Më saktë gjendja në këtë fushë shqyrtohet në këto shtete sepse gjatë shqyrtimit të situatës me të drejtat e njeriut vetëm në këto 17 shtete është konstatuar kufizim i lirisë së shoqërimit dhe tubimit të qetë. Në raportin për vitin 2010 shtetet në të cilët është konstatuar kufizim i kësaj së drejte të njeriut kryesisht janë afrikane, aziatike, nga Evropa Lindore dhe vetëm një shtet anëtarë i BE-s. Shtetet ku është konstatuar mosrespektim i kësaj të drejte janë Bjelorusia, Benini, Burundi, Kameruni, Kongo, Kuba, Egjipti, Estonia, Gjeorgjia, Irani, Jordani, Moldavia, Nikaragua, Ruanda, Suazilendi, Tunizia, Zimbabve. Edhe kjo organizatë ndërkombëtare joqeveritare thërret në respektimin e normave ndërkombëtare, gjegjësisht kriteret e vetme sipas të cilëve vlerësohet se a ka mosrespektim të lirisë së shoqërimit janë dokumentet ndërkombëtare.

Prandaj mundet të konstatohet se liria e shoqërimit, gjegjësisht kufizimi i saj rrallë herë trajtohet në këto raporte në përgjithësi, e në veçanti kur bëhet fjalë për shtetet evropiane. Kohë pas kohe e përkujtojnë Greqinë. Kundër saj ka proces para Gjyqit Evropian në Strasburg. Në këtë proces gjyqësor Sideropoulos and others kundër Greqisë, Gjyqi në Strasburg konstaton se refuzimi të regjistrohet organizata e quajtur Shtëpia e Civilizimit Maqedonas, paraqet thyerje të nenit 11 <sup>140</sup>. Gjyqi grek, i cili e ka shqyrtuar rastin kryesisht është bazuar në raporte të shkallës së dytë dhe gjykon se shoqata ka pasur për qëllim të promovon shtet të veçantë maqedonas. Sipas këtij gjyqi, shoqata ka pasur për qëllim ta cenon integritetin territorial të Greqisë, gjegjësisht të promovon shtet të veçantë maqedonas. Gjyqi Evropian theksoi se organizata akoma nuk ka filluar të veproj dhe prandaj këto gjykime bazohen në dyshim. Refuzimi të regjistrohet kjo organizatë paraqet reaktion të tepruar se ka ndonjë kanosje të cilën mundet ta shkakton ky grup. Por, Gjyqi në Strasburg “nuk përjashton se sapo të formohet, shoqata mundet, nën mbulesën e qëllimeve të cekura në memorandumit e saj, të kyçet në aktivitete të cilat nuk janë në pajtim me ato qëllime. Në rast të tillë pushteti nuk do të mundeshin ta zgjedhin këtë problem”. Nga kjo mundet të shihet qasja rigoroze e Gjyqit kur janë në pyetje shoqatat<sup>141</sup>.

139 Qasja rigoroze e Gjyqit ndaj kufizimeve të partive politike mundet konkretisht të shihet në gjykimin e rastit United Communist Party of Turkey and Others v. Turkey, 30.01.1998, Reports of Decisions and Judgements 1998-I; për raste tjera shih Harris, D. J., M. O’Boyle, C. Warbick: Law of the European Convention on Human Rights, Butterorths, London, Dublin, Edinburgh, 1995

140 Më tepër në G. Zyrtare RM. 52/10

141 Ligji për tubime publike, G. Zyrtare e RM-s 55/95; Ligji për parti politike, G. Zyrtare RM 74/04; Ligji për marrëdhënie të punës, G. Zyrtare RM 65/05

## LEGJISLACIONI NACIONAL DHE PRAKTIKA

### » **Zgjidhjet kushtetuese dhe ligjore në Maqedoni**

Liria e shoqërimit garantohet me aktin më të lartë juridik në vend, Kushtetutën. Me alinenë 1 të nenit 20 pos garantimit të lirisë së shoqërimit janë cekur edhe qëllimet për të cilët qytetarët mundet të shoqërohen. Kështu, kjo aline thotë “qytetarët mundet lirisht të shoqërohen me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtat tjera si dhe bindjet e tyre”. Me alinenë e dytë janë përcaktuar disa nga format e shoqërimit dhe në të janë cekur partitë politike dhe shoqatat qytetare. Ndërsa me alinetë tre dhe katër nga i njëjti nen përcaktohen kufizimet bazike të kësaj të drejte. Alineja tre thotë: “programet dhe veprimi i shoqatave të qytetarëve dhe partive politike nuk mundet të kenë për qëllim shembjen e dhunshme të rendit kushtetues të Republikës dhe inicimin e agresionit ushtarak apo nxitjen e urrejtjes nacionale, racore apo fetare”, kurse alineja katër precizon se ndalohen shoqata ushtarake apo gjysmë ushtarake të cilat nuk bëjnë pjesë në forcat e armatosura të Republikës së Maqedonisë. Kjo kornizë precizohet me nenin 110, paragrafi 1, alineja 7 në të cilin thuhet se për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve vendos Gjyqi Kushtetues i Republikës së Maqedonisë. Pos nenit 20 i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë i përket lirisë së shoqërimit Kushtetuta gjithashtu garanton edhe forma të tjera të shoqërimit siç janë sindikatat (neni 37) dhe kishat, bashkësitë fetare dhe grupe të tjera religjioze të parapara me nenin 19, amendamentin 7.

Sigurisht, Kushtetuta e parasheh edhe të drejtën e tubimit të qetë dhe protestës publike. Edhe këtë të drejtë shteti mundet ta kufizon në kushte lufte dhe gjendje të jashtëzakonshme.

Liria e shoqërimit në Maqedoni rregullohet me Ligj të veçantë për shoqata dhe fondacione. Me këtë ligj rregullohet mënyra, kushtet dhe procedura për formim, regjistrim dhe përfundim të punës së shoqatave, fondacioneve. Si zakonisht ka edhe kufizime (neni 4 paragrafi 2) nëse programi dhe veprimi ka të bëjë me shembje të dhunshme të rendit, nxitjen e urrejtjes nacionale dhe fetare... Format e shoqërimit rregullohen me ligje tjera, gjegjësisht e drejta e shoqërimit ka të bëjë apo trajtohet edhe në Ligjin për tubime publike, Ligjin për parti politike të miratuar në vitin 2004, por i cili ka pësuar më shumë ndryshime, Ligji për marrëdhënie të punës dhe ngjashëm ..

### » **Liria e shoqërimit dhe kufizimi i saj në Maqedoni**

Kufizimi i lirisë së shoqërimit në vend kryesisht mund të thuhet se janë trysni joformale si në procesin e formimit të shoqatave ashtu edhe gjatë veprimit të tyre. Kjo shihet edhe nga rezultatet e hulumtimit ku janë të kyçura 161 shoqata, të zbatuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtarë. Më saktë në pyetjen e parashtruar se a është ballafaquar

organizata juaj me kufizim jologjor apo sulme nga ana e pushtetit lokal apo qendrorë, 18.8% janë përgjigjur “po”, kurse 81.2% “jo”. Gjatë kësaj si kufizim të së drejtës për shoqërim cekin shembuj të llojeve në vijim: pasoja në vendin e punës, kontrole nga ana e Drejtorisë për të Hyra Publike, pagimin e taksës radio-difuzive pa paralajmërim, gjegjësisht marrjen e mjeteve nga gjiro llogaria, trysni nga inspektorati ndërtimorë, trysni, kërcënime, përgjime policore. Nga këto përgjigje shihet se përfaqësuesit e shoqatave praktikisht edhe nuk i dinë shkaqet e kufizimit të lirisë së shoqërimit dhe cekin shembuj të cilët nuk janë në kontekst me kufizimin e kësaj të drejte.

### **Presionet joformale**

Për trysnitë joformale me të cilat ballafaqohen shoqatat flasin shembujt, gjegjësisht përvoja e disa shoqatave. Gjatë kësaj ajo që mundet të përfundohet është se përfaqësuesit e shoqatave si probleme cekin se gjatë regjistrimit kryesisht u janë dhënë vërejtje për emrin e organizatës, pastaj tregojnë për trysni politike, kurse vetë përfaqësuesit e këtij sektori si kufizim e cekin edhe dokumentacionin e vëllimshëm të nevojshme për regjistrim<sup>142</sup>.

**IMKA Manastir:** Përfaqësuesit e kësaj organizate janë ballafaqur me kufizim gjatë regjistrimit. Në vitin 2002 kur është regjistruar shoqata e cila është pjesë e rrjetit botërorë të IMKA - Young Men’s Christian Association, që të jetë më bindëse kanë dashur të regjistrohen si Asociacioni Rinor Krishterë IMKA Manastir. Lënda është kthyer nga ana e gjyqit kompetent për regjistrim (deri në vitin 2007 shoqatat i regjistrojnë gjyqet themelore, me ndryshimin e rregullores ligjore tani ato regjistrohen në Regjistrin Qendrorë) me sqarim se nuk mundet të përdoret fjala krishtere. Në fund për shkak të kësaj vërejtje regjistrohen si Asociacion Rinor IMKA Manastir. Simptomatike në këtë rast është se i njëjti gjykatës e sjellë vendimin në bazë të ligjit i cili vlen për të gjithë në tërë territorin, kurse organizata në Shkup sipas të njëjtit ligj regjistrohet si Shoqatë Rinore Krishtere IMKA Maqedoni e cila ekziston deri sot me po atë emër.

**FORUM – Qendra për hulumtime strategjike dhe dokumentim:** Gjatë regjistrimit të FORUM – Qendrës për Hulumtime Strategjike dhe Dokumentim, sipas legjislacionit i cili ishte në fuqi në vitin 1997, domethënë në gjyqin kompetent, gjykatësi disa herë është menduar për shkak të shprehjes (hulumtime strategjike) që në fund ta aprovon regjistrimin si shoqatë qytetarësh. Te themeluesit ekziston vetëdija se ambiciet e tyre janë shumë më të gjera se definicioni për shoqatë, por regjistrimi i tink-tenk është i pamundur. Në veprimin e mëvonshëm kufizimi është shfaqur në nivel të “reputacionit” i cili në Republikën e Maqedonisë gjithnjë mund të lëkundet. Kjo ndodhë në veçanti nga ana e subjekteve politike të cilave disa aktivitete të shoqatave në një mënyrë ua prish komforin, gjegjësisht vetëm rreth disa çështjeve është e mundur të shprehen qëndrime të ndryshme nga ato të

142 Shembujt janë nga intervistat me përfaqësuesit e shoqatave. Nga IMKA Manastir intervistë me Viktor Iliev, FORUM – Gjyner Ismail, Këshilli për Bashkëpunim Global- Gjyner Ismail, FOKUS – Dime Vele, Sindikata e gazetarëve dhe punonjësve medial – Tamara Çausidis

subjektit politik. Atëherë vijon “ofensivë propagandistike e diskreditimit”, goftë nëpërmjet medimeve, apo nëpërmjet llojeve tjera të zbulimit publik apo më diskret të motiveve dhe burimeve të financimit.

**Këshilli për bashkëpunim global:** Gjatë regjistrimit të Këshillit për Bashkëpunim Global, aplikimi në fakt ka qenë për Këshill për Punë të Jashtme. Nëpunësi për regjistrim dy herë e refuzon regjistrimin herën e parë për shkak të shprehjes “jashtme”, e pastaj për shkak të shprehjes “punë”. Kjo sipas kompetentëve për regjistrim të shoqatave ka qenë monopol i organeve shtetërore e jo i shoqatave të qytetarëve. Duke dashur të kursejnë kohë dhe energji, nga ana e përfaqësuesit ligjor themeluesve u është sugjeruar ta ndryshojnë titullin/emrin.

**FOKUS – Fondacioni për zhvillim lokal dhe demokraci, Veles:** Fondacioni FOKUS si kufizim të parë gjatë formimit të shoqatës mendon se është në procedurën e themelimit për të cilën gjë nevojiten numë i madh dokumentesh, të cilat pas ditës së themelimit nuk nevojiten. Personat të cilët themelojnë shoqatë ballafaqohen me procedura ligjore dhe prandaj duhet të paguajnë shërbime juridike apo këshillëdhënëse. Tjetër pengesë është mos bërja e dallimit të regjistrimit të shoqatave me subjektet tjera juridike – shoqata tregtare, SHA dhe ngjashëm. Pastaj këtu bëjnë pjesë edhe formularët e panevojshëm dhe taksa e lartë në Regjistrin qendrorë.

**Sindikati i gazetarëve dhe punëtorëve medial:** Nga sindikata thonë se nuk janë ballafaqur me kufizime të lirisë së shoqërimit. Por sqarojnë një situatë. Regjistri qendrorë për regjistrimin e kësaj sindikate ka pasur takim të veçantë gjë e cila nuk është e zakonitë gjatë regjistrimit të shoqatave. Kjo ka ndodhë pasi që deri atëherë sindikatat janë regjistruar vetë si sindikata me një punëdhënëse të cilët pastaj janë shoqëruar në Lidhje apo Konfederata, ndërsa kjo sindikatë i përfshinë anëtarët si individë, kurse punëdhënësit janë shumë. Kurse vetë sindikata është i vetëm dhe i pavarur. Megjithatë edhe pos kësaj Sindikata e gazetarëve dhe punonjësve medial u regjistrua në Regjistrin Qendrorë..

### » **Të papunësuarit nuk mund të udhëheqin me organizata qytetare**

Për këtë problem përfaqësuesit e shoqatave nuk duan të flasin shumë.

Jeni i papunë, kurse jeni njeri i parë në shoqatë qytetarësh. Kjo është shkak t’u thërrasin nga Agjencia për punësim dhe t’u informojnë se tani më nuk jeni në regjistrin e të papunësuarve. Praktika e tillë krijon pasqyrë joreale për të papunësuarit, sepse zvogëlohet numri i të papunësuarve kurse nga ana tjetër kufizohet e drejta e shoqërimit. Kjo ndodhë për shkak se Agjencia shumë gjerësisht i interpreton normat juridike të cilat i përkasin kësaj fushe. Të papunët të cilët menaxhojnë me shoqata janë viktima të paqartësive në ligj i cili i barazon persona e parë të shoqatave tregtare të cilat realizojnë profit me shoqatat të cilat janë organizata jofitimprurëse. Sipas kësaj logjike edhe nëse edhe nëse punoni vullnetarisht në shoqatën apo fondacionin tuaj apo nëse merrni para për punë të kryer me

kontratë në vepër donë të thotë se jeni i punësuar.

Si duket kjo në praktikë? Njerëzit e parë të shoqatave të cilët janë të papunësuar ftohen nga Agjencia për punësim, gjegjësisht nga qendra kompetente dhe i informojnë se si themelues të personave juridik nuk mundën të paraqiten si të papunësuar dhe ti shfrytëzojnë privilegjet që u takojnë me evidentimin në këtë institucion. Gjatë kësaj u sqarohet se në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim “në rast të papunësisë evidentimi i personave të papunësuar nuk vazhdon të bëhet nëse personi themelon shoqatë tregtare, ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik”. (Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, neni 59, paragrafi 1 pika 3).

Problemin e krijon paqartësia e këtij Ligji. Sipas këtij ligji evidentimi nuk vazhdon të bëhet nëse personi themelon shoqatë tregtare, ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik. Prandaj Agjencia për punësim pjesën “subjekt tjetër juridik” e interpreton shumë gjerësisht dhe i merr parasysht edhe njerëzit e parë të organizatave joqeveritare të cilët nuk janë të punësuar.

Përti ikur kësaj dukurie me ligj duhet të precizohet cilat persona do të jenë në kategorinë të papunësuar. Një kategori janë personat me nevoja të posaçme, të cilët nuk mundën të punojnë. Ata janë kategori e veçantë e cila nuk kërkon punë. Pastaj kategori tjetër është ajo e cila në mënyrë aktive kërkon punë dhe ato janë persona të cilët janë të papunë dhe e japin pasqyrën reale të papunëve. Domethënë nuk mundet dikush që është pa punë dhe vetë se është përfaqësues i shoqatës të fshihet nga regjistri i të papunëve.

### » **Modest Court Practice**

Praktikë modeste gjyqësore

Në përvojën gjyqësore ka shumë pak lëndë ku ndalohet veprimi i shoqatës pas regjistrimit të saj, gjegjësisht gjatë punës. Një rast i tillë është me shoqatën “Ratko” të themeluar më 24 maj, 2000. Promovimi zyrtarë i shoqatës mbahet më 27 tetor 2000 në Shkup. Në fillim të tetorit shoqata e boton fletushkën e parë informative në të cilën jep informata bazike për shoqatën dhe për qëllimet e tyre dhe aktivitetet programore. Në fletushkë ceket se emri i shoqatës vjen nga nofka e Ivan (Vanço) Mihajlov – Ratko, personalitet në opinionin maqedonas i njohur si dashamirës i politikës bullgare e jo asaj maqedonase. Ky është shkaku pse ngrihet iniciativë para Gjyqit Kushtetues të Republikës së Maqedonisë për vlerësim të kushtetutshmërisë së programit, statutit të shoqatës, si edhe iniciativa për vlerësim të kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjyqit Themelor në Ohër. Më 17 janar të vitit 2001 Gjyqi Kushtetues sjell Vendim për të ngritur procedurë për vlerësim të kushtetutshmërisë, kurse më 21 mars të vitit 2001 sjell Vendim me të cilin shfuqizohet programi për punë i shoqatës së qytetarëve “Ratko” dhe shfuqizohet statuti i shoqatës.

Edhe pse Gjyqi Kushtetues gjatë marrjes së qëndrimit për ti shfuqizuar programin dhe

statutin e shoqatës ka pasur parasysh se liria dhe e drejta e shoqërimit të qytetarëve është vlerë themelore për ekzistimin e marrëdhënieve demokratike dhe prandaj kjo e drejtë garantohet me Kushtetutë, megjithatë Gjyqi ka vlerësuar se liria dhe e drejta e shoqërimit, organizimi dhe veprimi nuk mundet të kuptohet dhe aprovohet në qëllimet dhe zgjedhjen e mjeteve për realizimin e tyre.

Rasti Ratko tani është para Gjyqit Evropian. Aplikimi është dorëzuar në korrik 2001 nga ana e shoqatës. Gjykimi Gjyqi e solli më 15 janar të vitit 2009 dhe i njëjti e konstaton thyerjen e nenin 11 të KEDNJ-s nga ana e Maqedonisë. Gjyqi mendon se mosrespektimi është bërë me gjykimin e Gjyqit Kushtetues sipas të cilit shteti i shfuqizon programin dhe statutin e shoqatës me çka ndalohet puna e shoqatës <sup>143</sup>.

143 Më tepër për rastin Ratko në tezën magjistruese Liria e shoqërimit si e drejtë njerëzore në demokraci, Emina Nuredinoska,



# PËRFUNDIM DHE REKOMANDIMS

Liria e shoqërimit nuk është e drejtë absolute dhe e njëjta ka kufizime të caktuara sipas normave ndërkombëtare. Kufizimet mundet të jenë pranishme në një shoqëri demokratike nëse ato janë në interes të sigurisë nacionale, për pengimin e trazirave apo veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit apo për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tjerëve. Garantimi i së drejtës së shoqërimit dhe kufizimet e cekura janë të definuar në dokumentet ndërkombëtare siç janë Pakti për të drejtat qytetare dhe politike, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut kurse pastaj shkrihen në legjislacionet nacionale. Standardet e cekura janë obliguese edhe për Maqedoninë si nënshkruese e këtyre dokumenteve ndërkombëtare.

Çka mundet të përfundohet kur bëhet fjalë për lirinë e shoqërimit?

Së pari, kufizimet shpesh herë ekzistojnë kur bëhet fjalë për parti politike dhe sindikate (kjo kryesisht është në nivel ndërkombëtarë)

Së dyti, se a respektohet ose se a ka kufizime të lirisë për shoqërim, organizatat joqeveritare ndërkombëtare vlerësojnë në bazë të asaj se a respektohen standardet e vendosura në dokumentet ndërkombëtare të cilët i garantojnë të drejtat e njeriut (UDP, KPK, KEDNJ). OJQ-t ndërkombëtare kryesisht i ftojnë organet kompetente në shtete që ti përputhin legjislacionet nacionale me dokumentet ndërkombëtare.

Së treti, liria e shoqërimit në Maqedoni shpesh herë nuk është çështje e kufizimit. Kufizimi shpesh herë fillon kur shoqërimi shfrytëzohet për realizimin e lirisë së shprehjes.

Si rekomandim, kur janë në pyetje të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe liria e shoqërimit, mund të jetë ajo që legjislacioni nacional duhet patjetër të jetë në përputhje me normat ndërkombëtare.

## Bibliografia

1. Dimitrijević, V., Međunarodno pravo ljudskih prava, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 2007
2. Harris, D. J., M. O'Boyle, C. Warbick: Law of the European Convention on Human Rights, Butterorths, London, Dublin, Edinburgh, 1995
3. Nowak, M., Commentary on the UN Covenant on Civil and Political Rights, NP Engel Publisher, 1993
4. Nuredinoska, E., Liria e shprehjes si e drejtë e njeriut në demokraci (teza e magjistrimit), Universiteti Sh. Qiril dhe Metodij, Fakulteti Juridik, Shkup 2010.

## Raporte

1. **Freedom to Create Associations-A Declarative Regime in Name Only**, HRW Report, 2009
2. **The Suppression of China Democracy Party**, HRW Report, 2000
3. **The State of the World's Human Rights**, Amnesty International Report, 2010
4. **The State of the World's Human Rights, Working to Protect Human Rights**, Amnesty International Report, 2009

## Ligje

Ligji për shoqata dhe fondacione, L. Zyrtarë RM 52/10

Ligji për tubime publike, G. Zyrtare RM nr 55/95

Ligji për parti politike, G. Zyrtare RM 74/04

**Ligji për marrëdhënie pune**, G. Zyrtare RM 65/05

## *Shënime për autorët*

**Mr. Ilina Mangova** është hulumtuese dhe projekt menaxhere në Institutin për Demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS). Në kuadër të Institutit për Demokraci punon në tema lidhur me çështjet ndërreligjioze, diskriminimi dhe analiza zgjedhore. Ka diplomuar shkencat politike në Fakultetin Juridik në Shkup. Në vitin 2010 si bursiste e Qeverisë britanike ka magjistruar në politikën komparative (demokraci) në Shkollën londineze për ekonomi dhe shkencat politike. Para se të shkojë në Londër, ka punuar si ndihmës-drejtoreshë në Institutin republikan ndërkombëtar (IRI) në Shkup. Gjatë punës në IRI, ka qenë e fokusuar në hulumtime në çështje politike dhe zhvillim të kapaciteteve të partive politike.

**Mr. Bobi Badarevski** studimet i kreu në Institutin për filozofi pranë Universitetit Sh. Qirili dhe Metodi në vitin 1997 në Shkup. Magjistroi në vitin 2008 në Institutin për hulumtime shoqërore dhe humaniste “Euro-Ballkan” me punimin e magjistraturës me titull “Epistemologjia feministe dhe analiza gjinore”. Bashkëpunon me institucione të shumta nga fusha e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut. Është anëtar në këshillin redaktues të revistës Identiteti: Revistë për politikë gjini dhe kulturë. Interesi i tij aktual dhe tekstet janë nga fusha e studimeve gjinore, veçanërisht metodologjia gjinore dhe epistemologjia, analiza kritike e diskurseve dhe çështjet e gjinisë dhe teknologjitë informative-komunikuese. Autor i teksteve të shumta dhe publikimeve nga fusha e barazisë gjinore. Redaktor i përmbledhjes Perspektiva gjinore e tregtisë me njerëz, Euro-Ballkan pres, 2004.

**Mr. Nikica Kusenikova** është drejtore ekzekutive e Konekt. Konekt është shoqatë, misioni i të cilës është promovimi dhe nxitja e dhurimit privat dhe përgjegjësisë shoqërore (PSHN) të orientuara drejt zhvillimit efektiv dhe afatgjatë të Maqedonisë. Është autore e disa publikimeve në fushën e filantropisë dhe PSHN. Ajo është zëvendës anëtare e Trupit koordinues nacional për PSHN dhe anëtare e komitetit për zhvillimin e fuqisë së punës dhe PSHN në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane. Ka kryer studimet pas diplomimit evropiane nga fusha e zhvillimit lokal komparativ pranë Universitetit në Trento, Universiteti nga Regensburgu dhe Universiteti Korvinus nga Budapesti. Ka magjistruar në temën “Filantropia te diaspora si resurs potencial për organizatat

joqeveritare në Maqedoni”. Trembëdhjetë vitet e fundit punon në pozita udhëheqëse dhe si konsultante në programe zhvillimore ndërkombëtare dhe nga vendi. Krahas angazhimit profesional, ajo është aktiviste në sektorin civil dhe anëtare e Shoqatës për mbrojtjen e kafshëve “Sërna”, Fondacioni Nacional për transplantacion, Qendra e krizës “Shpresa” dhe HOPS.

**Mr. Simonida Kacarska** ka doktoruar në Universitetin Lids në Mbretërinë e Bashkuara dhe e hulumton lidhjen mes procesit së qasjes në Bashkimin Evropian dhe zhvillimin e politikave për pakicat nacionale në rastet e Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kroacisë. Ka diplomuar në shkencat politike dhe studimet evropiane në Universitetin amerikan në Bullgari, ndërsa magjistrin në politikën evropiane në Universitetin Saseks. Ajo ka përvojë shumëvjeçare pune rreth kriterëve politike për qasjen në BE në shërbimet shtetërore në Republikën e Maqedonisë. Gjatë gjashtë viteve të fundit merret me punë hulumtuese në projekte të vendit dhe ndërkombëtare, gjatë së cilës ka qëndruar në Universitetin Oksford, Universitetin Kent në Bruksel, si dhe Universitetin Siena në Itali. Si bashkëpunëtoresh e jashtme ka punuar në projekte ndërkombëtare për Universitetin e Evropës Qendrore dhe Universitetin Londër metropolitan. Është autore dhe ko-autore e disa publikimeve dhe eseve nga fusha e demokratizimit dhe procesit të qasjes drejt BE në revista shkencore nga vendi dhe jashtë.

**Mr. Slagjana Dimishkova** është politikologe e diplomuar, magjistër i shkencave juridike në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Ka punuar si gazetare në disa medime të shkruara, kurse tani është gazetare në gazetën ditore Nova Makedonija. Ka përvojë pune si korrespondentë në Radion Evropa e Lirë. Përveç gazetarisë ka përvojë edhe si ligjërues në institucione të arsimit të lartë, në fillim në Universitetin e Evropës Juglindore, e pastaj edhe në Fakultetin Juridik Justinijani i Parë. Pos gazetarisë në fokusin e interesit janë edhe të drejtat e njeriut. Përgatitën edhe analizë të ligjeve, punon si konsultat. Është autor i librit Liria e shprehjes dhe demokracisë, ka shpallur edhe më shumë tekste në revista të ndryshme.

;

.

